

**Barazia
buxhetore,
premtim vetëm
në fushata**

Fq.3



**SHKOLLAT
PROFESIONALE**

**Drejtime
që nuk duhet
humbur**

Fq.7



**Koman-
dantët**

Forum

Fq.10



Koha

www.koha.mk

**Një luftë për
tubacionet!**

Fq.12



E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3361 · e enjte 10 maj, 2018

12°C | 26°C

15 DEN

EDITORIAL

**"Skenaristët"
në liri,
"aktorët"
në burg!**



Ngjarjet e 9 dhe 10 majit 2015 nuk ndodhën vetvetiu, në mënyrë stihike. Ato dikush i ka ideuar dhe organizuar. Madje kjo punë u bë me bashkëpjesëmarrje. Plot individë...

Fq.2

PROFILE

**Skuadra që
po tmerron
Afrikën
e Jugut**

Fq.17

RAJON

**Diplomacia
sipas tekeve**

Fq.14

GLOBI

**Kurdi
që sfidon
Erdoganin,
fushatë
nga burgu**

Fq.15



TREVJET PAS KUMANOVËS, NGECHETIMI NDËRKOMBËTAR

ORGANIZATORËT NË LIRI



Roli i pjesëtarëve të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim në organizimin e "Grupit të Kumanovës", mendohet të jetë trajektorja kryesore përmes të cilës do të realizohet asistenca ndërkombëtare për "Lagjen e Trimave"

Fq.5

Serbët plaken më shpejt!

Shkup, 9 maj - Pothuajse një në pesë persona në Bashkimin Evropian (BE) është 65 vjeç ose mbi këtë moshë. Sipas statistikave të bëra publike nga EUROSTAT-i, rreth 19.4% e një popullsie prej gati 100 milionë banorësh janë 65 vjeç ose më shumë. Raporti i varësisë së plakjes tradicionalisht shihet si një tregues i nivelit të mbështetjes në dispozicion të personave të moshuar (të moshave 65 vjeç e lart) nga popullata

në moshë pune (të moshës 15 deri në 64 vjeç). Në BE, raporti i varësisë së plakjes ishte 29.9% në vitin 2017. Sipas studimit, për çdo person të moshës 65 vjeç e lart kishin pak më shumë se tre persona në moshë pune. Raporti i varësisë së plakjes së BE-së është rritur për një kohë të gjatë. Njëzet vjet më parë, kishte rreth pesë persona në moshë pune, për çdo person të moshës 65 vjeç e lart...

Fq.7



EDITORIAL

"SKENARISTËT" NË LIRI,
"AKTORËT" NË BURG!

Emin AZEMI

Ngjarjet e 9 dhe 10 majit 2015 nuk ndodhën vetvetiu, në mënyrë stihike. Ato dikush i ka ideuar dhe organizuar. Madje kjo punë u bë me bashkëpjesëmarrje. Plot individë nga Maqedonia dhe nga Kosova u kujdesën që këto ngjarje të kenë efektin dhe kontekstin e tyre. Mirëpo jo të gjithë individët u penalizuan për veprimet e tyre. Disa humbën jetën, të tjerët u burgosën me qindra vite burg dhe jo pak u dënuan me burgime të përjetshme. Por, të gjithë këta nuk kanë qenë vetëm dhe është iluzore të mendohet se veprimet e tyre nuk e kishin njëfarë parapërgatitje dhe njëfarë koordinimi.

Mirëpo çka ndodhi? Jashtë burgut mbetën ata individë që i organizuan ngjarjet e Kumanovës? Në Kumanovë, më 9 dhe 10 maj ranë disa idealistë shqiptarë, që gabimisht u futën në agjendat e matrapazëve shtetërorë të Shkupit e Prishtinës dhe është për t'u habitur se si kjo e vërtetë vazhdon të mbetet disi e pluhosur me tisin e misteriozitetit dhe paqartësisë. Fatkeqësisht jo pak njerëz vullnetar mirë në Kosovë më me rëndësi e kishin t'i shpallnin heronj këta djem që ranë në Kumanovë, se sa të çjerrin maskën e harburëve të gjithë atyre që i futën këta djem në gërrhë, një rrugicë qorre të një lagjeje të varfër të Kumanovës, aty ku idealistët e kishin menduar të hyjnë, por kishin qenë matrapazë dhe harbutët ata të cilët e kishin menduar mosdaljen nga kjo rrugicë. Në rrugët pa dalje hyjnë ose njerëzit që nuk i njohin taktikat e luftës guerile, që nuk ishte në rastin e "grupit të Kumanovës", ose në ato rrugë të fut dikush, me premtimin se "lehtë ia bëjmë, mjafton të shkrepën disa rafale...".

Tani po kërkohet ekspertizë ndërkombëtare për të rishikuar edhe njëherë këto ngjarje. Por, para se të bëhet kjo ekspertizë, Prokuroria Speciale Publike e Maqedonisë është mirë t'i kërkojë dhe ti vihen në dispozicion të gjitha telefonatat që janë zhvilluar në mes të pjesëtarëve të "grupit të Kumanovës" dhe individëve të caktuar që kanë punuar nëpër shërbime sekrete të Maqedonisë dhe Kosovës. Aq e thjeshtë është kjo punë dhe pa ndonjë telashe të madhe, sa që nuk ka vend më për kurrfarë ekspertize ndërkombëtare. PSP duhet të mos hezitojë në veprimet e saja parahetuese, sepse edhe zogjtë e malit e dinë se pjesëtarët e këtij grupi që u futën në atë rrugë qorre në Kumanovë, nuk kanë mundur të ndërmarrin asnjë hap pa qenë paraprakisht të "instruktuar" prej individëve të caktuar të shërbimeve sekrete. Pse institucionet e drejtësisë po bëhen sikur nuk i dinë se kush janë këta individë? Pse politika aktuale po tregohet kaq pa sens në zbërthimin e kësaj nyjeje që dikush para tyre e lidhi për të ngulfatur një proces? Kryeministri Zav, në bombat e famshme të tij ka edhe plot biseda të përgjuara që mund të jenë pista të sigurtta hetimi për atë se kush ishte i përfshirë në organizimin e ngjarjeve të përgjakshme të Kumanovës. Është shumë e qartë se politika i ka rregullat e veta të funksionimit dhe ka shumëçka që mbetet mister, për hir të disa raporteve, proceseve e konteksteve të caktuara. Mirëpo, nuk duhet të harrojmë se politika ka edhe moral dhe një politikë dallohet për parime të drejta, vetëm atëherë kur udhëhiqet nga morali. Nëse ngjarjet e përgjakshme të Kumanovës lihen kështu, të pasqaruara dhe të pa ndriçuar deri në fund, atëherë i bie që turli kastravec i shërbimeve sekrete mund të kurdis, pa i munguar as një qime floku, çfarëdolloj "spektakli" dhe për këtë politika të hesht dhe të mos kërkojë llogari për autorët e atij "spektakli". Nëse politikë legale nuk reagon ndaj deformimeve që vijnë prej njerëzve të shërbimeve sekrete, atëherë ajo politikë është bashkëpjesëmarrëse në ato ngjarje, duke iu dhënë madje edhe legjitimitet institucional. Pra, jo vetëm që nuk mund të flasim për një politikë të drejtë dhe të moralshme, por nuk mund të pretendojmë se edhe në të ardhmen nuk mund të përsëriten skenarë të ngjashëm, ku politika sërish do të paraqitet në rolin e sehirxhiut.

"Ngjarjet e Kumanovës" duhet ti kalohen PSP-së dhe të ndahet njëherë e përgjithmonë fajësia e atyre që erdhën pa e ditur se ku po vijnë, e që morën dënime kapitale, dhe të tjerëve që e dinin saktësisht epilogun dhe efektin e këtyre ngjarjeve, e që aktualisht janë më të lirë se zogjtë e malit. Përderisa të mos futen në kafaz këta zogj grabitqarë, nuk mundet të flitet për kurrfarë ekspertize, qoftë ajo kombëtare a ndërkombëtare dhe "ngjarjet e Kumanovës" do të vazhdojnë të mbeten një gropë e thellë e mistershme ku secili e ka luksin të projektojë konspiracionet e veta.

SERBIA PO POLITIZON EDHE SPORTIN

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka reaguar për ndalimin e përfaqësueses së Kosovës në karate në kufi me Serbinë nga autoritetet serbe. Përmes një postimi në Facebook, Thaçi ka shkruar se Serbia po tenton të politizojë edhe sportin që duhet të bashkojë popujt. "Ndalimi i pjesëmarrjes së karateisteve kosovarë në kampionatin Evropian të karatesë për seniorë në Novi-Sad nga autoritetet e Beogradit është e papranueshme, është kundër frymës sportive dhe rregullave elementare të Federatës Ndërkombëtare të Karatesë", ka shkruar Thaçi. "Me sjellje të tillë, Serbia po tenton t'i politizojë edhe sportin, i cili duhet t'i bashkojë popujt dhe jo të krijojë ndarje mes tyre", ka shkruar ai.



BEOGRADI PO QËNDRON NË POLITIKAT NACIONALISTE

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka reaguar për ndalimin e përfaqësueses së Kosovës në karate që i është bërë në Merdare nga autoritetet e Serbisë. Përfaqësuesja e Kosovës pritet të marrë pjesë në Evropianin që mbahet në Novi Sad, por autoritetet serbe kanë pamundësuar shkuarjen e tyre në Vojvodinë. "Ndalimi i Kombëtares së Kosovës nga autoritetet e Serbisë, për të marrë pjesë në Kampionatin Europian të Karatesë në Novi Sad të Vojvodinës, është akt i papranueshëm që nuk i kontribuon normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve tona. Autoritetet serbe janë njoftuar më kohë nga Komiteti Olimpik i Kosovës për këtë udhëtim dhe pretendimi se ato nuk janë informuar me kohë është i paqëndrueshëm. Këtë akt ndalese të shtetit serb, të dytin më radhë brenda një kohe të shkurtë, e konsiderojmë si veprim që sinjalizon se Serbia po qëndron në politikat nacionaliste të konfliktit dhe refuzimit në vend të bashkëpunimit", ka shkruar kryeministri Ramush Haradinaj në Facebook.



DY KRYEMINISTRAT E ARDHSHËM

"Emerimi i Sajid Javidit në pozite të Sekretarit të Brendshëm Britanik ka ndryshuar skenën politike në Britani të Madhe. Ky funksion i rendesishëm konsiderohet se do faktorizojë edhe me tutje Sajidin. Ky artikull flet për miqesinë e Sajidit me Sadiqin, dy politikaneve me prejardhje aziatike (pakistaneze) dhe që te dy bije të shofereve të autobusave. Ata janë në parti të ndryshme dhe miqesia e tyre mund të shenderrohet në 'armiçesi' pasi që, që te dy, shihen si kryeministra të ardhshëm të Britanisë së Madhe. Sidoqoftë, ky është një artikull interesant", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti nga Londra, Daut Dauti.



MEDIACitate

LONDRA, QYTETI MË I MIRË NË BOTË PËR STUDENTËT

Londra është listuar në vendin e parë si qyteti më i mirë në botë për studentët. Kompania Quacquarelli Symonds (QS) e specializuar në të dhënat e edukimit të lartë ka renditur më parë Montrealin dhe Parisin në vendin e parë. Renditja bazohet në disa faktorë si numri i universiteteve më të mira në një qytet, tregu i punës, diversiteti kulturor dhe kualiteti i jetës. Sidoqoftë, Londra ka mbetur mbrapa në kategorinë e përballeshmërisë. Kompania në fjalë publikon çdo vit edhe renditjen e universiteteve më të mira në botë. Krahasimet, të cilat përfshijnë pikëpamjet e 50,000 studentëve janë përpjekje për të përcaktuar disa nga përparësitë dhe të metat e qyteteve për studentët. Në 10 vendet e para nuk gjendet asnjë qytet amerikan, krahasuar me dy vende gjermane si Berlina dhe Mynihu. Paris, që për vite të tëra ka kryesuar në listë, këtë vit gjendet i pesti në listë.

(REL, 9 maj)

GJERMANI, VJET JANË KRYER 1075 KRIME ANTI-ISLAME

Vitin e kaluar në Gjermani janë kryer gjithsej 1.075 krime anti-islame. Ministri i Brendshëm gjerman, Horst Seehofer, në një deklaratë në një mbledhje prezantimi për "Raportin e Statistikave të Krimit 2017", mbajtur në Qendrën e Shtypit Federal ka theksuar se vitin e kaluar janë kryer 1.075 krime anti-islame. Krimet në fjalë theksohet se janë përbërë nga veprime të tilla si hedhja e gjakut të derrave ndaj xhamive, dërgimi i letrave kërcënuese, sulmimet ndaj grave të mbuluara me shami, vizatimi i simboleve naziste nëpër shtëpitë ose xhami si dhe publikimi i shkrimeve të urrejtjes në internet. Nuk mund të bëhet një krahasim e shifrave me vitin tjetër për shkak të faktit se krimet anti-islame në Gjermani kanë nisur të regjistrohen për herë të parë vitin e kaluar. Ndërkohë, bëhet e ditur se në Gjermani vitin e kaluar, numri i krimeve ka rënë me 9.6 për qind krahasuar me 2016.

(Anadolu Agency, 9 maj)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KA PATUR VEND NË SHQIPËRI ME EMRIN ZETA?

Zeta është emri me të cilin njihet që nga shekulli XIII territori që shkonte deri në derdhjen e Bunës në Adriatik, duke përfshirë edhe një pjesë të trevave të brendshme malore. Emri Zeta zëvendësoi emrin e vjetër Dioklea. Zeta ndahej në dy pjesë: në Zetën e sipërme, pjesa veriore malore dhe Zetën e poshtme, viset fushore rreth liqenit të Shkodrës e në lindje të tij. Trevat e Zetës si ato të Dioklesës u gjendën së pari nën sundimin e princit Voislav që ia shkëputi Bizantit e më vonë kaluan në

sundimin e dinastisë së Nemanjideve. Nga gjysma e dytë e shekullit XIV edhe në shekullin XV me formimin e principatës feudale shqiptare të Balshajve, emri Zeta përfshihet në emrin më të përgjithshëm Shqipëri ose identifikohet me të. Kurse nën sundimin osman, emri Zeta u zëvendësua nga emri Mali i Zi, popullsia shqiptare që jetonte në pjesën veriore të Zetës me kohë u sllavizua, ndërsa në pjesën jugore ajo e ruajti karakterin e saj etnik të vjetër shqiptar.

KËSHILLI BUXHETOR AKOMA PA FUNKSION

BARAZIA BUXHETORE, PREMTIM VETËM NË FUSHATA PARAZGJEDHORE

Jo vetëm në legjislaturat e mëhershme parlamentare, ku nuk është dëgjuar ndonjë ide apo projekt nga ana e deputetëve shqiptarë, por as tani nuk vërehet ndonjë interesim i deputetëve në Këshillin buxhetor



Tani është momenti për emrin

Shkup, 9 maj - Mendoj se tani është momenti më i mirë dhe më i papërsëritshëm për të gjetur zgjidhje për problemin e stërzgjatur me emrin, njoftoi kryeministri Zoran Zaev duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve pas përfundimit të seancës së sotme për rastin "Rryshfeti". "Pres që së paku në margjinat e Samitit të Ballkanit Perëndimor në Sofje të takohem me kryeministrin grek Cipras dhe të shfrytëzojmë arritjet e deritanishme midis dy ministrave, ndoshta do të jemi edhe më të fuqishëm në krijimtarinë tonë nuk them se jo, por në çdo rast vlen që të përpiqemi deri në fund. Unë i jap mundësi procesit", theksoi Zaev. Ai nënvizoi se çdoherë ka informuar nëse ka diçka të re në lidhje me problemin të cilin e ka Greqia me emrin tonë kushtetues dhe se kohëve të fundit nuk ka ndonjë risi për të ndarë me publikun. Zaevi kujtoi se Samiti në Sofje dhe Këshilli Evropian po afrohen dhe atë, siç shtoi, është përpjekje të paktën deri në ato data për të gjetur një zgjidhje. "Besoj se gjatë fundjavës që vjen do të mund sinjerisht dhe hapur me alternativa të caktuara dhe zgjidhje kreative të cilat dalin edhe nga ana jonë dhe nga ana e Greqisë për t'i përafuar pozicionet", tha Zaev.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 9 maj - Vonesat në realizimin e agjendave parlamentare jo vetëm në aspektin politik, por edhe në atë buxhetor, janë evidente tek shumica parlamentare. Këshilli buxhetor si njëri nga dy trupat e veçantë punues të Parlamentit të Maqedonisë bashkë me Këshillin nacional për euro-integrime, është konstituuar me vonesë - më 18 mars të këtij viti, shkaku i mos zgjedhjes së nënkryetarëve të Parlamentit kur me Rregulloren e punës, njëri nga ta udhëheq më Këshillin buxhetor. Jo vetëm në legjislaturat e mëhershme parlamentare ku nuk është dëgjuar ndonjë ide a projekte nga ana e deputetëve shqiptarë në Këshillin Buxhetor, as në legjislaturën e tanishme nuk vërehet ndonjë interesim i deputetëve shqiptarë në Këshillin Buxhetor.

Çka është më tragjike, partitë shqiptare para zgjedhjeve parlamentare e kanë lodhur opinionin se përveç barazisë së gjuhës, do të arrijnë edhe barazinë buxhetore me maqedonasit, ndërsa tani kur po bëhen një vit e gjysmë pas zgjedhjeve, partitë shqiptare parlamentare më shumë janë të preokupuar si të hynë në Qeveri se sa të dalin me projekte konkrete për barazi buxhetore apo të paktën të japin kritika për Buxhetin 2018 të Qeverisë së Zoran Zaevit. Deputetët më me përvojë në Parlamentin e Maqedonisë, Xhevat Ade-

mi dhe Rexhail Ismaili nuk pranojnë të flasin për gazetën KOHA nëse në të kaluarën grupi parlamentar i BDI-së ka propozuar apo ndonjë ide apo projekt për zonat prej nga vijnë deputetët në Këshillin buxhetor. Madje, ata thonë se nuk kanë njohuri lidhur me propozimet eventuale. Kjo, pasi Këshilli buxhetor ka kompetencë të verifikojë prioritetet strategjike të Parlamentit për vitin e ardhshëm dhe përfshirjen e tyre në Buxhetin e Maqedonisë me propozimin e programeve dhe nënprogrameve të posaçme, jep udhëzime dhe drejtime për përgatitje të propozimit të kërkesave buxhetore dhe nevojat për punën e Parlamentit. Nga ana tjetër, edhe për këtë vit duket se BDI nuk ka ndonjë plan apo projekt që do të diskutohej në Këshillin buxhetor.

Koordinatori i grupit parlamentar të BDI-së, Ejup Alimi, flet vetëm për arsyet e vonesës së këtij Këshilli, ndërsa deputeti tjetër i BDI-së, Agim Shaqiri, thotë se deri më tani nuk kanë biseduar se çfarë të propozojnë në Këshillin buxhetor. "Me ekspertët anglezë kemi pasur konsultime se si të arrihet më shpejtë dhe më mirë deri tek ajo që Parlamenti të bëhet Njësi e veçantë buxhetore dhe të mos varet prej Qeverisë. Nuk është puna vetëm pse jemi vonuar me zgjedhjen e nënkryetarëve për të funksionalizuar Këshilli Buxhetor, por ideja është që të kemi dialog të

mirëfilltë në mes partive parlamentare për të pavarësuar Parlamentin nga Qeveria në aspektin financiar", thotë Alimi.

"Deri më tani kemi qenë të ngarkuar me konsolidimin e Këshillit dhe nuk kemi propozuar diçka konkrete. Normal që ne si grup parlamentar do ti kemi propozimet tona në këtë Këshill", thotë deputeti Agim Shaqiri. Nga Lëvizja BESA, anëtar i këtij Këshilli, deputeti Nexhmedin Kahremani thotë se në mbledhjet e radhës, në Këshillin buxhetor do të propozojnë projekte për Rajonin Veriperëndimor në sferën e shëndetësisë dhe të arsimit.

"Deri më tani kam prezantuar vetëm në një mbledhje të Këshillit buxhetor, sepse më herët nuk kam qenë anëtar. Si deputetë kemi biseduar se çfarë mund të bëjmë në Këshill, duke i piketuar investimet në arsim dhe shëndetësi në Rajonin Veriperëndimor, por konkretisht ende nuk kemi diçka", tha për gazetën KOHA, Nexhmedin Kahremani. Ndryshe, më 8 mars, Këshilli buxhetor ka mbajtur seancën e parë, ndërkaq me të udhëheq nënkryetarja e Parlamentit, Frosina Ramenski. Por deri më tani, ky Këshill nuk ka arritur të miratojë Planin strategjik për periudhën 2018-2020, në të cilin mes tjerash parashihet edhe aktiviteti i përforcuar diplomatik i Parlamentit. Këshilli buxhetor po ashtu i propozon Qeverisë që në ba-

shkëpunim me Ministrinë e Financave, të ndjek ekzekutimin e shpenzimeve të Buxhetit të Parlamentit dhe propozon shpërndarjen e mjeteve në kuadër të mjeteve të miratuara me Buxhetin e Maqedonisë, sjell Rregullore për punën e tij dhe kryen punë tjera të verifikuara me ligj.

Së fundmi, kryetari dhe disa anëtarë të Këshillit buxhetor janë takuar edhe me përfaqësues të Fondit Ndërkombëtar Monetar, kjo për të përforcuar Parlamentin në aspektin buxhetor për të cilin edhe është njëri ndër prioritetet kryesore të kësaj shumice parlamentare. Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, në njërin nga brifingjet për gazetarë ishte kritik ndaj varësisë së Parlamentit nga Qeveria, duke thënë mes tjerash se dhe ujin çka e pinë, ia sjell Qeveria dhe nuk e zgjedhin vetë. Sipas asaj çka tha Xhaferi, Parlamenti vetëm nëse bëhet linjë e veçantë buxhetore, duke mos qenë i varur nga paratë prej Ministrisë së Financave, do të mund të luaj rolin dhe funksionin ashtu siç duhet. Në aspekt të pavarësisimit buxhetor të Parlamentit pritet të ndikojë pozitivisht edhe dialogu "Zhan Monet" që do të fillojë në Ohër më 18 maj me pjesëmarrjen e të gjitha partive parlamentare, kjo për të forcuar rolin e Parlamentit në aspekt të kontrollit ndaj Qeverisë dhe organeve tjera të pavarura, gjithmonë përmes bashkëpunimit pozitiv-opozitë.

SHREDER TAKON MINISTRIN POPOVSKI

GAZETARIA E LIRË, VEÇORI E SHOQËRISË DEMOKRATIKE

Shkup, 9 maj - Pas më shumë se dhjetë viteve, në Maqedoni po shihet një pamje e re politike, l ku mediumet kanë ambient të ri dhe mundësi që të punojnë në mënyrë profesionale, duke bashkëpunuar me institucionet shtetërore, theksoi drejtoresha e Federatës evropiane të gazetarëve (FEG), Renata Shreder në takim të sotëm me ministrin pa resor, të angazhuar për komunikime, Ilogaridhënie

dhe transparencë, Robert Popovski. Siç kumtoi shërbimi qeveritar për shtyp, gjatë takimit Shreder i ka shprehur Popovskit urime për angazhimin e Qeverisë për parimet e deklaruara për punë transparente dhe llogaridhënie, si dhe për komunikimin e hapur dhe transparent me opinionin dhe mediumet.

Ministri Popovski, ndërkaq, ceket, duke u falënderuar për

vlërësimet pozitive, theksoi se koncepti për qeveri të hapur, e cila i mbështetë parimet e transparencës dhe llogaridhënie është me qëllim që t'u tregohet qytetarëve se si shpenzohen paratë e tyre dhe shtoi se Qeveria e Republikës së Maqedonisë vendosë standarde edhe për të gjitha qeveritë e ardhshme, me angazhim që të mos përtëritet gabimet nga e kaluar. Ai e informoi Shreder se Qe-

veria ka krijuar sektor real për komunikim dhe përmes konferencave të rregullta për shtyp qytetarët informohen rregullisht për të gjitha vendimet të cilat sillen në mbledhjet e rregullta. Ai shtoi se krahas asaj që po bën Qeveria lidhur me sigurimin e kushteve demokratike për respektim të lirive, nevojitet, theksoi, edhe institucionet e tjera në shtet, prokuroria dhe gjykatat, të veprojnë profesionali-

sht në mënyrë maksimale ndaj cilit do sulm apo kërcënim kundër një punonjësi medial. Ministri Popovski dhe Shreder do të marrin pjesë në Konferencën e pestë vjetore për mediume në Evropën juglindore, e cila më 10 dhe 11 maj do të mbahet në Strugë, në organizim të përfaqësuesit të OSBE-së për liri të mediumeve në bashkëpunim me operacionet terrenore të OSBE-së në Evropën Juglindore.

"Humbja e shpresës për anëtarësim në BE dhe në NATO do të kontribuojë që të rinjtë edhe më tej të vazhdojnë ta braktisin vendin duke e ulur fuqinë e punës dhe mundësitë për zhvillim dhe rritje. Humbja e shpresës gjithashtu do të shkaktojë lodhje të fuqishme nga BE-ja dhe euroskepticizëm dhe do t'i rritë ndjenjat anti-NATO...", ka thënë Osmani

Shkup, 9 maj - Në rast se nuk marrin datë për fillimin e negociatave inkuadruese me BE-në, rreziqet janë të shumta, ndërsa vendet anëtare duhet ta kenë parasysh atë se kur do të vendosin, sepse duhet të jemi pjesë e Unionit dhe t'i fillojmë negociatat, porositi zëvendëskryeministri për Çështje evropiane Bujar Osmani në "Mëngjes me BE-në" tradicional me rastin e Ditës së Evropës.

"Ky vend është i vetmi në rajon i cili tërësisht i ka zgjidhur parimet. Ai është vend funksional multientik dhe multireligjioz dhe është pjesa e cila mungon në mozaikun e BE-së që mund të kontribuojë në Union me frymë të re të kohezionit dhe mund të shërbejë si shembull pozitiv për tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Është i gatshëm tërësisht të veprojë në pajtim me qëllimet e përbashkëta të jashtme-politike të Unionit dhe të jetë pjesë e strukturave mbrojtëse të BE-së. I avancojmë marrëdhëniet e mira fqinjësore në pajtim me standartet e BE-së dhe jemi të gatshëm politikisht, por edhe me kapacitetet e saja institucionale t'i fillojmë negociatat inkuadruese", tha Osmani. Ai theksoi se ka shumë rreziqe nëse Maqedonia sërish nuk merr datë për fillimin e negociatave inkuadruese.

"Humbja e shpresës për anëtarësim në BE dhe në NATO do të kontribuojë që të rinjtë edhe më tej të vazhdojnë ta braktisin vendin duke e ulur fuqinë e punës dhe mundësitë për zhvillim dhe rritje. Humbja e shpresës gjithashtu do të shkaktojë lodhje të fuqishme nga

MËNGJESI TRADICIONAL ME RASTIN E DITËS SË EVROPËS

MOS MARRJA E DATËS, SJELL SHUMË RREZIQE



BE-ja dhe euroskepticizëm dhe do t'i rritë ndjenjat anti-NATO. Ndarja e popullatës sipas bazës etnike, religjioze dhe sociale do të thellohet që do të shkaktojë cenusshmëri tek institucionet demokratike dhe kapacitetin e tyre për të qeverisur, do ta ulë nivelin e rezistencës dhe do të krijojë tokë pjellore për përzierje dhe ndikim më të madh të vendeve të treta. Do të hapë hapësirë për depërtimin e grupeve potenciale dhunuese duke e rritur me këtë rreziqun nga terrorizmi, ekstremizmi dhe nacionalizmi", paralajmëroi zëvendëskryeministri Bujar Osmani. E tërë kjo, theksoi, duhet të përdoret si bazë në të cilën do të ndërtojmë konsensus më të gjerë dhe të përhershëm për të gjitha sfidat në këtë rrugë. Prandaj nuk guxon të lejohet ta humbasim këtë moment

historik. "Viti 2018 është vit kyç për Maqedoninë. Gëzohem në Smatin e ardhshëm historik në Sofje gjatë javës së ardhshme i cili shpresoj se do të jetë samiti i parë i BE-së që i dedikohet zgjerimit pas Samitit në Selanik në vitin 2003 në të cilin presim të riafirmohet perspektiva evropiane nga vendet e Ballkanit Perëndimor me deklaratë. Sofja natyrisht do të sjellë më shumë energji dhe nxitje për përfshirje, stabilitet, siguri dhe prosperitet ekonomik të Ballkanit Perëndimor.

Në Samitin e qershorit të BE-së pritjet tona janë që zyrtarisht të marrin datë për fillimin e negociatave për inkuadrime", tha Osmani. Ambasadori i Delegacionit të BE-së në Maqedoni, Samuel Zhbogar theksoi se vendi për një vit pati sukses të arrijë rezultate impresive në

lidhje me reformat, por mbetet që Këshilli i BE-së ta sjellë vendimin për datë për negociatat inkuadruese. "Çështja nuk është nëse gota është gjysmë e zbratur ose gjysmë e mbushur, por ajo që është me rëndësi është që të vazhdoni ta mbushni, siç keni bërë deri më tani", tha Zhbogar.

Ambasadori bullgar Ivan Petkov në cilësi të përfaqësuesit të vendit si kryesues aktual me Unionin, shfaqti shpresë se gjatë kryeministri bullgar, Maqedonia do të marrë datë për fillimin e negociatave. "Mëngjes me BE-në" që mbahet tradicionalisht është në organizim të Sekretariatit për Çështje Evropiane, ndërsa në të marrin pjesë ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së, të SHBA-së dhe ish-zëvendëskryeministra për çështje evropiane.

KEMI BESIM TE MAQEDONIA

Ne kemi besim tek Maqedonia se do të na bashkangjitet në familjen evropiane. Këtë dje e tha ambasadori francez në Maqedoni Kristian Timonie në MPJ, ku me prezantim u shënuar Dita e Evropës-9 Maji. "Mirëserdhët në klub sepse ju e kaluat testin, keni bërë një hap të dukshëm me rekomandimin e pakushtëzuar. Por, ajo është vetëm fillim i një rrugëtimi. Mirëserdhët në klubin për diskutime i cili gjithashtu e paraqet BE-në", tha Timonie. Dita e Evropës, siç tha, është një ditë e madhe për të gjithë ne dhe në të ardhmen e afërt do të jetë ditë e përbashkët. Franca ju mbështet në



këtë rrugëtim. Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë të Punëve të Jashtme Viktor Dimovski informoi se gjatë këtij viti shënohet 25 vjetori nga vendosja e raporteve diplomatike midis Maqedonisë dhe Francës. U falënderua për bashkëpunimin e shkëlqyer me Francën, ndërsa veçanërisht me ambasadën e Francës në Shkup. "Mbështetja dhe partneriteti me Francën për rrugën tonë evropiane dhe euroatlantike janë veçanërisht të rëndësishme dhe besoj se jubileun tjetër do të festojmë së bashku në familjen e madhe evropiane", tha Dimovski.

9 Maji, dita e rrëfimit dhe ëndrrës europaine

Shkup, 9 maj - Në Ditën e Evropës, Lëvizja BESA i kthehet kësaj date për ta theksuar jo vetëm rëndësinë e rrëfimit evropian, integritet dhe inkuadrimit në Bashkimin Evropian, por edhe të vëmë re se 9 Maji është dita e ngadhënjimit mbi fashizmin. "Kështu, synimi drejt shtigjeve të progresit dhe perspektivës së ndritur dhe beteja me ekstremizmat dhe radikalizmat janë mësimi i mirë që të gjithë banorët e Europës, rrjedhimisht edhe ne, duhet ta marrim nga kjo ditë. Në të vërtetë, këto dy pika janë komplementare, sepse beteja me këto vese në fakt është virtut evropian, ndërsa integriteti është ambicie e të gjitha shteteve të rajonit për t'u bërë pjesë e unionit të shteteve të kontinentit më të vjetër, pra Bashkimin Evropian. Duke u nisur nga kjo, Lëvizja BESA rikujton se ajo mbetet e angazhuar në këtë rrugë dhe angazhimi i saj edhe në të ardhmen do të jetë i fokusuar në këtë drejtim. Ajo shumë herë ka theksuar dhe vazhdon të pohojë se integriteti i Ballkanit Perëndimor në BE do të jetë një zgjidhje afatgjate për avancimin e demokracisë, vendosjen e shtetit të së drejtës dhe ngritjen e mirëqenies ekonomike të qytetarëve të këtij rajoni të Kontinentit", thuhet në njoftimin e Lëvizjes BESA, sipas të cilës, 9 Majin kjo parti e përkujton edhe me dyvjetorin e protestës së madhe në Shkup, që u mbajt më 9 maj 2016, nën moton "Dita D - Drejtësi, Dinjitet, Demokraci", që përveçse ishte protesta më e madhe shqiptare e organizuar në Shkup, ishte edhe një mesazh për orientimin e shqiptarëve të Maqedonisë dhe për qëndrimin e tyre kundrejt shtetit dhe pushtetit në Maqedoni, që akoma lë shumë për të dëshiruar.

Dita e Evropës e zbehtë pa zbardhjen e rastit të Kumanovës

Shkup, 9 maj - Dita e 9 Majit është dita kur e tërë bota perëndimore feston Ditën e Evropës, ditën e Unionit Evropian, dhe dita kur i jepet fund ideologjisë fashiste që pothuajse e kishte kapluar kontinentin më të vjetër në tërësi. Edhe pse kjo ditë në të kaluarën është festuar si një ditë fitoreje dhe unitetit edhe në Maqedoni, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për tri

vitet e kaluara, por edhe për shumë vite që do të pasojnë në çdo 9 maj të vitit. Kështu thuhet në njoftimin e RDK-së së Vesel Meedit, ndërsa shton se në momentin kur të gjithë po përgatitemi për të festuar këtë datë, në orët e mëngjesit të 9 majit të vitit 2015, ndodhën ngjarjet e Kumanovës që do të ngelin në memorien e gjithë shqiptarëve për një pe-

riudhë të gjatë kohore. "Duke qenë të vetëdijshëm se ngjarjet e Kumanovës patën potencial të nxisin një konflikt të ri ndëretnik në vend, duhet patjetër e vërteta e këtij konflikti të zbardhet deri në fund sepse në të kundërtën do të na përsëriten incidentet, si ajo më e fundit e 27 prillit në Parlamentin e Maqedonisë. Për hirë të viktimitave, të vërtetës, si dhe gjithë aktorëve di-

rekt dhe indirekt që akuzohen me të drejtë ose pa të drejtë, Rilindja Demokratike Kombëtare kërkon që sa më shpejt që është e mundur të zbardhet e vërteta për ngjarjet e Kumanovës. E vërteta patjetër duhet të del në shesh me të vetmin qëllim që aktorët e vërtetë të involvuar të japin llogari para drejtësisë, me qëllim që kurrë mos të na përsëriten raste të kësaj

natyre. Në të kundërtën, për vendin dhe për shqiptarët në përgjithësi, 9 maji asnjëherë nuk do të mund të trajtohet si datë e fitores dhe unitetit evropian. Vetëm e vërteta dhe drejtësia, sado pak, do të mund të ndryshojnë domethënien e 9 majit, për Maqedoninë dhe për shqiptarët në përgjithësi", thuhet në njoftimin e RDK-së.

TRE VJET PAS NGJARJEVE TË KUMANOVËS, NGEÇ HETIMI NDËRKOMBËTAR

ORGANIZATORËT NË LIRI



Roli i pjesëtarëve të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim në organizimin e "Grupit të Kumanovës", mendohet të jetë trajektorja kryesore përmes të cilës do të realizohet asistencë ndërkombëtare për "Lagjen e Trimave"

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 9 maj - Tre vjet pas konfliktit të armatosur në "Lagjen e Trimave" dhe pas dënimit të 38 shqiptarëve për vepër penale "terrorizëm", vazhdon të mbetet enigmë se kush janë organizatorët e vërtet të kësaj ngjarje. Ndaj vendimit gjyqësor kundër Grupit të Kumanovës, nga 2 nëntori e deri e këndej, nëpër rrugët e Shkupit dhe gjithandej Kosovës janë zhvilluar në sërë protestash, apeli i të cilëve vazhdimisht ishte të zbulohen orkestruesit e vërtetë të 9 dhe 10 majit të vitit 2015. Aktgjykimet e shkallës së parë në rastin e Lagjes së Trimave, siç janë shprehur shumë herë deri më tani avokatët mbrojtës të të akuzuarve, ende nuk u janë dorëzuar klientëve të tyre. Lidhur me këtë çështje, nga GJPSH kanë thënë se përkthimi i aktgjykimëve paraqet arsyen kryesore se pse të akuzuarit e Lagjes së Trimave edhe më tej nuk i kanë pranuar vendimet e gjykatës. Zvarritja e kësaj procedure, sipas avokatëve të Grupit të Kumanovës, paraqet pengesën kryesore për mos parashtrimin e ankesës para Gjykatës së Apelit.

Në përvjetorin e "luftës së vogël" në Kumanovë, kryeministri Zoran Zaev në një pyetje të parashtruar nga gazeta KOHA, ka theksuar se ai i qëndron prapa fjalëve të dhëna më herët dhe se asistencë ndërkombëtare për "Lagjen e Trimave", gjithsesi do të bëhet.

"Ne e kemi përsëritur dhe qëndrojmë pas asaj që kemi deklaruar së rasti i 'Lagjes së Trimave' duhet të shqyrtohet edhe përmes ekspertizës ndërkombëtare. Në bazë të normativës pozitive të Maqedonisë, ne kemi konstatuar se nuk është e mundur që ndihma ndërkombëtare të përfshihet përdërisht procesi gjyqësor ende po vazhdon. Fillimisht kjo lëndë duhet të bëhet e plotfuqishme nga të gjitha instancat gjyqësore dhe më pas të

krijohen mundësitë për ndërhyrjen e përfaqësuesve të huaj, në cilësinë e komentuesve apo personave që nga afër do të monitorojnë këtë proces", tha kryeministri Zaev.

Roli i pjesëtarëve të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim në organizimin e "Grupit të Kumanovës", mendohet të jetë trajektorja kryesore përmes të cilës do të realizohet asistencë ndërkombëtare për "Lagjen e Trimave". Shkeljet e Ligjit për procedurë penale, konkretisht mos përfillja e palës mbrojtëse në këtë proces gjyqësor, nga gjykatësja Verka Petrovska, po ashtu pritet të jetë lëndë shqyrtimi i instancave më të lartë gjyqësore në vend. Refuzimi i mbi 200 provave, përfshirë një numër të konsiderueshëm të dëshmitarëve, për të cilën avokatët e të akuzuarve në "Lagjen e Trimave" vlerësojnë se dukshëm do të kontribuojnë në zbardhjen e tërësishme të rastit, vazhdon të mbetet ndër dilemat kryesore që e karakterizuan procesin kontrovers gjyqësor. Kërkesa e avokatëve që e ish-funksionarët e lartë të MPB-së, siç janë Gordanan Jankullovska, Sasho Mijallkov e Mitko Çavkov të paraqiten në Gjykatë si

dëshmitarë, kategorikisht u refuzua nga dyshja e Trupit gjykues me arsyetim se të njëjtit është dashur të propozohen në fillim të procesit gjyqësor. Në mesin e dëshmitarëve, të cilat i kërkuar të akuzuarit dhe avokatët e tyre, ishte edhe Ali Ahmeti, Artan Grubi, Ejup Alimi e Sadullah Duraku, të gjithë këto funksionarë të lartë të BDI-së, mirëpo Gjykata nuk pati mirëkuptim as që këto person t'i ftojë si dëshmitarë. Në mesin e shumë dëshmitarëve, gjykatësja Verka Petrovska çuditërisht pranoi që si dëshmitar në seancë të paraqitet vetëm punonjësi i Agjencisë për Zbulim, Shenasi Mehmeti, i cili drejtpërdrejtë akuzohet se ka pasur kontakt me Mirsad Ndrecajn dhe Beg Rizajn, tashmë të vrarë. Megjithatë, me një shkresë zyrtare drejtuar Gjykatës, nga Agjencia për Zbulim u tha se agjenti tyre nuk mundet të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit, pasi ekziston mundësia e shpalosjes së ndonjë sekretit shtetëror.

Ndryshe, nga gjithsej 38 të akuzuar për ngjarjet e "Lagjes së Trimave", vitin e kaluar 31 persona u dënuam me burg prej 746 viteve, gjegjësisht 7 prej tyre u dënuan me burg të përjetshëm.

SPASOVSKI PËRKUJTON "TIGRAT" E VRARË

Përmes një postimi në rrjetin social Fejsbuk, Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, të mërkurën i ka përkujtuar 9 pjesëtarë e policisë speciale, të cilët më 9 dhe 10 maj të vitit 2015 u vranë në përlëshje me "Grupin e Kumanovës". Po ashtu, MPB-ja në njoftim zyrtar ka theksuar se përgjegjësit për ngjarjet e Kumanovës të vitit 2015 do të përgjigjen. "Kumanova dhe 'Lagja e Trimave' e 9 dhe 10 maj 2015,



asnjëherë mos të përsëritet. Në një pusi, për shkak të motive të fshehura, në mënyrë monstruoze ndërruan jetë tetë pjesëtarë të MPB-së. Ky rast asnjëherë nuk duhet të përsëritet. Pjesëtarët e policisë janë këtu për ta mbrojtur shtetin dhe qytetarët, dhe jo për të qenë viktimë të interesave të caktuara", ka shkruar Spasovski. Në mesin e tetë policëve të vrarë tre vite më parë, u gjend edhe polici shqiptar nga fshati Studeniçan i Shkupit, Isamedin Osmani.

KRONIKË

Konfiskohet marihuanë, arrestohet tetovari

Pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, të martën pasdite kanë kryer kontroll në shtëpinë dhe hapësirat ndihmëse të 32-vjeçarit F.H. nga Tetova, në rrugën "Mirçe Acev" në Tetovë. Gjatë kontrollit të kryer me urdhër të gjykatës, janë gjetur 9 plumba të kalibrit 6.35 milimetër, peshore elektronike, 7 qese najloni me marihuanë, 2 telefona celularë, foli speciale dhe 33 mijë denarë të bankënotave të ndryshme. Qeset e najlonit me marihuanë janë gjetur në dy veturat e tij të parkuara edhe atë "Golf 2" dhe furgon "Fiat Dukato". Gjësendet e gjetura gjatë kontrollit janë fotodokumentuar dhe janë marrë për ekspertizë, kurse F.H. është arrestuar dhe është mbajtur deri në zbardhjen e plotë të rastit, ku ndaj tij do të inicohet padi adekuate.

Mbyllet bastore në fshatin Ratajë

Të martën pasdite vonë është kryer kontroll në objekt në fshatin Ratajë të Tetovës, i cili ka punuar në mënyrë ilegale, si bastore sportive, ku pa licencë janë organizuar lojëra të fatit. Në objekt është takuar personi M.P. 27-vjeç nga fshati Glogjë, si i punësuar. Gjatë kontrollit janë gjetur dhe janë marrë me vërtetim, tre televizorë, shtëpizë kompjuteri, monitorë, printer, lexues barkodi, tastaturë dhe maus. Punohet në zbardhjen të gjitha detajeve në veçanti lidhur me punën ilegale të objektit, kurse ndaj pronarëve do të inicohen padi adekuate.

Djali rreh babain në Gostivar

Të mërkurën në orët e para të mëngjesit, personi Xh.M. 61-vjeçar nga Gostivari, ka paraqitur dhunë familjare, të cilën e ka kryer djali i tij H.M. 30-vjeçar. Paraprakisht, djali i cili ka qenë në gjendje të alkoolizuar, së pari ka filluar zënkë verbale me babain e tij, pastaj edhe fizikisht i ka sulmuar prindërit e tij, duke i rrahur në pjesë të kokës dhe trupit. Menjëherë pas paraqitjes së rastit, ai është arrestuar dhe është mbajtur në Stacionin Policor në Gostivar, ku punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Grabitet pompa e benzinës në rrugën "Pero Nakov"

Dy persona të panjohur herët në mëngjes kanë kryer vjedhje dhe kanë marrë gjashtë mijë denarë nga pompa e benzinës në rrugën "Pero Nakov", kumtoi policia. Në Sektorin për punë të brendshme Shkup në orën 4.15 është denoncuar se në pompën e benzinës në rrugën "Pero Nakov" dy persona të panjohur duke u kanosur me pistoletë kanë kryer vjedhje dhe kanë marrë 6.000 denarë pas çfarë me motoçikletë ke kanë braktisur vendin e ngjarjes. Po ndërmerren masa për ndriçimin e plotë të rastit

Aksidentohet 58 vjeçari me motoçikletë

Në rrugën regjionale Tetovë-Zhelinë, rreth orës 11.00, motoçikletë e tipit "Kivej" me targa të Tetovës, të cilën pa leje për vozitje e ka drejtuar personi E.M. 58-vjeçar nga Tetova për shkak të shpejtësisë së papërshtatshme ka humbur kontrollin dhe ka dalur nga rruga. Personi E.M. ka marrë lëndime të rënda trupore frakturë në hundë, ku me veturë tjetër është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, ku është ndaluar për mjekim të mëtutjeshëm. (U.H)

PSP NË SEANCËN PËR RASTIN "TITANIK"

TË KONFISKOHEM PRONA E GRUEVSKIT

Në aktakuzë është cekur se Gruevski dhe Protugjer në vitin 2011 kanë siguruar mbi 500 mijë euro me urdhëresa pagesore të paguara në xhiro llogarinë zgjedhore nga Dalibor Neshkoviç i koalicionit të VMRO-DPMNE-së si donacion i 529 personave fizik

Koha

Omer XHAFFERI



Shkup, 9 maj - Prokurorët e Prokurorisë Speciale Publike në seancën e djeshme për "Titanikun" kërkuan nga Gjykata që t'u konfiskohet prona të akuzuarve Nikolla Gruevski dhe Martin Protugjer në vlerë prej 34.908.000 denarëve. Konfiskimi i pronës që i përgjigjet mjeteve joligjore të siguruar, prokurorët kërkuan edhe për të akuzuar të tjerë në këtë rast. Paraprakisht, këshilli gjyqësor e hodhi poshtë si të palejueshme kërkesën e mbrojtjes për përjashtim të prokurores speciale publike Katica Janeva. Avokati Dimitar Dangov kërkoi nga Gjykata që vendimi me të cilin u refuzua kërkesa për përjashtim, t'i parashtrahet mbrojtjes në formë juridike formale me të drejtë ankese. Por, gjykatësi Osman Shabani e refuzoi

kërkesën e tij. Para fillimit të debatit kryesor, Dangov kërkoi që Gjykata të sigurojë edhe një kamerë e cila do ta xhirojë këshillin gjyqësor.

Prokurorja e PSP-së, Lile Stefanova, duke e arsyetuar aktakuzën, tha se paraqet bashkim kriminel për të cilin ekzistojnë shumë dëshmi. Ajo theksoi se do të dëshmojnë se për zgjedhjet në vitin 2013, për zgjedhje të deputetëve nga diaspora, të akuzuarit Gruevski, Janakieski dhe Jankullovska kanë formuar grup për t'i fituar vendet e deputetëve në mënyrë joligjore. Sipas PSP-së, gjatë zgjedhjeve në vitet 2011, 2013 dhe 2014 ata në mënyrë joligjore kanë grumbulluar mjete për partinë së cilës i takojnë. Gjatë zgjedhjeve në vitet 2011, 2013 dhe

2014, siç tha Stefanova, kanë kryer vepër penale për financim të fushatës.

Në aktakuzë është cekur se Gruevski dhe Protugjer në vitin 2011 kanë siguruar mbi 500 mijë euro me urdhëresa pagesore të paguara në xhiro llogarinë zgjedhore nga Dalibor Neshkoviç i koalicionit të VMRO-DPMNE-së si donacion i 529 personave fizik. "Në vitin 2011 Gruevski, Janakieski, Protugjer dhe Kiril Bozhinovski kanë marrë me qira pajisje të paguar nga Transmet në shumë mbi tre milionë denarë, të cilat nuk i kanë futur në regjistrin e donacioneve, ndërsa për atë do të dëshmojnë edhe persona nga kompanitë", tha Stefanova. Në vitin 2013, siç është cekur në aktin e

prokurorisë, Ilija Dimovski dhe Leko Ristevski në mënyrë të jashtëligjshme kanë siguruar 470.000 euro njëjtë si i akuzuari Dalibor Neshkoviç dhe i kanë paguar si donacione nga persona fizik, ndërsa për këtë, sipas PSP-së do të dëshmojnë donatorët e supozuar. Në vitin 2014, ndërkaq, Ilija Dimovski dhe Leko Ristevski në mënyrë të paligjshme kanë siguruar 52.233.654 denarë dhe përmes Dalibor Neshkoviç kanë futur në xhiro llogari si pagesë të anëtarësisë nga anëtarë të supozuar. PSP në dëshmitë do ta prezantojnë edhe listën zgjedhore me qytetarë të cilët ishin shënuar si votues të partisë në pushtet dhe ata të cilët me presion është dashur të përfitohen. Siç theksoi

prokurorja Stefanova, nga PSP do të dëshmojnë se të akuzuarit kanë formuar para-polici gjatë zgjedhjeve në Ohër, për të bërë presion ndaj qytetarëve. "Gruevski nga Jankullovska ka kërkuar të organizojë persona nga Shqipëria për të marrë letërnjoftime dhe të hyjnë në listat zgjedhore në Kërçovë, Qendër dhe Resnjë", tha Stefanova dhe shtoi se i akuzuari Edmond Temellko u ka dhuruar nga 20 euro personave nga Shqipëria të cilët kanë votuar për VMRO-DPMNE-në. Gjykimi për rastin "Titanik" do të vazhdojë më 21 maj me paraqitje hyrëse të përfaqësuesve të mbrojtjes. Në "Titanik" të akuzuar janë ish-kryeministri Nikolla Gruevski dhe ish-funksionarët Martin Protugjer, Kiril Bozhinovski, Mile Janakieski, Gordana Jankullovska, Biljana Bishkoska Boshkovski, si dhe Ilija Dimovski, Munir Pepiq, Edmond temellko, Leko Ristovski, Kiril Todorovski, Katerina Vellovska, Stanko Korunovski, Kosta Markovski, Dragçe Dragçeski, Marjan Nakevski, Goce Janevski, Xhezmi Ahmet, Robert Davitkov, Dalibor Aleshkoviç dhe Lenka Rashajkovska.

Ata janë të akuzuar nga PSP për bashkim kriminel, shkelje të së drejtës zgjedhore, shkelje të lirive dhe përcaktim të votuesve, rryshfet gjatë zgjedhjeve dhe votimit, shkatërrim të materialit zgjedhor dhe keqpërdorim të mjeteve për financim të fushatës zgjedhore në vitin 2012.

AMEJLI SHKRUAN KRYEMINISTRIT MALAZEZ, DUSHKO MARKOVIQ

NDALUJINI SULMET NDAJ GAZETARËVE



Shkup, 9 maj - Mbrëmë në Podgoricë ka ndodhur tentim vrasje e Olivera Lakiç, gazetare e së përditshmes Vijesti e Malit të Zi, para shtëpisë së saj familjare, në një pjesë shumë të populluar të qytetit, para syve të shumë kalimtarëve. Ky është sulmi i dytë me radhë ndaj Olivera Lakiç, me sa duket për qëllim që gazetaria e lirë e një medie të pavarur dhe profesionale, e cila merret me hetimin e kriminit të organizuar, ta heshtin një herë e përgjithmonë. Kështu thuhet në një letër të hapur të Vuk Marash, drejtor ekzekutiv i Aso-

ciacionit të Mediave të Evropës Juglindore (AMEJL), drejtuar kryeministrit Dushko Markoviç, ndërsa shprehet shqetësimi serioz për sigurinë e të gjitha mediave të pavarura dhe profesionale në Mal të Zi, duke pasur parasysh se deri më tani, nuk ka ndonjë progres në ndriçimin e sulmit të dytë radhazi ndaj Olivera Lakiç.

"Mënyra se si është realizuar tentim vrasja e Olivera Lakiç tregon se sulmuesit me sa duket nuk kanë patur asnjë lloj frike për të zbatuar planin e tyre. Kjo nuk është befusuese, duke pasur parasysh se Mali i Zi deri tani nuk ka bërë asgjë për të ndriçuar sulmet e mëparshme, si atë ndaj Olivera Lakiç ashtu edhe ndaj gazetarëve dhe mediave të tjera të pavarura, të lira dhe profesionale, si dhe ndaj pronave të mediave. Gjithashtu, kjo sjellje nuk është për t'u

habitur pasi duke patur parasysh se para më pak se një muaj, Milo Gjukanoviç, presidenti i zgjedhur i Malit të Zi, median në të cilën punon Olivera Lakiç, e ka quajtur fashiste dhe shantazhuese, gjë që jo vetëm që e ka vënë nën thjerrëz gazetën Vjesti, por edhe të gjithë punonjësit e saj", thuhet në letrën e Marashit drejtuar Markoviçit.

Detyrimi i shtetit, vazhdon të tej letra, gjegjësisht Qeverisë drejtues i së cilës jeni ju për gati një vit e gjysmë, është për të mbrojtur të gjithë gazetarët dhe mediat nga ndonjë sulm fizik, persekutimi apo gjuhë e urrejtjes. "Gjithashtu, është detyrë e shtetit të ndriçojë të gjitha sulmet e mëparshme ndaj gazetarëve dhe mediave. Për fat të keq, deri tani, Ju, z. Markoviç nuk i keni bërë asgjë në lidhje me këtë. Ju, të paktën as gojarisht nuk keni

mbrojtur gazetarët nga gjuha e urrejtjes së shëfit tuaj të partisë, nuk keni mbrojtur Olivera Lakiç, e cila edhe para tentim vrasje mbrëmshme, ka qenë e sulmuar, por nuk keni bërë asgjë në mënyrë që të zbardhen disa nga rastet më të vjetra të sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave ndër vite dhe që nuk është bërë asnjë hap. Kryeministër, vendi në të cilin një gazetar për punën e tij "shpërblehet" me një plumb përpara shtëpisë së tij, është larg të qenit demokratik. Akti monstruoze i vrasjes në tentativë të Olivera Lakiçit që ka ndodhur mbrëmë tregon se liria e medias është vetëm një floskulë imagjinare, inekzistente, në një situatë ku autoritetet nuk po bëjnë asgjë për të zbuluar dhe ndjekur aktorët dhe porositësit e kësaj dhe shthurjeje të ngjashme".

Mali i Zi, shkruan drejtori i AMEJL-së, nuk ka më kohë për të pritur. "Ne ju ftojme që sa më shpejtë, pa vonesë, të bëni zbulimin e kryerësve dhe porositësve të tentimit të vrasjes së Olivera Lakiçit dhe sulmeve të tjera ndaj gazetarëve dhe mediave të lira. Veprimi ose joveprimi i juaj konkret në këtë rast në mënyrë të qartë do të tregojë se në anën e cilit jeni ju – gazetarëve të lirë, të cilët po hetojnë krimin e organizuar, për çka vuajnë pasojat e tmerrshme apo të tjerëve, të cilat janë temë e shkrimeve të atyre gazetarëve. Asociacioni i Mediave të Evropës Juglindore do të vazhdojë të monitorojë me vigjilencë të gjitha hapat që do të ndërmarrin institucionet e Malit të Zi, në mënyrë që të zbardhet tentim vrasja e Olivera Lakiç, si dhe sulmet ndaj gazetarëve të tjerë dhe mediave".

Manushaqe Ymeri, profesoreshë në shkollën e mesme të ndërtimitarisë "Zdravko Cvetkovski" në Shkup, shpreh keqardhje që nuk ka interesim për paralelet e ndërtimitarisë dhe gjeodezisë në gjuhën shqipe. "Për paralelet e arkitekturës interesimi është i madh, por për fat të keq mungon interesimi për ndërtimtarinë dhe gjeodezinë", vëren Ymeri

SHKOLLAT PROFESIONALE ME PERSPEKTIVË NË TREGUN E PUNËS



montues për ndërtime të thata dhe mirëmbajtës i instalimit të oxhaqeve. "Të gjitha drejtimet e shkollës sonë u japin mundësi nxënësve të zbatojnë në praktikë gjithë atë çfarë mësojnë", pohon ajo, ndërsa shpreh keqardhje që nuk ka interesim për paralelet e ndërtimitarisë dhe gjeodezisë në gjuhën shqipe.

"Për paralelet e arkitekturës interesimi është i madh, por për fat të keq mungon interesimi për ndërtimtarinë dhe gjeodezinë", vëren Ymeri.

Shkolla të tjera profesionale me perspektivë është edhe ajo e komunikacionit "Vllado Tasevski", e autokomunikacionit "Boro Petrushevski", e elektroteknikës "Mihajlo Pupin", e makinerisë "8 Shtatori" apo e shërbimeve personale "Dimitar Vllaho", ku për paralelet me mësim në gjuhën shqipe janë planifikuar (sipas radhës) nga 4, 5, 5, 4 dhe 6 paralele. Shkolla të tjera me paralele në gjuhën shqipe në qytetin e Shkupit janë gjimnazi "Zef Lush Marku" me 16 paralele, e tekstilit "Koço Racin" me 4 paralele, e bujqësisë "Vëllezërit Milladinovci" me 8 paralele, e pylltarisë "Gorgji Dimitrov" me 1 paralele, e mjekësisë "Pance Karagjovov" me 7 paralele, e ekonomisë "Arseni Jovkov" me 8 paralele, e tregtisë "Cvetan Dimov" me 9 paralele, e hotelarisë "Llazar Tanev" me 2 paralele, e kimisë "Maria K. Skllodovska" me 5 paralele, shkolla e mesme "Sara" me 6 paralele, muzikës dhe baletit "Ilija N. Luji" me 1 paralele, e artit figurativ "Llazar Liçenovski" me 1 paralele dhe gjimnazi sportiv "Metodia M. Brico" me 2 dy paralele. Pra, në shkollat e Shkupit, gjysmëmaturantët shqiptarë do të kenë 101 paralele, ndërsa në qytete tjera oferta e këtij viti është me sa vijon: Manastiri me 3 paralele, Velezi me 3 paralele, Vrapçishti me 4 paralele, Kostivari me 29 paralele, Dibra me 6 paralele, Kërçova me 13 paralele, Kumanova me 34 paralele, Likova me 4 paralele, Ohri me 2 paralele, Prespa me 2 paralele, Struga 16 paralele dhe Tetova me 75 paralele.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 9 maj - Shkollat e kryeqytetit siç edhe pritet, vite me radhë gjenden në krye të listës sa i takon numrit të vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme. Kështu ndodh edhe me ofertën e vitit shkollor 2018/2019, ku në nivel të të gjitha shkollave komunale dhe shtetërore të qytetit të Shkupit, janë planifikuar të formohen 312 paralele me 10.908 vende të lira, nga gjithsej 1032 paralele me 35.088 vende në nivel të shtetit. Pjesa dërmuese e paraleleve në Shkup do të jenë në gjuhën maqedonase edhe atë 205 paralele me 6970 vende, ndërsa për paralelet me mësim në gjuhën shqipe janë planifikuar 101 sosh me 3434 vende. Në gjuhën turke është planifikuar të formohen 6 paralele me 204 vende.

Për të gjitha gjuhët në të cilat zhvillohet arsimiti mesëm në Maqedoni, numri i vendeve të planifikuar si total është më i madh se numri i gjysmëmaturantëve që pritët të përfundojnë arsimin fillor këtë vit. Në këtë prizëm është e natyrshme që shumë vende të mbesin të paplotësuara dhe, nëse ai mosplotësim është linear - nuk ka përse të

DREJTIME QË NUK DUHET HUMBUR

jetë një dukuri shqetësuese. Mirëpo, nuk është ky rasti me paralelet në gjuhën shqipe, sidomos në qytetin e Shkupit. Shumë drejtime të shkollave profesionale me perspektivë për tregun e punës mbeten jashtë interesimit të nxënësve shqiptarë dhe kjo ka bërë jo vetëm që të ngushtohet rrejtja e shkollave të mesme në të cilat mësohet në gjuhën shqipe, por edhe të limitohen kapacitetet kadrovike si për prodhimin e kuadrove, ashtu edhe për krijimin e vendeve të punës në ato profile. Ndodh madje që brenda vetë shkollave disa drejtime të preferohen më shumë dhe të tjerat aspak, sikurse është rasti me Shkollën e Mesme të Ndërtimitarisë "Zdravko Cvetkovski" në Shkup. Profesoresha Manushaqe

Ymeri thotë se ka ndryshueshmëri të madhe sa i përket interesimit që tregojnë nxënësit shqiptarë për paralelet e drejtimeve të arkitekturës, gjeodezisë dhe dizajnit.

"Paralelet e Gjeodezisë edhe pse janë atraktive për tregun e punës dhe krijojnë lehtësira si në studimet e mëtejshme ashtu edhe në sigurimin e vendeve të punës, nuk tërheqin sa duhet nxënësit shqiptarë. Në këto paralele çdoherë regjistrohen shumë më pak nxënës se sa në paralelet e arkitekturës", thotë Ymeri. Të gjitha drejtimet, patjetër që janë të rëndësishme, por nuk është mirë që të gjithë të orientohemi në një drejtim. Duhet që nxënësit shqiptarë të krijojnë paralele në numër më të madh drejtimesh pro-

fesionale, plotëson profesoresha e SHMN "Zdravko Cvetkovski". Kjo, porosit më tej ajo, do t'ju zgjeron më tepër mundësitë e punësimit si për ata që do të vendosin të regjistrohen nëpër fakultetet përkatëse, ashtu edhe për ata që do të ndërpresin shkollën e arsimimit pas kryerjes së nivelit të mesëm. Për vitin shkollor 2018/2019, në këtë shkollë janë planifikuar të formohen 21 paralele, prej të cilave 15 në gjuhën maqedonase dhe 6 në gjuhën shqipe. Këta të fundit, krahas drejtimeve katërvjeçare: teknik i arkitekturës, teknik i ndërtimitarisë, teknik i gjeodezisë dhe teknik dizajner për arkitekturë të brendshme, janë planifikuar edhe paralele me kohëzgjatje dyvjeçare:

EUROSTAT PUBLIKON RAPORTIN E VARËSISË SË PLAKJES

Serbët plaken më shpejt, Maqedonia më mirë në rajon

Koha Evis HALILI

Shkup, 9 maj - Pothuajse një në pesë persona në Bashkimin Evropian (BE) është 65 vjeç ose mbi këtë moshë. Sipas statistikave të bëra publike nga EUROSTAT-i, rreth 19.4% e një popullsie prej gati 100 milionë banorësh janë 65 vjeç ose më shumë. Raporti i varësisë së plakjes tradicionalisht shihet si një tregues i nivelit të mbështetjes në dispozicion të personave të moshuar (të moshave 65 vjeç e lart) nga popullata në moshë pune (të moshës 15 deri në 64 vjeç). Në BE, raporti i varësisë së plakjes ishte 29.9% në vitin 2017. Sipas studimit, për çdo person të moshës 65 vjeç e lart kishin pak më shumë se tre persona në moshë pune. Raporti i varësisë së

Sipas të dhënave zyrtare të EUROSTAT-it, në vendet jo anëtarë të Bashkimit European, Shqipëria e ka raportin e varësisë së plakjes 19.1%. Serbia kryeson këtë listë më një përqindje më të lartë, prej përkatësisht 29.2%, e ndjekur nga Mali i Zi me 21.4%. Me një përqindje më të ulët shfaqet Maqedonia, me 18.9%

plakjes së BE-së është rritur për një kohë të gjatë. Njëzet vjet më parë, kishte rreth pesë persona në moshë pune, për çdo person të moshës 65 vjeç e lart. Dhjetë vjet më vonë, raporti ishte 4:1 dhe sot është afërsisht 3:1.

Sipas të dhënave zyrtare të EUROSTAT-it, edhe për vendet jo anëtarë të Bashkimit European, Shqipëria e ka raportin e varësisë së plakjes 19.1%. Krahasuar me rajonin, Serbia kryeson këtë listë më një përqindje më të lartë, prej përkatësisht 29.2%, e ndjekur nga Mali i Zi me 21.4%, më pas vendi Shqipëria. Me një përqindje më të ulët shfaqet Maqedonia, me 18.9%. Në vitin 2017, në vendet anëtare të BE-së, raporti i varësisë së plakjes ishte më i lartë në Itali (34.8%), Greqi (33.6%)

dhe Finlandë (33.2%), pasuar nga Portugalia (32.5%) dhe Gjermania (32.4%). Në anën tjetër, raportet më të ulëta janë regjistruar në Luksemburg (20.5%) dhe Irlandë (20.7%), përpara Sllovakisë (21.5%) dhe Qipros (22.8%). Në këto Shtete Anëtare, kishte rreth pesë persona të moshës së punës për çdo person të moshuar. Shifrat tregojnë se ky raport është në rritje në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, përveç Luksemburgut.

Gjatë dy dekadave të fundit, raporti i varësisë së plakjes është rritur në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, me përjashtim të Luksemburgut, ku ajo ka rënë nga 21.2% në 1997 në 20.5% në 2017 (-0.7 pikë përqindje). Rritjet më të mëdha midis viteve 1997 dhe 2017 u regjistruan në Fin-

landë (nga 21.7% në 33.2% ose +11.5 pikë përqindjeje), Malta (+10.7 pikë përqindjeje), Sllovenia (+10.1 pikë përqindjeje), Lituania dhe Portugalia (të dyja 9.8 pikë përqindjeje), Italia (+9.6 pikë përqindjeje), Gjermania dhe Letonia (të dyja +9.4). Në të kundërt, rritjet ishin më të moderuara në Irlandë (nga 17.4% në 1997 në 20.7% në 2017, ose +3.3), Mbretëria e Bashkuar (+3.7), Belgjika (+3.9) dhe Suedia (+4.2). Sipas metodologjisë së EUROSTAT-it, Raporti i varësisë së moshës së vjetër (plakjes) është raporti i numrit të personave të moshuar në një moshë kur ata janë në përgjithësi ekonomikisht joaktive (pra 65 vjeç e lart), në krahasim me numrin e njerëzve të moshës së punës (p.sh. 15-64 vjeç).


QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT
SHPALLJE PUBLIKE
për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes publike
“Rrugë dhe rrugica” – Shkup

- Kandidatët për zgjedhjen e drejtorit duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - të jenë nënshtruar të Republikës së Maqedonisë;
 - të posedojnë së paku 240 kredi sipas ECTS ose të kenë përfunduar nivelin VII/1 të arsimit;
 - në momentin e emërimit, me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - të posedojnë së paku pesë vite të përvojës së punës;
 - të posedojnë një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare ose të vërtetimeve për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetra se pesë vite, me sa vijon: TOEFEL IBT (TOEFL iBT) – së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë, ILEC (ILEC Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE Cambridge English: First) provimi i dhënë ose BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë, ose APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2).
- Vërejtje: nëse kandidati nuk e përmbush kushtin e paraparë në pikën 1 alineja 5 nga kjo shpallje në lidhje me njohjen e gjuhës angleze, ai është i obliguar që këtë kusht ta përmbush në afatin prej një viti nga dita e emërimit të tij, në të kundërtën atij do të pushohet mandati (në pajtim me nenin 13 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për ndërmarrjet publike – Gazeta zyrtare e RM-së nr. 64/2018).**
- Kandidatët për drejtor, përkaj dëshmime për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura duhet të dorëzojnë edhe dokumentet vijuese:
 - fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
 - propozim programin e punës dhe zhvillimit të ndërmarrjes.
- Dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët janë të detyruar që ta dorëzojnë në origjinal ose kopje të verifikuar te noteri.
- Afati i parashtrimit të dokumentacionit të nevojshëm është 7 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike në shtypin ditor.
- Fletëparaqitjet e kandidatëve dorëzohen deri te arkivi i Qytetit të Shkupit në barakën nr. 16 – me shenjën Kryetari i Qytetit të Shkupit – Për shpalljen publike për zgjedhjen e drejtorit të NP “Rrugë dhe rrugica” – Shkup.
- Drejtori zgjidhet me mandatin prej 4 viteve.
- Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Qyteti i Shkupit
 Kryetari i Qytetit të Shkupit
 Petre Shilegov


QYTETI I SHKUPIT
KRYETARI I QYTETIT


Bul. Ilinden 82
 1000 Shkup
 www.skopje.gov.mk
 tel: 02/3 297 204

Numri ynë: _____

Shkup

Në bazë të nenit 50, paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 23 të Ligjit për ndërmarrjet publike (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 38/1996; 9/1997; 6/2002; 40/2003; 49/2006; 22/2007; 83/2009; 97/2010; 6/2012; 119/2013; 41/2014; 138/2014; 25/2015; 61/2015; 39/2016 dhe 64/2018), dhe në pajtim me Vendimin për publikimin e shpalljes publike për zgjedhjen e Drejtorit të “Ndërmarrjes së qarkullimit publik” – Shkup, nr. 08 - _____/1 të datës ____05.2018, Kryetari i Qytetit të Shkupit, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
për zgjedhjen e drejtorit të
“Ndërmarrjes së qarkullimit publik” – Shkup

- Kandidatët për zgjedhjen e drejtorit duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - të jenë nënshtruar të Republikës së Maqedonisë;
 - të posedojnë së paku 240 kredi sipas ECTS ose të kenë përfunduar nivelin VII/1 të arsimit;
 - në momentin e emërimit, me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - të posedojnë së paku pesë vite të përvojës së punës;
 - të posedojnë një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare ose të vërtetimeve për njohje aktive të gjuhës angleze, jo më të vjetra se pesë vite, me sa vijon: TOEFEL IBT (TOEFL iBT) – së paku 74 pikë, IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë, ILEC (ILEC Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2 (B2), FCE (FCE Cambridge English: First) provimi i dhënë ose BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë, ose APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2).
- Vërejtje: nëse kandidati nuk e përmbush kushtin e paraparë në pikën 1 alineja 5 të kësaj shpallje në lidhje me njohjen e gjuhës angleze, ai është i obliguar që këtë kusht ta përmbush në afatin prej një viti nga dita e emërimit të tij, në të kundërtën atij do të pushohet mandati (në pajtim me nenin 13 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për ndërmarrjet publike – Gazeta zyrtare e RM-së nr. 64/2018).**
- Kandidatët për drejtor, përkaj dëshmime për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura duhet të dorëzojnë edhe dokumentet vijuese:
 - fletëparaqitje me biografi të shkurtër;
 - propozim programin e punës dhe zhvillimit të ndërmarrjes.
- Dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët janë të detyruar që ta dorëzojnë në origjinal ose kopje të verifikuar te noteri.
- Afati i parashtrimit të dokumentacionit të nevojshëm është 7 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike në shtypin ditor.
- Fletëparaqitjet e kandidatëve dorëzohen deri te arkivi i Qytetit të Shkupit në barakën nr. 16 – me shenjën Kryetari i Qytetit të Shkupit – Për shpalljen publike për zgjedhjen e drejtorit të “Ndërmarrjes së qarkullimit publik” – Shkup
- Drejtori zgjidhet me mandatin prej 4 viteve.
- Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Qyteti i Shkupit
 Kryetari i Qytetit të Shkupit
 Petre Shilegov

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015-teksti i pastruar) dhe nenit 142 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013), UD Drejtori i IPKCF “Estreja Ovalija – Mara” Manastir publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar
1. Edukator për fëmijët e moshës prej 2-6 vjeç – 3 (tre) persona për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme**
- Profesor i diplomuar i lartë/sipëror për edukim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar të shkallës VII/1 ose me arsim të lartë të mbaruar përkatës për edukatorë
- pa përvojë pune
- licencë valide për edukatorë
- Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat ndahen në 30 orë për punë të drejtpërdrejtë me fëmijë, dhe koha e mbetur për aktivitete të tjera, prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i kohës së punës caktohet në mënyrë të shkallëzuar në kuadër të orarit të punës prej ora 5:30 deri në ora 18:00.
- Neto pagesa bazë është 19.574 denarë për përgatitje sipërore profesionale ose 18.506 për përgatitje të lartë profesionale.

2. Përkëdhelës - 1 (një) person për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme**
- PMP – arsim të mesëm katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës
- pa përvojë pune
- licencë valide për përkëdhelës
- Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat janë të shpërndara në 35 orë për punë drejtpërdrejtë me fëmijë, ndërsa koha tjetër për aktivitete të tjera prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i punës është me shkallë në kuadër të orarit të punës prej ora 5:30 deri në ora 18:30.
- Neto pagesa bazë është 14.772 denarë.

3. Enëlarës -1 (një) person për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme**
- Arsim fillor
- pa përvojë pune
- Orari i punës është 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 8:30 deri në ora 16:30.
- Neto pagesa bazë është 11.998 denarë.

4. Furnizues-vozitës -1 (një) person për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme**
- PMP – arsimi i mesëm katërvjeçar – drejtimi ekonomik ose 180 kredi shkenca ekonomike
- pa përvojë pune
- Leje të vozitjes të kategorisë B
- Orari i punës është 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 8:30 deri në ora 16:30.
- Neto pagesa bazë është 13.185,00 denarë.
- Krahas kushteve të posaçme të theksuara kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme ligjore.

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Diplomë (Certifikatë), Dëftesë për arsimin e mbaruar përkatës (origjinal ose kopje të vërtetuar);
- Licencë valide (për edukator dhe përkëdhelës)
- Certifikatë të shtetësisë së RM (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
- Certifikatë të lindjes
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj).
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën do dënohet për veprë penale dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Shpallja zgjatë pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit të saj.
 Zgjedhja do të realizohet në afat prej dyzetepesë (45) ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i kompletuar të dorëzohet në adresën: IPKCF “Estreja Ovalija – Mara” – Manastir, rr. “Naum Naumovski Borçe” pn, Manastir.
 Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IPKCF “Estreja Ovalija – Mara”
 MANASTIR



Ministria e punës dhe politikës sociale
 Projekti për avancim të shërbimeve sociale

THIRRJE PUBLIKE
Për mbajtjen e tri debateve publike për dokumentet
“Korniza për menaxhim me mjedisin jetësor dhe çështje sociale” dhe “Korniza e politikës
për politikën e zhvendosjes” për Projektin për avancim të shërbimeve sociale

Në organizim të Ministrisë së punës dhe politikës sociale do të mbahen tri debate publike me qëllim të prezantimit dhe debatit publik për dokumentet “Korniza për menaxhim me mjedisin jetësor dhe çështje sociale” dhe “Korniza e politikës për politikën e zhvendosjes” për Projektin për avancim të shërbimeve sociale që do të financohet përmes huas nga Institucioni ndërkombëtar financiar për rinovim dhe zhvillim (IBRD).

Debatet publike do të mbahen në lokacionet në vijim dhe në terminet në vijim:

- **Më datë 14.05.2018 në Komunën e Tetovës në adresën rr. Dervish Cara pn, me fillim të debatit publik në ora 10:00.**
- **Më datë 14.05.2018 në Komunën e Shtipit në adresën rr. Vasil Gllavinov nr. 4B në Shtip, me fillim të debatit publik në ora 14:00.**
- **Më datë 15.05.2018 në Ministrinë e punës dhe politikës sociale – Qendra për veprimtari sociale në adresën rr. 11-ti Oktomvri nr. 42a (ndërtesa e OSHH Dare Xhambaz) në Shkup, me fillim të debatit publik në ora 11:00.**

Projekti ka për qëllim të përmirësojë qasjen deri te shërbimet për përkujdesje, edukim dhe arsimim të fëmijëve të moshës parashkollore dhe qasjen deri te kompensimet dhe shërbimet sociale. Me projektin parashihet përmirësim i kushteve në institucione për moshën parashkollore përmes ndërtimit të çerdheve të reja për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve, renovim të çerdheve ekzistuese për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve dhe riorientim të objekteve ekzistuese në qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve, si dhe mbështetje të realizimit reformave në sistemin e mbrojtjes sociale dhe avancimin e shërbimeve sociale.

Me qëllim të identifikimit në kohë të ndikimeve të mundshme negative ndaj mjedisit jetësor dhe aspekteve sociale të realizimit të aktiviteteve projektuese janë përgatitur dokumente: **“Korniza për menaxhim me mjedisin jetësor dhe çështjet sociale” dhe “Korniza për politikën për shpërngule”** në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe kërkesën e Bankës Botërore.

Ministria e punës dhe politikës sociale fton të gjitha palët e interesuara, institucionet dhe individët të marrin pjesë në debatet publike dhe të japin komentet dhe vërejtjet e tyre në dokumentet e përpiluara.

Propozim versioni i dokumenteve është vënë në pamje publike në ueb faqen e Ministrisë së punës dhe politikës sociale (<http://www.mtsp.gov.mk>).

Komentet e juaja mund t'i parashtroni edhe te Sanja Andovska, kontakt personi për Projektin për kompensimet e kushtëzuara në të holla në e-mail: sanja.andovska@mtsp.gov.mk, deri në ditën e mbajtjes së debatit të fundit publik.

Ministria e punës
 dhe politikës sociale

ECO GUERRILLA PËR DITËN E EVROPËS

TETOVA VETËM QYTET NUK ËSHTË!

"Sot, në Ditën e Evropës, është e papranueshme që qytetarët mos jenë të informuar se sa është borxhi i Komunës, kujt i kemi borxh, në kohën e kujt dhe për çfarë arsye është krijuar ky borxh? Sot, në Ditën e Evropës, po të kishim shtet të së drejtës, këta funksionarë do të përgjigjeshin për keqpërdorime të detyrës zyrtare dhe do të përballëshin me gjykatat", deklaroi Arjanit Xhaferi, kryetar i Lëvizjes Eco Guerilla

Tetovë, 9 maj - Lëvizja Eco Guerilla ka drejtuar një sërë akuza në drejtim të kryetares së Komunës së Tetovës, Teuta Arifi. Pikërisht në Ditën e Evropës, kjo organizatë ambientaliste ka nënvizuar se komuna fsheh informacionet se si harxhohen paratë e qytetarëve.

"Sot, në Ditën e Evropës, është turp të fshehësh informacionet se si harxhohen paratë e qytetarëve nga Komuna dhe Ndërmarrjet Publike. Edhe pse mori përsipër se do jetë transparente dhe do të publikojë Raportin financiar për vitin e kaluar dhe për 10 vitet e kaluara, kjo kryetare vazhdon me avazin e vjetër me dy faqe bilanc përfundimtar u hedh pluhur syve të qytetarëve. Me këtë papërgjegjësi të skajshme, na bën



të dyshojmë se ka keqpërdorime serioze. Sot, në Ditën e Evropës, është e papranueshme që qytetarët mos jenë të informuar se sa është borxhi i Komunës, kujt i kemi borxh, në kohën e kujt dhe për çfarë arsye është krijuar ky borxh? Sot, në Ditën e Evropës, po të kishim shtet të së drejtës, këta funksionarë do të përgjigjeshin për keqpërdorime të detyrës zyrtare dhe do të përballëshin me gjykatat", deklaroi Arjanit Xhaferi, kryetar i Lëvizjes Eco Guerilla. Më tej, Xhaferi ka drejtuar akuza edhe për gjendjen aktuale me shumë probleme akute të qytetit të Tetovës.

"Sot, në ditën e Evropës vazhdojmë të mashtrohemi kur krye-

tarja me nënshkrimin e saj më 9 tetor 2017, mori përsipër se rrugët e lagjeve tona, para shtëpive tona do të pastrohen së paku njëherë në muaj, me ujë. Sot, në Ditën e Evropës, jetojmë në një qytet ku pluhuri në rrugët e lagjeve tona ende është pjesë e përditshmërisë për fëmijët tanë. Rrugët e qytetit tonë nuk pastrohen si në Evropë, por pastrohen vende-vende ende si në shekullin e 19, pa makineri dhe infrastrukturë moderne. Shkaktare për sëmundjet respiratore të fëmijëve është pikërisht pluhuri që ata thithin nga ambienti. Sot, në Ditën e Evropës, Tetova është qyteti me më pak hapësira të gjelbërta. Edhe ato pak hapësira

që kishin mbetur, po betonizohen çdo ditë. Sot, në Ditën e Evropës, policia e trafikut në Tetovë është bashkëfajtoreshë dhe e paaftë për ta zgjidhur kaosin e trafikut në qytet. Sot, në Ditën e Evropës, Tetova vazhdon të mbetet pa transport publik", tha Xhaferi, në pres konferencën me gazetarë në Ditën e Evropës.

"Sot, në Ditën e Evropës, uzurpimi i hapësirave publike në Tetovë është bërë zakon i të fortëve me vite. Ne e përshëndetëm nisimën e Komunës për çlirimin e hapësirave publike të uzurpuara, dhe e inkurajojmë atë ta vazhdojë këtë operacion me intensitet edhe më të lartë, dhe të mos jetë selektive, posaçërisht në trotualet e zaptuara që pamundësojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve. Anarkia duhet të marrë fund dhe vendosja e rendit dhe shtetit të së drejtës duhet të jetë pjesë e jetës së përditshme. Sot, në Ditën e Evropës qytetarët e Tetovës meritojnë të kenë qytet, me infrastrukturë efikase rrugore, linja të rregullta të transportit publik, parkingje nëntokësore, ambient të pastër jetësor, dhe parqe të gjelbëra që ruhen e mirëmbahen", theksoi Xhaferi. Nga Komuna e Tetovës nuk kanë dashur të komentojnë akuzat e Lëvizjes Eco Guerilla. (U.H)



Nuk guxon të vdesin fëmijët për shkak të mosvaksinimit

Prilep, 9 maj - Nuk guxon të na ndodhë vdekshmëri e fëmijëve për shkak të mosvaksinimit. Në Maqedoni duhet të ngritet përqindja e imunizimit të fëmijëve, e cila prej të 90-ave të dikurshme ka rënë shumë. Ajo është rregulluar me akte ligjore. Këtë e theksoi dhe ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska pas vizitës në hapësirat e reja të adaptuara me dedikim për kopsht të fëmijëve në SHFK "Rampo Levkata" në Prilep. "Në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore qëndron se fëmijët në Maqedoni duhet të vaksinohen. Inspekcioni sanitar i cili hyn në entet e fëmijëve i kontrollon kartonat e vaksinave dhe kjo nuk është famë. Kjo nuk është asgjë e re. Maqedoni më herët kishte përqindje të lartë, mbi 90 përqind përfshirje me imunizim, tani ka rënë dhe kjo duhet të rregullohet. Nuk guxon të na ndodhë vdekshmëri për shkak të mosvaksinimit", tha Carovska duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve. Ndaj akuzave të ish-të punësuarve në kohë të caktuar se ka pasur dekret me shkrim nga ministrja për t'iu vazhduar kontrata deri në fund të shkurtit, Carovska kërkoi ta tregojnë atë dëshmi. Në pyetjen për ta komentuar vendimin e sotëm të Gjykatës kushtetuese sipas të cilit, pjesëmarrja normative tashmë nuk do të jetë bazë për pagesë të rrogës minimale, Carovska u përgjigj shkurtë se nuk komentohen vendime gjyqësore, por ato zbatohen. (D.K)

AKTIVITETE TË NDRYSHME PËR DITËN E EUROPËS NË TETOVË

9 Maji - Dita e Europës tanimë tradicionalisht është shënuar edhe nga Këndi Amerikan në Tetovë, ku me rastin e kësaj dite përfaqësues të Këndit Amerikan, studentë dhe nxënës kanë bërë një xhiro me biçikleta në rrugët e qytetit të Tetovës. Ky aktivitet këtë vit është organizuar nga Klubi i të rinjve të NATO-së që funksionon në suaza të Këndit Amerikan. Me rastin e

Ditës së Evropës, përballë Qendrës për kulturë janë organizuar edhe disa aktivitete të tjera kulturore të përgatitura nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Tetovës, si dhe Shoqëritë Kulturo-Artistike ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Komunës së Tetovës, si dhe zëvendësambasadorja e Holandës në Maqedoni.

Rrahje në Idrizovë, lëndohet rëndë një i burgosur

Shkup, 9 maj - Një i burgosur është lënduar rëndë një rrahje që ka ndodhur dje në pjesën e mbyllur të Institucionit Ndëshkues-Përmirësues - Idrizovë. Policia kumtoi

se dje rreth orës 16.30 në Sektorin e punëve të brendshme Shkup, është denoncuar se në Institucionin Ndëshkues-Përmirësues - Idrizovë, në krahun e pestë (pjesë e

mbyllur), pas grindjes paraprake ka ardhur deri në rrahje midis të dënuarve S.R. (26) dhe M.E. (32), të dy nga Shkupi. Në rrahjen M.E. ka marrë lëndime të rënda trupore,

të konstatuar nga ana e mjekut të Klinikës për Kirurgji maksilofaciale. Po ndërmerren masa për ndriçimin e plotë të rastit, kumtoi MPB-ja.

TARAVARI PRITI AMBASADORËT E GRUPIT TË VISHEGRADIT

Gostivar, 9 maj - Ambasadorët e shteteve të Grupit të Vishegradit, edhe sivjet përzgjedhën Gostivarin për të shënuar 9 Majin - Ditën e Bashkimit Evropian. Fillimisht ambasadorët e tre nga katër shtete e Grupit të Vishegradit në Shkup, respektivisht ai i Çekisë, Miroslav Toman, i Polonisë Jacek Multanowski dhe i Hungarisë, Laslo Duks u pritën në kabinetin e tij nga Arben Taravari ku biseduan për aktualitetet në komunë dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ekzistues. Më pas, kryetari Taravari dhe



tre ambasadorët morën pjesë në manifestimin e organizuar për shënimin e Ditës së Evropës, i cili

filloi me intonimin e himnit të Bashkimit Evropian - Oda e Gëzimit interpretuar nga kori i SHF M.K.

Ataturk - Gostivar, i pasuar me pika muzikore nga vendet e BE-së interpretuar nga nxënësit e Shkollës së ulët të muzikës "Enver Stafai" - Gostivar. Kryetari Taravari në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi ambasadorët e Grupit të Vishegradit që rregullisht përzgjedhin Gostivarin për të shënuar ditën më të rëndësishme të Bashkimit Evropian, si dhe përgëzoi nxënësit për programin e bukur të përgatitur enkas për këtë ditë, për të nderuar mysafirët. Të pranishmëve, në emër të shteteve të Grupit të Vi-

shegradit, iu drejtua edhe ambasadori hungarez Laslo Duks, i cili inkuadrinim e vendeve të Vishegradit në BE e prezantoi si një storje suksesi, duke uruar që sa më shpejtë edhe Maqedonia të bëhet pjesë e familjes së madhe Evropiane. Me program të pasur kulturor-artistik u shfaqën edhe nxënësit e SHF "Goce Dellçev" të udhëhequr nga profesori i muzikës Basri Ristemi, të cilit për kontributin e dhënë kryetari Taravari i dhuroi një kaskë për çiklizëm, hobi ky i preferuar i profesorit.

Komandantët

Nga

Nazim RASHIDI



Nuk e di se si do të kalojmë në fazën ku shoqëria do të hyjë në një normalitet dhe ku absurditeti mos të dominojë bisedat e përditshmërisë. Një shprehje thotë, se "janë të mallkuar ata që jetojnë në kohë interesante", dhe vërtet, asnjë ditë nuk po mbetet që nuk të habit. Dhe tamam sa do thuash, jo, nuk ka ç'të më habitës, s'ka më asnjë ngjarje e zhvillim që do më çudisë, se i kam parë e dëgjuar të tëra, dhe sërish... del diçka që të le gojëhapur.

Ky moment habie, siç edhe ndodh rëndom ka të bëjë me politikën. E cila na shkundi e tundi nga të papriturat që na rezervon. Por sërish, dikush do të thoshte, sa të mërzitshme do ta kishim jetën nëse nuk i kishim këta politikanë dhe vërtetë... do të ngjanim si shumë vende të tjera në Evropë, ku jo që s'ka marrëzi nga politika e politikanë, por të paktën ato janë më të rralla, dhe ku jeta në këto vende është gjithë rend e mirëqenie. Do t'i kthehem Evropës, sepse kur shkruaj këtë tekst, është dita e saj, por fillimisht me marrëzirat tona.

"Bomba" e fundit nga politika quhet Hoxha. Dhe t'i marrim gjërat shtruar.

Nuk ka njeri (shqiptar) që nuk mendon se Xhezair Shaqiri, nuk duhet të marrë mbështetje e vlerësim për gjithë kontributin e sakrificën e tij që shoqëria të arrijë këtu ku jemi sot. Ashtu si ai edhe shumë të tjerë do të duhet të mbështeten e të përkrahen që të vazhdojnë të kontribuojnë me atë që dinë në zhvillimin tonë.

Bindjet e mija politike, janë pranë të majtës, ku mendoj se shteti do të duhet të ndërhyjë në shoqëri që të vë balancë dhe që të sigurojë mirëqenie dhe dinjitet për njerëzit. Si rrjedhojë, po dua të shoh zhvillimin në nivelet e perëndimit, ku shteti i mirëqenies i siguron një jetesë të qëndrueshme qytetarit. Këto në fakt janë dhe bazat e një shteti e shoqërie me vëmendje sociale dhe këtë duhet ta bëjë edhe Maqedonia. Aq më shumë duhet të ketë kujdes dhe vëmendje për ata individë kontributi i të cilëve ka qenë vendimtar për të ardhmen.

Por sinqerisht, le ta bëjmë pyetjen hapur: A mendon dikush që Hoxha do të këshillojë realisht Kryeministrin Zaev?

Rasti në fjalë na sjell përpara dy çështje. E para fare, na pllakos të gjithëve, dhe na përplas rëndë fak-

tin se politika në kontekst të institucioneve vazhdon të bëjë përzgjedhjet e saj pa sistemin e meritokracisë, për pozicionet dhe postet që përhap. Nuk ka njeri që nuk e beson se rasti i fundit nuk ka të bëjë me ndonjë "nder" që Zaev do të lajë ndaj Shaqirit, apo dhe të tjerëve, por çështja është, a është ky nder i kthyer i duhuri? Pa diskutim që të gjithë e dinë përgjigjen.

Por rasti nxjerr në pah edhe faktin tjetër, atë se çështjet e hapura të shoqërisë nuk duhen lënë të kalojnë pa zgjidhje sepse kthehen më pas si bumerang. Nëse për një gjë ka të drejtë Xhezair Shaqiri, është se shteti do të duhet të ishte kujdesur me kohë për të. Ai dhe luftëtarët e tjerë nuk mund të mbesin peng i inateve dhe mosguximit të politikës sidomos maqedonase. Komandanti Hoxha është e njohur se çfarë ka bërë dhe nxehjet apo dhe mospajtimet politike që mund të kishin vijuar më pas, nga rrethanat politike të pas 2001-shës, nuk do të duhet të linin të patrajtuar atë dhe të tjerët si ai.

Politika maqedonase nuk kishite guximin të pranojë zgjidhje të socializimit të shtresës së shoqërisë që është edhe e tyrja (për aq sa e pra-

nojnë këtë) dhe politika shqiptare nuk guxonte që të linte trajtimin e ish luftëtarëve në forma alternative e me forma përzgjedhëse favorizuese për dikë e harresë për dikë tjetër. Jeta do të duhej të kishte ardhur për ta me kohë, por në vendin e duhur.

Duke dhënë modelin se vetëm nëse je në politikë atëherë mund të përfitosh në paqe gjithçka rrëzohet në kontekst të zhvillimit që duam sot. Si rezultat i kësaj logjike ne sot kemi situata të tilla, ku ende flitet për trajtim të një shtrese të shoqërisë që do të duhej të ishte trajtuar e rehatuar.

Nga ana tjetër e gjithë situata është një përgjigje ndaj çështjeve që lihen e shtresohen por që vjen një ditë që edhe do të duan zgjidhje. Kështu Hoxha po bëhet një simbol i mosguximit për të zgjidhur çështjet në kohën e duhur dhe shembull se kur do që të jetë përgjigje politika duhet tu japë situatave që kërkohen prej saj. Por ajo që tashmë Hoxha nuk duhet të jetë simbol është i zgjedhjeve rastësore kadrovike në postet qeveritare. Kjo më nuk është kompatible as me kërkesat e njerëzve e sidomos të një brezi që kërkon të mbërrijë Evropën sa më parë, e as nuk është në përputhje

Nuk fakt komandantët e të tashmes do të duhet të jenë të një modeli tjetër. E meqë jemi tek dita e Evropës, më 9 maj, qeveria dhe vetë kryeministri atë që do të duhej të bënte është të shfaqte ushtrinë e komandantët me të cilët do të identifikohet progresi dhe zhvillimi



me gjithë prirjet dhe reformat që qeveritarët do të duhet të ndërmarin për të arritur drejtë Brukselit.

Nuk fakt komandantët e të tashmes do të duhet të jenë të një modeli tjetër.

E meqë jemi tek dita e Evropës, më 9 maj, qeveria dhe vetë kryeministri atë që do të duhej të bënte është të shfaqte ushtrinë e komandantët me të cilët do të identifikohet progresi dhe zhvillimi. Komandantët që nuk do të tremben të "shtinë" me dije, ligje, veprime përballë burokracisë së Brukselit që do të grijë çdo gjë përpara kur do të skanojë funksionalitetin e qeverisë, ministrave dhe gjithë atyre këshilltarëve, të cilët do të duhet të jenë të përgatitur e veshur me kostume profesionale, ekspertizash, apo dhe gjuhësh të huaja që të përballojnë dhe t'ia dalin rrugëtimit evropian.

Dhe po, të tillë komandantë ka dhe shqiptarë. Djem dhe vajza që me vite investojnë në dijen e tyre e cila as e si të vlerësohet e ku më shoqëria të përfitojë prej tyre. Por këta do të jenë ata komandantë të brezit të ri, që do të qëndrojnë ballëllartë e krenarë në anijen me detra plot fatunë drejt përparimit.

Patetike është e gjithë kjo reto-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovassja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 9 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

rikë që e shkruaj, sepse është e aq stërpërsëritur, por po aq patetike dhe dëshpëruese është politika në hapat dhe veprimet e saj, saqë ndjesia që të vjen është të hidhesh nga ajo anija që as e si të ecë përpara, në të cilën as kemi hipur e as që përballet me de-trat e vështirë.

Jo rastësisht pastaj ata që kanë mbetur në këtë vend duan të ikin, sepse modelet e suksesit dhe meritës vinë nga jashtë. Dhe meqë jemi tek Evropa, po në këtë ditë po bëhet e qartë se në finalen e festivalit të këngës së lehtë, Evropionit do të ketë tre shqiptarë: Eugent Bushpepa, që përfaqëson Shqipërinë por edhe Ermal Meta që do përfaqësojë Italinë dhe Eleni Foureira që përfaqëson Qipron. Por këta dy të fundit janë modeli që ndjek brezi i ri. Këta të fundit japin mesazhin se po të vlesh, edhe pse në vend të huaj edhe të huajt të vlerësojnë.

Dhe kë mendoni ju, se do pranojnë si model të arritjes dhe suksesit të rinjtë? Ku do duan ta provojnë veten pa frikën se nëse vlejnë do të kenë sukses? Cila është këshilla që marrin ata dhe krejt të tjerët me rastet e tilla... ahhh po gjithçka këtu kalon nga politika!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Hap i pritur, pasoja të paditura

Askush nuk besonte më në një mrekulli. Edhe para bërjes publike të vendimit të Trumpit spekulohet më shumë se sa i ashpër do të ishte vendimi, pra dalja nga marrëveshja atmoike, nëse do të mbetej ndonjë derë e hapur, nëse kishin pasur ndonjë efekt diplomatik përpjekjet e europianëve. Tani dihet: SHBA e hedhin poshtë përfundimisht Joint Comprehensive Plan of Action, JCPOA, marrëveshjen atomike me Iranin, sanksionet rivendosen: Nga të gjitha variantet e diskutuara më parë ky është më i rrezikshmi.

Më e sigurt, më paqësore bota nuk bëhet me këtë vendim: Aksionet e koncerneve të armëve filluan të shtohen që gjatë kumtimit të vendimit të Trumpit. Po ashtu nuk bëhet më i lehtë sukcesi në takimin e pritshëm të Donald Trumpit me sundimtarin koreanoverior, Kim Jong Un. Arsytimi i Donald Trumpit për daljen nga marrëveshja atomike me Iranin: Marrëveshja nuk i ka dalë të mbrojtë interesat amerikane. Por se si dalja nga kjo marrëveshje do të mbrojtë interesat amerikane, mbetet sekret i Trumpit. Marrëveshja atomike i ndalonte Iranit në mënyrë të kon-

Donald Trump i tha "Jo" marrëveshjes atomike me Iranin. Por refuzimi i saj e bën botën më të rrezikshme. Çarmatimi bëhet më i vështirë dhe diplomacia zhvlerësohet në favor të militarizimit

trollueshme ndërtimin e bombës atomike dhe pengonte me këtë një garë armatimi në rajon. Ky ishte objektivi i saj, dhe ai në këtë formë plotësohej. Madje as sekretari i ri i Departamentit të Shtetit, Mike Pompeo nuk dyshon që Irani i përbush detyrimet që dalin nga marrëveshja.

Trump, kështu analizonte një diplomat francez për Crisis Group, "nuk ka problem me marrëveshjen, ai ka problem me Repu-

blikën Islamike të Iranit". Prandaj edhe negociatat mes europianëve dhe SHBA në këto muaj ishin të destinuara të dështonin. Megjithë lëshimet e europianëve, megjithë ofensivën diplomatike të Macron, Merkelit dhe Johnsonit së fundmi.

Trump ka qenë i rrethuar në Shtëpinë e Bardhë në mënyrë të vazhdueshme me përfaqësues të linjës së ashpër ndaj Iranit. Krahas Pompeo, bën pjesë këtu edhe këshilltari i ri për sigurinë, John Bolton. Ai ka shkruar në vitin 2017: "Qëllimi i deklaruar i Amerikës duhet të jetë që t'i japë fund Revolucionit Islamik të vitit 1979 para 40 vjetorit të tij." Nocioni i "ndërrimit të regjimit" po dëgjohej në mënyrë të frikshme gjithnjë e më shpesh. E frikshme, sepse John Bolton edhe para luftës së Irakut në vitin 2003 ka luajtur një rol qendror. Pasojat katastrofale të një lufte kundër së drejtës ndërkombëtare për të gjithë rajonin dihen, edhe pse arsytimi për këtë luftë bazohet në gënjeshtër.

Në arsyetimin e tij për daljen nga marrëveshja atomike me Iranin, presidenti amerikan iu referuar shprehimisht kryeministrit izraelit, Netanjahu në daljen publike

javën e fundit. Ndërkohë që kjo dalje publike ishte dukshëm një shou propagandistik. Material i vjetër dhe i ri ishte përzier e ripaketuar, pa asnjë lidhje me gjendje aktuale të programit atomik iranian. Vendimi i Trumpit i vë pikëpyetje 12 viteve të përpjekjeve diplomatike intensive me Iranin, pa ofruar ndonjë alternativë. Tani shumë gjëra do të varen nga uniteti i europianëve, nga vendosmëria dhe vullneti i tyre, që së bashku me partnerët e tjerë, Kinën dhe Rusinë të ofrojnë stimuj që Irani, megjithë daljen e SHBA-së nga marrëveshja, të respektojë kushtet e saj. E çara në marrëdhëniet transatlantike do të thellohet.

Vendimi i Donald Trumpit do të forcojë shpejt forcat konservatore në Iran. E me këtë rritet probabiliteti që gjendja të shkallëzohet në mënyrë të rrezikshme në një rajon me konflikte të shumta, Jemeni, Siria, Libani dhe Iraku. Krijimi i një arkitekture të sigurisë në rajon që respekton interesat legjitime të të gjitha palëve shtyhet në një të ardhme shumë më të largët. Por kjo do të ishte e vetmja rrugë që të arrihet paqja e vërtetë në rajon.

(DW)



Nga Matthias Von HEIN

Iluzioni ynë: Na duket sikur jemi specialë...

Mes eksperiencave më "drithëruese" të jetës moderne, është një që më ndodh shpesh, por me siguri jo vetëm mua. Ule të pi diçka me një mik, i cili më këshillon një libër a një film, që sipas tij do të më pëlqejë, dhe pastaj, pa e kërkuar fare unë vetë, nis të shoh reklamën online. Nuk është për t'u habitur që qarkullojnë zëra se Fejsbuku përdor mikrofonin e celularit tonë për të na përgjuar. Është pothuaj me siguri i rremë: aplikacionet dhe faqet e internetit mbledhin tashmë kaq shumë të dhëna rreth nesh, saqë nuk kanë nevojë për truke të tilla, kemi vetëm ndjesinë që po na spiunojnë.

Por ka një tjetër arsye përse rrjeti na njeh më mirë se sa mendojmë: jemi shumë më normalë, nga se besojmë se jemi. Duke ditur diçka rreth meje, si Fejsbuku, si miku im përfundojnë duke më kë-

shilluar të njëjtat gjëra, sepse konstelacioni im i interesave është shumë më pak i veçantë, e si pasojë më i parashikueshëm, nga sa do të më pëlqente të besoja. "Nuk je edhe aq i veçantë", mund të jetë një fyerje (si të thuash i gjori, mendon se kushedi kush është), dhe ndonjëherë një shprehje dashurie, si mesazhi që u bë viral në vitin 2012, ku mësuesi amerikan i shkollës së lartë David McCulloch, u bënte thirrje studentëve të tij të mos bëheshin të palumtur, duke u përpjekur të tregonin se ishin në qendër të universit. Shpesh herë, është edhe akuzë që më të mosshuarit ua bëjnë më të rinjve.

Por ky është vetëm një shpërqendrim nga fakti brutal statistikor që, në bazë të cilitdo parametër, dhe me gjithë kushtet e tjera të mirëqena, është e qartë se jemi normalë. Privuar nga çdo lloj vlere gjykim, është kjo domethënia e fjalës "normale". Ka shumë

mundësi që inteligjenca jonë, krijueshmëria jonë, shijet tona kulturore apo dashurore, mënyra se si bota na ka keqtrajtuar, janë më pak të çuditshme apo ekstreme nga sa mendojmë, mbi të gjitha po të kemi parasysh se, gjithsecili prej nesh ka arsye të forta për të besuar të kundërtën. Ose për ta thënë me fjalë të tjera: të mendosh se je i/e veçantë është vetëm një nga mënyrat e shumta për të qenë normalë. Është fenomeni i famshëm, i njohur si "superioriteti i gënjeshtërt", që shpjegon pse shumica e njerëzve mendojnë se janë mbi mesataren për mënyrën si ngasin makinën, për mungesën e paragjyqimeve dhe për shumë arsye të tjera, ndryshme. Dhe funksionon edhe në të kundërt: sindroma e mashtruesit është pikërisht ajo e atyre që mendojnë se janë të veçantë, por në një kuptim negativ. Problemi është se duke menduar që jemi më pak normalë nga sa

Problemi është se duke menduar që jemi më pak normalë ga sa jemi në të vërtetë, pozitivisht apo negativisht, na bën të pakënaqur, duke na bindur se jemi pazakonshëmrisht të këqij, ose na detyron të izohemi dhe të rrimë në mbrojtje, sepse mendojmë që jemi shumë të mirë

jemi në të vërtetë, pozitivisht apo negativisht, na bën të pakënaqur, duke na bindur se jemi pazakonshëmrisht të këqij, ose na detyron të izohemi dhe të rrimë në mbrojtje, sepse mendojmë që jemi shumë të mirë. Kjo sjellja e fundit nënkupton gjithashtu që, cilido aspekt i jetës apo eksperiencës, absolutisht normal - për definicion, pothuaj të gjithë - na duket si mospërfillje, apo sfidë ndaj identitetit tonë. "Mos harroni asnjëherë, se çdo mendje plazmohet prej eksperiencave më të zakonshme", shkruante poeti francez, Paul Valéry. "Të thuash se diçka është normale, do të thotë të thuash që është mes gjërave, që kanë dhënë më shumë kontribut në formimin e ideve tona më themeltare". Të përçmosh normalen, do të thotë të përçmosh gjithçka që na ndodh. Edhe ta bësh këtë, sigurisht që është normale, por është edhe realiteti i sigurt për një jetë të palumtur. (The Guardian)



Nga Oliver BURKEMAN

SIRIA SI KRIZË MAKRO-RAJONALE

NJË LUFTË PËR TUBACIONET!

Lufta civile siriane, që tashmë po zgjat qysh nga 2011, por ribën kartën gjeopolitike e Lindjes së Mesme, në kuadrin e një riorganizimit të përgjithshëm të asetëve politiko-ekonomike e të gjithë kontinentit euraziatik

Përplasja fillestare ushtarake midis regjimit të Bashar al-Assad dhe opozitës laramane të shfaqur si efekt i nxitur nga pranverat arabe që ka parë të përfshirë një numër në rritje aktorësh, nga interesat shpesh konvergjuese, nganjëherë konfliktuale, asnjëherë lineare. Duke pasur parasysh marxhinalizimin strategjik e Perëndimit dhe për të dekriptuar arsyet e thelle e shpërthimit të konfliktit, sidomos ndërhyrjen masive ushtarake dhe protagonizmin e ri politiko-diplomatik të Moskës, disa analistë kanë nënvizuar interesat e kundërta energjetike midis disa prej aktorëve rajonalë të përfshirë në konflikt, Turqi, Iran e Katar, të ashpërsuara nga rivaliteti midis Rusisë e Shteteve të Bashkuara. Në një lexim të tillë, do të ishin këto origjina e vërtetë e vetë konfliktit.

Objekt i kontestimit do të ishte në thelb tregu fitimprurës i gazit europian dhe tentativa e diversifikimit të furnizimeve të tij. Për nga vetë natyra e tij, gazi natyror në pjesën më të madhe transportohet nëpërmjet tubacioneve (Sipas British Petroleum, 67% e totalit kalon nëpër tubacione). Kjo karakteristikë "territorialiteti"- duke pasur parasysh lidhjen midis gazsjellësve dhe rajoneve që përshkojnë - e ka bërë për një kohë të gjatë të vështirë krijimin e një tregu global të ngjashëm me atë të naftës. Rusia, thuhet monopoliste e furnizimit të disa vendeve të mëdha europiane (furnizim thelbësor për ekonominë e saj), do t'i kundërvijë kështu çdo tentativë për të krijuar korridore të rinj nëpërmjet Lindjes së Mesme që të arrijnë Kontinentin e Vjetër.

Praktikisht, ndërsa dimensionin energjetik i kësaj krizë të Lindjes së Mesme shpesh injorohet, elementë tensioni midis aktorëve rajonale dhe Rusisë të lidhura me projekte gazsjellës potencialisht alternativë janë padyshim të pranishëm. Megjithatë, a janë të mjaftueshëm për ta bërë luftën në Siri



një "luftë për tubacionet"? Në realitet, ndryshorja energjetike nuk mund të konsiderohet shkaku kryesor i rikonceptimit të asetëve gjeopolitikë rajonalë. Nga aktorë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në konflikt dhe duke përfshirë gjigandin saudit për rolin e tyre relativisht marxhinal në sektorin e gazit, Rusia, Irano dhe Katar janë (në këtë renditje) 3 vendet më të pasura të botës me rezerva gazit natyror. Rusia dhe Katar, prodhuesit më të mëdhenj të gazit, janë konkurrentë për aksesin në tregun e gazit europian. Nga ana e tij, Irani po profilohet si aktor i tretë i ardhshëm.

Rusia ka një avantazh gjeografik dhe infrastrukturor të konsiderueshëm, me aksesin në tregun europian të garantuar nga sistemi i gazsjellësve që lidhin kampet gazifere të Rusisë e të Siberisë Perëndimore me Europën. Kjo e fundit mbetet akoma tregu kryesor për Gazpromin, pavarësisht tentativave të diversifikimit në zhvillim drejt Kinës dhe pjesës tjetër të Azisë Perëndimore. Moska ka një interes të qartë për ta ruajtur pozicionin e saj si furnizuese e madhe, duke mbuluar rreth 30% e nevojës së Kontinentit të Vjetër. Çdo tentativë

për të realizuar korridore alternativë, si projekti i gazsjellësit europian Nabucco apo Transcaspian Pipeline ka qenë praktikisht gjatë dy dekadave të fundit i urryer apo i keq-përtypur nga ana e Kremlinit.

Midis furnizuesve të tjerë, Katar është një prej vendeve nga të cilët Europa blen më shumë metan në formë LNG (gas natyror i lëngëzuar). Ky transportohet me anije sidomos në терминалет që po përhapen gjatë gjithë bregut jugor e verior të Europës. Praktikisht, nëqoftëse është e vërtetë se gazi i transportuar nëpërmjet tubacioneve mbetet dominues në nivel botëror, përhapja e impianteve të lëngëzimit dhe rigazifikimit e ka arritur në mënyrë të konsiderueshme kuotën e LNG. Ky, bashkë me shale gas, ka mundësuar shfaqjen e një tregu - spot të gazit, potencialisht global, alternativ ndaj atij të bazuar mbi kontrata afatgjata të llojit "take-or-pay", tipike të furnizimeve të ardhura nga Rusia.

Në këtë kuadër, Katar, që eksporton rreth 23% të LNG së tij drejt Europës, ka një interes të qartë për t'i ruajtur dhe mundësisht t'i rrisë furnizimet drejt kontinentit, duke shfrytëzuar sidomos marrëdhëniet e keqësuar me Mo-

skën si pasojë e krizës ukrainase dhe çmimin e ulët të naftës që e ka detyruar Gazpromin që ta rinegociojë drejt uljes kontratat e tij afatgjata me kompanitë europiane. Pavarësisht skontove të Gazpromit, në fakt tensioni ndërkombëtar dhe vetë uljet në çmimin e LNG vazhdojnë që t'i shtynë europianët drejt diversifikimit të burimeve të furnizimit.

Nga ana e tij, për arsye të lidhura me konsumin e lartë të brendshëm dhe me izolimin ndërkombëtar, Irani nuk arrin akoma të luajë një rol në tregun global të gazit. Me përfundimin e sanksioneve, Teherani ka treguar megjithatë interes në rritje për t'u bërë një furnizues i Europës nëpërmjet fqinjëve të Lindjes së Mesme, duke shfrytëzuar afërsinë gjeografike me Turqinë nga njëra anë dhe me Irakun e Sirinë nga ana tjetër. Interesave pjesërisht konfliktuese të 3 prodhuesve u shtohen pastaj interesat e Turqisë, si vend tranziti. Ankaraja synon prej kohësh që të marrë rolin e hub-jugor të energjisë përgjatë korridorit TANAP (Transanatolian Pipeline, pasues i projektit europian "Nabucco") që nga Kaspiku duhet të transportojë gaz drejt Europës Juglindore. Këtij mund t'i sh-

tohen furnizimet ruse nga veriu dhe, pikërisht, ato të Gjirit Persik nga jugu.

Potencialiteti i TANAP-it është i bllokuar nga ndalimi kontraktor për të rishitur gazin e blerë nga Rusia (Turqia është tregu i dytë më i madh për gazin rus pas Europës), nga konsumi i lartë kombëtar dhe nga sasitë e kufizuara të gazit kaspikas të parashikuara për momentin. Për pasojë, Turqia ka një interes të qartë që ta orientojë gazin nga Lindja e Mesme në TANAP dhe t'u japë konsistencë ambicieve të saj si hub-alternativ ndaj Rusisë. Në këtë kuadër kompleks, Levanti dhe Siria efektivisht mund të fitojnë një rol kryesor. Në 2009, Katar mendonte që të zhvillonte një linjë gazsjellësisht nga vendburimi më i madh nxjerrës i tij në Gji, për të kompensuar varësinë nga LNG kur kostot e këtij të fundit qenë ende shumë të larta: propozoi kështu që të ndërtonte një tubacion nëpërmjet Sirisë deri në Turqi. Në kundërpërgjigje, Bashar al-Assad vendosi një veto që u duk e justifikuar pikërisht nga nevoja për t'u garantuar rusëve monopolin në tregun europian, duke pasur parasysh sidomos mbështetjen e dhënë Sirisë, 2 vite më vonë, me zgjerimin e gazsjellësit Irak - Iran të sponsorizuar nga Teherani (i quajtur "Islamic Pipeline").

Sipas teorive që e shikojnë në këtë zgjedhje origjinën e krizës siriane, Shtetet e Bashkuara do të vendosnin në këtë pikë që të mbështesnin opozitën ndaj al Assad pikërisht për t'i garantuar Katarit që të pozicionohej si alternativë si ndaj Moskës, duke i dobësuar kapjen ndaj tregut europian, ashtu edhe ndaj Teheranit, duke bllokuar në lindje çdo tentativë iraniane për të arritur Mesdheun Lindor. Kjo zgjedhje do të provokonte nga ana e saj ripozicionim turk në funksion anti-Assad, krijimin e një aksi Turqi - Arabi Saudite me mbështetje amerikane dhe krijimin e kundërkasit Damask - Bagdad - Teheran - Moskë. Në këtë kontekst, do të favorizohej lindja dhe forcimi i Shtetit Islamik. Një rindërtim i tillë, përveçse mbivlerëson rolin e projekteve në kantier, nuk merr në konsideratë mjaftueshëm as evolucionin e tregut të gazit si global, ashtu edhe europian, as rolin e ndryshores aziatike në ekuacionin energjetik të Lindjes së Mesme.

Në fakt, siç përcillet nga shumë burime, projekti i Katarit u la mënjanë dhe u konsiderua i dështuar qysh në nisje të 2010 prej kundërshtimit saudit ndaj një tubacioni që të përshkonte territorin e tij. Jo vetëm kaq: kriza ekonomike



europiane, reduktimi pasues i kërkesës për gaz, përhapja e terminalëve LNG (në 2014 në Europë genë aktivë 23 terminale LNG me kapacitet importues prej më shumë se 200 miliard metra kub gaz, 40% e të gjithë nevojës për të) dhe zbulimi i vendburimeve offshore në Mesdheun Lindor, e kanë bërë këtë projekt fillestar relativisht të kotë për Katarin. Diskutim tjetër është për t'u bërë për Teheranin. Dendësia e pakët e rritjes iraniane të tubacioneve dhe e impianteve LNG e bëjnë Iranin të interesuar ndaj çdo zgjidhjeje dhe në çfarëdo tregu. Finalizimi (i njoftuar në janarin e 2017) i linjës Iran - Irak mund të përbëjë praktikisht pjesën e parë të "Islamic Pipeline", që me një Siri të "paqëtuar" siç e do Teherani mund të çojë deri në bregun e Mesdheut Lindor një vëllim prej rreth 40 miliard metra kub në vit. Ky gazsjellës do të ishte konkurrent i drejtpërdrejtë si i tubacionit Katar - Turqi, por potencialisht do të ishte edhe për gazsjellësit rusë. Megjithatë, një skenar i kësaj natyre, që do ta vinte Teheranin në rrugën e përplasjes me Moskën, është bërë vështirë i realizueshëm jo vetëm nga konflikti sirian, por sidomos prej një leverdie të pakët ekonomike. Me kosto të vlerësuar në 10 miliard dollarë, tubacioni do të ndeshë pastaj me transformimet e tregut të gazit europian. Faktikisht, në një treg që nuk zgjerohet, duke pasur parasysh rritjen e sheshtë ekonomike, pavarësisht rolin akoma vendimtar të Rusisë, furnizimi europian është tashmë mjaft i diversifikuar; ndërlihdësit dhe terminalët e rinj LNG i garantojnë pastaj sigurinë. Praktikisht, rritja e importeve të gazit europian që i detyrohet zvogëlimi të prodhimit të brendshëm do të kompensohet ka mundësia nga tregu - spot emergjent i LNG më shumë se nga gazi që vjen nga tubacione të tjera.

Nga ana e saj, Rusia është e interesuar që t'i ruajë kuotat e tregut europian, i sigurt, por i cunuar, sidomos në prani të çmimeve të ulëta dhe të paqartësive lidhur me furnizimet me gaz për Kinën, por është e vetëdijshme se në kushtet aktuale të tregut vështirë që "Islamic Pipeline" do të gjente financues. Kjo konsideratë e fundit na çon në argumentin e fundit dhe më domethënësit: për sa të rëndësishme interesat e kundërta e aktorëve të ndryshëm mund të jenë dhe për sa importi europian mund të rritet, sidomos për shkak të rënies së prodhimit të brendshëm, tregu i gazit europian nuk përfaqëson në të ardhmen një "premio" të mjaftueshme që të shpëtojë konfliktin e zgjatuar sirian e të Lindjes së Mesme dhe ta paraqesë atë si një "luftë për tubacionet". Praktikisht, kërkesa botërore e gazit, në dekadat e ardhshme, do të tërhiqet nga Kina, India dhe Azia Lindore. Katari eksporton tashmë 2/3 e LNG së tij drejt Azisë. Nga ana e tij, Irani ndjek me interes dhe vendosmëri të madhe çdo projekt që i mundëson gazit të Teheranit të arrijë Indinë, Juglindjen aziatike dhe potencialisht Kinën, siç ndodh tashmë me naftën e tij. Rusia, që mbetet fuqimisht e varur nga gazi europian, duhet t'i ruajë kuotat e saj të tregut, por edhe të shfaqet si lojtar influent në tregjet në rritje të Azisë. Në përfundim, nëse interesat divergjente energjetike kanë luajtur dhe luajtur një rol në riorganizimin e hapësirës gjeopolitike e Lindjes së Mesme, ato gjithsesi shfaqen si dytësore karshi objektivave politiko - ushtarake dhe strategjike që synojnë ta "mbyllin" Lindjen e Mesme ndaj influencës perëndimore.

Në këtë kuadër, është në fakt një ndryshore tjetër me të cilën duhen bërë llogaritë në Lindjen e Mesme "euraziatike" e viteve të ardhshme: prania në rritje kineze në ekuacionin rajonal dhe dëshira e Kinës për të rihapur korridore tregtarë joenergjetike nëpërmjet Lindjes së Mesme për të arritur si Afrikën Lindore, ashtu edhe Europën Jugore dhe Mesdheun. Kjo është e vërtetë, pavarësisht nga rezultati i luftës siriane dhe shumë përtej një "luftë energjetike" tashmë të vjetruar. (Geopoliticus)

FUNDI I TERRORIZMIT TË ETA-S

Pas Luftës Civile, ETA vrau 244 persona, rreth një e treta e vrasjeve totale. Në 1977 përfitoi një amnisti për t'i dërguar në mërgim të gjithë të burgosurit. Bilanci terrorist i saj është 93% e 829 vrasjeve e kreu në tranzicion dhe demokraci, vetëm 7 për qind gjatë diktaturës

Gjashtë vite e gjysëm më vonë pas deklarimit të ndërprerjes përfundimtare të terrorizmit, ETA ka njoftuar zhdukjen e saj si organizatë përmes një komunikate të publikuar në 14:06 të drekës. Fjalja që është përdorur për këtë njoftim është: "Çmontimi i plotë i strukturave të saj dhe fundi i trajektores dhe i aktivitetit të saj politik". Komunikata e publikuar nga mediat baske "Gara dhe Berria" është lexuar në spanjisht. Teksti titullohej "Deklaratë përfundimtare e Etas drejtuar popullit baske", me 378 fjalë, një komunikatë e ngjashme me atë të vitit 2011, në të cilën dekretoi mbylljen e saj përfundimtare. Nuk bën asnjë aludim për viktimat që ka shkaktuar gjatë akteve terroriste, por përiqet të justifikojë trajektoren e vet kriminale gjatë 59 viteve.

Teksti flet për ish ushtarakët që sinjalizon se do të vazhdojnë "luftën për një Euskal Herria të bashkuar, të pavarur, socialist dhe jo patriarkal dhe që kur e konsiderojnë më të përshtatshme me përgjegjësi dhe më ndershmëri të përhershme". Në pjesën e fundit të tekstit

thuhet: "Këtë vendim përfundimtar e adoptojmë për të favorizuar një fazë të re historike. ETA lindi nga ky vend dhe tek ky vend do të vdesë". Sinjalizon se do të ndërtojë një proces si një popull që ka forcë, aktivizim popullor dhe pakte mes të ndryshmeve si për të duruar pasojat e konfliktit, ashtu edhe për t'u përballur me rrënjët politike dhe historike. Institucionet dhe partitë konsiderojnë se kjo komunikatë është shpërbërja e kësaj organizate. Burime nga qeveria baske kërkojnë që t'u përmbahet kushteve të kërkuara, megjithëse mungon njohja e dëmeve të shkaktuar të gjitha viktimave dhe justifikimi i trajektores së saj terroriste. Në fakt ETA u zhduk në 20 tetor të 2011 kur pushoi përfundimisht terrorizmin dhe përfunduan vrasjet, sekuestrimet, zhvatjet dhe kërcënimet. Këmbëngulja për të ndërhyrë në një të ardhme ka zgjatuar 6 vite. Tani zhduket pa arritur asnjë nga pretendimet e veta, tek-tuk ndonjë pakt për të burgosurit. Sipas Ministrisë së Brendshme ka lënë një histori 853 vrasje, pjesa më e madhe baske, 79

sekuestri, 12 nga të cilat përfunduan me vrasje dhe 6389 të plagosur. Zhduket tani, ku kanë mbetur 197 raste të pa zbardhura, 170 të ndërprera dhe 27 të arkivuara. Lindi në 1959 si një organizatë për të luftuar diktaturën e Frankos, karriera e vrasjeve filloi në vitin 1968 dhe zgjati 43 vjet deri në 2011.

ETA e praktikoi terrorizmin vetëm 7 vjet gjatë diktaturës dhe 36 në tranzicion dhe në demokraci. Ishte një organizatë terroriste që me pretendimin për të imponuar një projekt totalitar në Euskadi u përpoq të destabilizonte demokracinë spanjolle dhe sulmoi në momentet më të vështira të tranzicionit. Konkretisht 1979-1980, vite të referendumit konstitucional të votimit të statusit të Gernikës dhe të krijimit të qeverisë së parë baske. Pas Luftës Civile, vrau 244 persona, rreth një e treta e vrasjeve totale. Në 1977 përfitoi një amnisti për t'i dërguar në mërgim të gjithë të burgosurit. Bilanci terrorist i saj është 93% e 829 vrasjeve e kreu në tranzicion dhe demokraci, vetëm 7% gjatë diktaturës.

Plaket Japonia, s'bën kush fëmijë!

Numri i fëmijëve në Japoni është ulur për vitin e 37 rresht, një shenjë e qartë që përpjekjet për të ndaluar plakjen e rëndë të popullsisë kanë dështuar, ndërsa ekspertët flasin për nisjen e numërimit mbrapsht të zhdukjes së këtij kombi. Nga 1 prilli 2018, në Japoni janë 15.53 milionë fëmijë nën moshën 14-vjeçare, një ulje me 170 mijë nga një vit më parë, një trend negativ që ka nisur që prej vitit 1981.

Segmenti më i madh mes fëmijëve është ai i atyre me moshë më të madhe, 3.26 milionë në moshat nga 12 deri në 14 vjeç, diçka që tregon se tendenca problematike nuk do të ndalet shpejt. Pavarësisht përpjekjeve nga qeveria e kryeministrit Shinzo Abe, për të nxitur japonezet që të kenë më shumë fëmijë, vetëm kryeqyteti Tokio raportoi më shumë lindje nga një vit më parë. Japonia përballet me lindje të ulëta prej dekadash dhe, ndryshe nga vendet e tjera të zhvilluara,



nuk ka mundur të plotësojë numrat përmes emigrantëve.

Për të ilustruar problemin e rëndë, Ministria japoneze e Shëndetësisë njoftoi se, në vitin 2060, nga 126 milionë banorë që është aktualisht, popullsia japoneze do të jetë reduktuar në 86 milionë.

Me më pak punonjës që paguajnë taksa për të mbështetur brezin në rritje të të moshuarve që kanë nevojë për pensione dhe kujdes shëndetësor, ekonomia japoneze po përballet me një sfidë të pa precedentë dhe koha nuk punon aspak në favor të saj.



Rruga Kaçanik-Hani i Elezit e bllokuar më shumë se 1 muaj

Për më shumë se një muaj do të mbetet e bllokuar rruga regjionale Kaçanik-Hani i Elezit si pasojë e rrezikut nga rrëshqitja e dheut dhe gurëve. Ministria e Infrastrukturës pas mbylljes së këtij aksi rrugor të martën nga ora 10:00, menjëherë ka nisur përgatitjen për fillimin e punimeve në mënyrë që një pjesë e kodrës të rrafshohet. Zyrtarët e kësaj ministrie, të martën, kanë treguar edhe për rrugët alternative të cilat mund t'i ndjekin vozitësit. Qëmajl Jonuzi, menaxher i projekteve në Ministrinë e Infrastrukturës, ka deklaruar se qytetarët nga Kaçaniku për në qytezën e Hanit të Elezit, mund të lëvizin vetëm me vetura të vogla nëpërmjet rrugëve alternative nga fusha e pajtimit në drejtim të Gllloboqicës, ndërkaq automjetet transportuese mund të kalojnë në Hanin e Elezit vetëm nëpërmjet rrugës për Te-tovë. "Këtu bëhet fjalë për mbyllje mujore të këtij aksi rrugor derisa dheu i kodrës të largohet dhe të stabilizohet gjendja, sepse edhe në të kaluarën ka pasur rrëshqitje të dheut dhe shembje të gurëve në këtë pjesë të magjistrales. Do të bëhet një zgjidhje përfundimtare për parandalimin e rrëshqitjes së dheut dhe gurëve, andaj në vend të ngjarjes vazhdimisht do të qëndrojnë edhe Policia e Kosovës për t'i orientuar vozitësit", ka thënë Jonuzi.

DIPLOMACIA SIPAS TEKEVE

Një nga tri objektivat e pjesëmarrjes në konferencën ministrore të vendeve të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik, sipas Pacollit, ishte edhe "aplikimi i Kosovës për statusin e vendit vëzhgues në këtë organizatë". Në anën tjetër, zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Gjergj Dedaj, ka paralajmëruar dorëheqje të paravokueshme, nëse Kosova anëtarësohet në këtë organizatë

Politika e jashtme e Kosovës po reflekton disa ndasi në qëndrime rreth çështjeve të ndryshme, të cilat sipas analistëve politikë, mund të sjellin pasoja të mëdha për vendin. Analisti Imer Mushkolaj, thotë se çështjet shtetërore duhet të jenë unifikuese, në mënyrë institucionale dhe jo në mënyrë personale. "Politika e jashtme e vendit dhe në përgjithësi institucionet, për fat të keq kanë vuajtur nga mungesa e koordinimit në raste të caktuara, qoftë kur bëhet fjalë për numrin e njohjeve, qoftë qasjen institucionale që vendi duhet ta ketë. Shumë nga çështjet janë trajtuar më shumë në rrafshin personal sesa në rrafshin institucional. Natyrisht se kjo është e dëmshme për vendin dhe nuk duhet të ndodhte kështu", tha Mushkolaj. Një shembull i mungesës së qëndrimeve unike dhe harmonizimeve në politikën e jashtme është vërejtur këto ditë, kur shefi i



diplocias së Kosovës, Behgjet Pacolli mori pjesë në një konferencë ministrore të vendeve të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik, të mbajtur në Bangladesh.

Një nga tri objektivat e pjesëmarrjes në këtë konferencë, sipas Pacollit, ishte edhe "aplikimi i Kosovës për statusin e vendit vëzhgues në këtë organizatë". Në anën tjetër, zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Gjergj Dedaj, ka paralajmëruar dorëheqje të paravokueshme, nëse Kosova anëtarësohet në këtë organizatë, siç thaj ai, pa një debat në Kuvendin e Kosovës dhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Në një bisedë për Radion Evropian, Dedaj tha se kjo nuk ka të bëjë me kundërshtimin e politikës së ministrit Pacolli, apo për çfarëdo polemike tjetër ndërfaqetare në Kosovë, por që sipas tij, agjenda kryesore në Kosovë është miqësia dhe partneriteti me SHBA-në, anëtarësimi në NATO dhe integrimi sa më parë në Bashkimin Evropian. "Unë si zëvendësministër i Jashtëm në Qeverinë e Kosovës mbetem i tharë i respektimit të agjendave dhe prioriteteve të Kosovës. Dhe për ne, agjendë, prioritet është anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin

Evropian, NATO, INTERPOL, UNESCO dhe në të gjitha institucionet tjera të cilat nuk kanë premisa prefikse apo fikse, qofshin ato islamike apo krishtere. Sepse, Kosova nuk e ka atë luks për shkak të përbërjes dhe strukturës konfesionale në Kosovë, që t'i vëmë agjendat para anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian", tha Dedaj.

Në anën tjetër, Emrush Ujkani, profesor i të Drejtës Evropiane tha për Radion Evropian se deklaratat e tilla kontradiktore nuk sjellin efekte pozitive në ecjen përpara të shtet-bërjes së Kosovës dhe njohjes së saj në arenën ndërkombëtare. "Kjo tregon më se miri se sa ka koordinim në institucionet relevante. Në konferencën e Organizatës së Bashkëpunimit Islamik ka mysafirë edhe nga vendet tjera të botës dhe nuk duhet të shikohet me një sy kritik. Ka vende që e kanë njohur Kosovën dhe Kosovës i nevojitet bashkëpunim edhe me këtë organizatë. Kjo nuk do të thotë integrim në të, por për të kërkuar mbështetjen e kësaj organizate", theksoi Ujkani. Ndërkaq, Imer Mushkolaj, thotë se deklaratat, siç ishin ato të zëvendësministrit Dedaj, mund të përcillen me

efekte të dëmshme për Kosovën në planin e jashtëm. Sipas tij, Kosova si shtet duhet ta përcaktojë qartë në politikën e jashtëme se në cilat organizata do të duhej të anëtarësohet dhe në cilat jo.

"Në anën tjetër duhet parë interesin nëse anëtarësimi në ndonjë organizatë që mund të mos jetë e orientuar kah vlerat euroatlantike mund t'i sjell dobi vendit, në kuptimin e njohjeve dhe në kuptimin e bashkëpunimit. Tek e fundit Kosova nuk mund të funksionojë e izoluar. Bashkëpunimi më çfarëdo organizate që mund t'i sjell dobi vendit duhet të jetë i mirëseardhur", tha Mushkolaj. Edhe në të kaluarën, janë vërejtur disa paqartësi të politikës së jashtme e Kosovës dhe numri i njohjeve ndërkombëtare. Deri vonë, institucionet e ndryshme prezantonin shifra të ndryshme rreth numrit të njohjeve. Por, tash për tash, kjo çështje është tejkaluar. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, thuhet se "Republika e Kosovës ka siguruar 116 njohje" dhe se "njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe e sovranitetit të Kosovës do të mbetet prioritet i Ministrisë së Punëve të Jashtme".

VUÇIQ PAS TAKIMIT ME PUTININ

Pa Rusinë, zgjidhja për Kosovën është e pamundshme

Zgjidhja për Kosovën nuk është e mundshme pa Rusinë, ka deklaruar presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, mbrëmë pas takimit me presidentin rus, Vladimir Putin në Moskë. "Pa Rusinë, pa pajtimin e Moskës, është e pamundshme, që është shumë me rëndësi dhe i kam thënë edhe Putinin që të marrë ndonjë zgjidhje", tha Vuçiq. Sipas fjalëve të tij, siç bëjnë të ditur mediat serbe, Rusia do t'i përcjellë me kujdes përmbytjet e bisedimeve me Kosovën

dhe do të reagojë me kohë dhe në mënyrë të duhur, por nuk do të përfshihet direkt në bisedime, sepse, siç thotë Vuçiqi, ato zhvillohen nën mbikëqyrjen e BE-së. "Por, do të marrë pjesë në mënyrë shumë aktive dhe thelbësore në përcjelljen e procesit të tërë dhe raporteve mes Beogradit e Prishtinës.

Veçanërisht ndikimin e faktorit ndërkombëtar në këtë çështje", tha Vuçiq para gazetarëve, transmeton Koha.net. "Më duket se

asnjëherë më parë s'kemi biseduar më gjatë për raportet mes Beogradit e Prishtinës dhe për raportet përbrenda bashkësisë ndërkombëtare. Qëndrimet tona përpunohen në shumë aspekte", shtoi ai. Vuçiqi tha të ketë përsëritur disa herë se Serbia është e gatshme për kompromis me shqiptarët e Kosovës "por nuk është e as që do të jetë asnjëherë e gatshme të pranojë shkatërrimin dhe rrënimin e plotë të së drejtës ndërkombëtare".



PREZANTOHESHIN SI ISIS-i, RUSËT KËRCËNUAN GRATË E USHTARËVE AMERIKANË



Associated Press ka gjetur prova se, gratë ishin shënjestruar jo nga xhihadistët, por nga i njëjti grup hackerash rusë që ndërhyjnë edhe në zgjedhjet amerikane dhe ekspozuan emaillet e kreut të fushatës presidenciale të Hillary Clintonit, John Podesta

Bashkëshortja e një ushtaraku, Angela Ricketts ishte zhytur në vaskë në shtëpinë e saj në Kolorado,

duke shfletuar disa nga kujtimet e saj, kur papritur një mesazh i del në "iPhone"-in e saj nga disa hakera, të cilët e kërcënonin se do t'i therrnin të gjithë pjesëtarët e familjes. "E dashur Angela - niste mesazhi i dërguar nga ata në Facebook. - Gëzofsh një Shën Valentin të përgjakshëm!". "Ne dimë gjithçka mbi ty, bashkëshortin tënd dhe fëmijët tuaj", vazhonte më tej mesazhi, i cili pretendonte se hakera që vepronin nën flamurin e militantëve të Shtetit Islamik kishin siguruar qasje në kompjuterin dhe telefonin e saj. "Jemi shumë më pranë nga ç'mund ta imagjinosh".

Ricketts ishte vetëm njëra nga pesë bashkëshortet e ushtarëve amerikanë që kanë marrë kërcënime me vdekje nga i vetëquajturi "CyberCaliphate" mëngjesin e 10 shkurtit të vitit 2015. Kërcënimet sollën për pasojë ditë të tëra mbulimi mediatik mes shqetësimeve mbi qasjen që kishin siguruar militantët e Shtetit Islamik. Me përjashtim të faktit se...ata nuk ishin të ISIS-it.

"Associated Press" ka gjetur prova se, gratë ishin shënjestruar jo nga xhihadistët, por nga i njëjti grup hackerash rusë që ndërhyjnë edhe në zgjedhjet amerikane dhe ekspozuan emaillet e kreut të fushatës presidenciale të Hillary Clintonit, John Podesta. Rasti është përfshirë tashmë në studimin e vështirësive të gjetjes së fajtorëve të vërtetë në një botë ku hakerat huazojnë thuajse në mënyrë rutinë identitetin e njëri-tjetrit, për t'i larguar hetuesit nga gjurmimi i tyre.

Lidhjet mes "CyberCaliphate" dhe piratëve rusë të informatikës, të mbiquajtur zakonisht si "Fancy Bear" ose "APT28", janë dokumentuar edhe më herët. Në të dyja anët e Atlantikut ekziston një konsensus i gjerë se dy grupet kanë lidhje të afërta. Por, ky konsensus nuk ka mundur të arrijë kurrë te gratë e përfshira, shumë prej të cilave janë ende të bindura se janë shënjestruar nga simpatizantë të Shtetit Islamik, deri kur Associated Press i kontaktoi ato.



Asgjësohen 20 mijë zogj pule në aeroportin e Brukselit

Në aeroportin e Brukselit janë asgjësuar me gaz 20 mijë zogj pule brenda kontejnerëve. Sipas lajmit në mediat belge, ka ndodhur problem në transportimin e 20 mijë zogjve pule në kontejnerët e sjellë në Aeroportin e Brukselit, të cilat do të dërgoheshin në kryeqytetin e Kongos, Kinshasa. Zyrtarët e aeroportit duke u lajmëruar tek kompania e transportit kërkuan që të largohen kontejnerët që kanë mbetur në asfaltin e nxehtë dhe në të cilën gjendeshin zogj pule. Por kompania e refuzoi këtë kërkesë.

Pasi që disa zogj pule filluan të ngordhin nga i nxehti, zyrtarët thirrën veteriner në aeroport. Veterineri vendosi që "të vihen në gjumë zogjtë për t'iu dhënë fund dhimbjeve të tyre". Zjarrfikësi i aeroportit nuk pranoi që të zbatojë këtë detyrë, ndërsa ekipet e zjarrfikësës të qarkut Zaventem shkatërruan me gaz 20 mijë zogj pule. Njësia Flamane e Mbrojtjes së të Drejtave të Kafshëve, u ankua tek autoritetet përkatëse që të fillohet një hetim ndaj kompanisë importuese.

BE bashkohet kundër politikave të Trumpit



Presidenti i Këshillit Evropian të Bashkimit Evropian (BE), Donald Tusk tha se BE do të veprojë në unitet pas deklaratës së presidentit amerikan Donald Trump i cili njoftoi vendimin e tij për t'u tërhequr nga marrëveshja bërthamore me Iranin. Në një mesazh të publikuar në llogarinë e tij në rrjetin social Tusk tha se "BE-ja do të veprojë në unitet përballë

politikave të presidentit amerikan Donald Trump në lidhje me marrëveshjen bërthamore me Iranin dhe në lidhje me tregtinë". Pasi ka rikujtuar se liderët e BE-së do të mblidhen së bashku më 17 maj në Sofje të Bullgarisë, Tusk ka ndarë informacionin se çështjet për marrëveshjen bërthamore me Iranin dhe për tregtinë do jenë në agjendën e samitit.

Kurdi që sfidon Erdoganin, fushatë për president nga burgu

Lideri kurd i Partisë Demokratike Popullore (HDP) po sfidon Presidentin aktual të Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, me fushatën për president nga qelia e burgut. Nga burgu ku ndodhet që prej Nëntorit të vitit 2016, 45-vjeçari Selahattin Demirtas ka publikuar të martën premtimet elektorale për zgjedhjet presidenciale të 24 qershorit. Në një postim të Twitter, ai shkruan të gjitha premtimet e tij me fokus tek pensionistët, sidhe

për fuqizimin e grave dhe të rinjve. "Me shpirt do toja që këto t'i flisja ballë për ballë me ju. Për momentin, të mjaftohem me ndarjen e mendimeve të mia nga këtu. Përsëritje, me krahë të lehtë", shkroi Demirtas në një publikim ku kishte etiketuar edhe gazetarin Fatih Portakal. Demirtas akuzohet nga prokuroria për pjesëmarrje dhe propagandë në favor të organizatës terroriste kurde PKK. Për të është kërkuar dënimi me 142

vite burg, por vetë 45-vjeçari i cilëson akuzat si politike. Erdogan dhe Demirtas kanë qenë përballë edhe në zgjedhjet presidenciale të vitit 2014, kur Erdogani u zgjodh president që në turin e parë me 52 për qind të votave, ndërsa Demirtas mori rreth 10 për qind. Por kjo garë paraqitet edhe më e ashpër nga ajo e 2014-ës dhe votat e Demirtasit mund të rezultojnë vendimtare nëse Erdogan nuk arrin të zgjidhet në raundin e parë.





REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 45/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Qytetin e Shkupit “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B03000 Ndihmës
udhëheqës i sektorit për përkrahje të Prefektit

1 realizues(ë)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 31.305,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalues për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca për letërsi, shkenca juridike ose shkenca ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30

Rroga neto: 24.998,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Rom(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 46/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Ndërmarrjen publike për veprimtari energjetike “Strumica - Gas” Strumicë “për vendet e punës në vijim:

1. KDR0102V01067 Këshilltar për çështje administrative juridike dhe menaxhim me resurse njerëzore, Njësia për çështje profesionale administrative dhe të përgjithshme, Shërbimi administrativ profesional

1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalues për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 20.979,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 47/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucion publik komunal për fëmijë Çerdhen e fëmijëve “Kalinka” Valandovë “për vendet e punës në vijim:

1. DEZ0102V04001 Bashkëpunëtor i ri - sekretar, Shërbimi për udhëheqje të punëve administrative dhe menaxhim me resurset njerëzore, Shërbimi administrativ

1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalues për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 19.998,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

MILINGONAT E KUQE

Skudra që po tmerron Afrikën e Jugut



Kompania është jashtëzakonisht jashtë rregullave në Afrikën e Jugut dhe është akuzuar vazhdimisht për krime që variojnë nga vjedhja në vrasje. Është kritikuar ashpër nga aktivistët e të drejtave të njeriut. Por qëndrimi i publikut të gjerë është më ambivalent - dhe vetë "Milingonat e Kuqe" janë shumë besnikë ndaj njëri-tjetrit dhe punëdhënësve të tyre

"Milingonat e Kuqe" janë një kompani private e sigurimit në Afrikën e Jugut e specializuar në pastrimin e "pushtuesve të paligjshëm" nga pronat. Dy herë në javë, nganjëherë tre herë në javë, një kolonë kamionësh ikën nga portat e një fasade të varfër në provincën e Gauteng, duke mbajtur qindra burra të shoqëruar nga "oficerët" të armatosur me armë dhe pistoleta. Kompania është jashtëzakonisht jashtë rregullave në Afrikën e Jugut dhe është akuzuar vazhdimisht për krime që variojnë nga vjedhja në vrasje. Është kritikuar ashpër nga aktivistët e të drejtave të njeriut. Por qëndrimi i publikut të gjerë është më ambivalent - dhe vetë "Milingonat e Kuqe" janë shumë besnikë ndaj njëri-tjetrit dhe punëdhënësve të tyre. "Ne jemi një familje. Ne kujdesemi për njëri-tjetrin ... Ne kemi ndërtuar një komunitet", thotë Johan Bosch, fermeri që themeloi dhe zotëron kompaninë.

NDËRTESAT SHKATËRRUESE TË JOHANESBURGUT

Mungesa e strehimit adekuat është një nga trashëgimet më toksike të regjimit të apartheidit që qeveriste Afrikën e Jugut për gati 50 vjet. Familjet, punëtorët migrantë, studentët dhe njerëzit e pastrehë paguajnë ndërmjetës për djerrina rreth Pretorias dhe Johannesburgut ose për ndërtesa të braktitura në qendrat e qyteteve. Autoritetet lokale tregojnë pak simpati dhe thonë se duhet ta zbatojnë ligjin. Zbatuesit e tyre të zgjedhur janë policia dhe, për të siguruar fuqinë punëtore për dëbimet, përdorin skuadrën e "Milingonave të Kuqe".

Fattis Mansions ishte dikur një bllok banesash në modë në vitet 1930 në zemër të rrethit bankar dhe juridik në Johannesburg. Banorët e pasur, kryesisht të bardhë, ikën nga qendra e Johannesburgut në fund të viteve 1980 dhe fillim të viteve 1990, duke lënë qindra ndërtesa për t'u marrë nga migrantët e varfër nga zonat rurale. Katërqind njerëz ndanin së bashku tre çezme uji. Nuk kishte tualete apo energji elektrike. Autoritetet e qytetit kanë pastruar këto "ndërtesa të rërbyera" një nga një për shumë vite - shpesh duke përdorur "Milingonat e Kuqe".

Operacioni, ku përfshihen 600 milingona të kuqe, fillon në mëngjes herët, pa paralajmërim. Sirenat policore të përgjakshme mbushin rrugët e ngushta. "Milingonat e Kuqe" derdhen përmes një hyrje, pastaj vazhdojnë me shkallët e ndryshkura të hekurit dhe poshtë korridoreve të ndyra. Nuk ka rezistencë. Pushuesit, liderët e bandës dhe çoroditësit e qirasë kanë shkuar. Kënga fillon, e ulët dhe e

qëllimshme, siç punojnë Milingonat e Kuqe. Fëmijët janë nxjerrë jashtë, të ndjekur nga nënat në gjendje të vështirë duke kapur sendet e pakta me qese plastike. Shumica e të rriturve e dinin se kjo do të ndodhte një ditë. Për ata që janë shumë të rinj për të kuptuar, qielli ka rënë.

KUSH JANË BURRAT NË UNIFORMAT E KUQE?

Ata vijnë nga fshatra të vegjël të dikurshëm të varfër, nga fshatra të largëta krahinorë në malet e thata, nga Soweto, nga lagjet e tmerrshme gjysmë të fshehura pas pjesës urbane të Johannesburgut. Shumica janë të rinj. Shumë prej tyre nuk kanë kualifikime bazë arsimore. Disa kanë të dhëna kriminale. Disa janë ish-të dënuar. Të gjithë janë të varfër. Ata paguhen gati 10 dollarë në ditë, plus ushqim. Shumë prej tyre janë vetë banorë.

HUMBJA E NJË PREJ TYRE

Milingonat e Kuqe janë plagosur shpesh, ndonjëherë edhe janë vrarë. Kervin Woods vdiq kur pushtuesit e tokës hapën zjarr në Lenasia në Jug. Anëtarët e komunitetit e therën atë, disa duke përdorur kaçavida, pasi ai ra në tokë.

Shpejt nisën përgatitjet për të djegur trupin e tij, por "Milingonat e Kuqe" filluan të shtënat me armë duke shpërndarë turmën. Funerali i Woods bëhet në Soweto. Halla e të vdekurit qan, ngushëllohet nga një pjesë e vogël e anëtarëve të familjes dhe fqinjëve. Udhëheqësit e lartë e përshëndesin arkivolin dhe japin eulogji të shkurtra, para se të këndojnë himnet pasi arkivoli të mbyllet.





Në bazë të Programit për aktivitetet për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018-2019 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 5/2018), Qyteti i Shkupit shpall:

Thirrje publike

për tubimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018, të destinuar për realizimin dhe financimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018

Përcaktimi i mjeteve në Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2018, Nën programi G1, të destinuar për financimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018 do të kryhet në përputhje me Planin aksionar për implementimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018 dhe kriterëve dhe prioritetëve të dhëna në këtë Thirrje publike.

1. Lloji i projekteve që do të përkrahen

Në suazat e kësaj Thirrjeje publike do të përkrahen:

a) Projekte dhe aktivitetet nga Programi për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018, nga fushat e mëposhtme me prioritet:

- Ofrimi i informacioneve dhe i këshillave përmes shoqatave për mbrojtjen e shpenzuesve në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e shpenzuesve;
- Analiza e problemeve të qytetarëve, të shqyrtuara përmes këshillimeve të realizuara dhe ofrimi i propozimeve deri te Këshilli për mbrojtjen e shpenzuesve të Qytetit të Shkupit për përcaktim të prioritetëve të veprimit;
- Bashkëpunimi i Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit me Këshillin për mbrojtjen e konsumatorëve të Qeverisë së RM-së dhe koordinimin e aktivitetëve me qëllim të realizimit të aktivitetëve të përbashkëta për avancim të mbrojtjes së konsumatorëve;
- Përgatitja, botimi dhe promovimi i materialeve informative dhe materialeve tjera promovuese për të drejtat e konsumatorëve në bazë të prioritetëve të përcaktuara për informim, që janë shqyrtuar përmes këshillimit të shpenzuesve;
- Realizimi i fushatës për fuqizim dhe ngritje të vetëdijes së shpenzuesve në fusha të caktuara të mbrojtjes së drejtave të tyre, në pajtim me prioritetet e përcaktuara me Këshillin për mbrojtjen e shpenzuesve të Qytetit të Shkupit;
- Iniciativa drejtuar komunitetit të biznesit në territorin e Qytetit të Shkupit për një marrëdhënie të drejtë ndaj konsumatorëve dhe promovimin e praktikave dhe mjeteve për zgjidhjen e konflikteve midis palëve;
- Bashkëpunimi me dhomat ekonomike në Republikën e Maqedonisë, organizimi i seminareve dhe planifikimi i aktivitetëve të përbashkëta;
- Organizimi i punësive me ndërmarrjet publike në territorin e Qytetit të Shkupit me qëllim një qëndrim më të mirë ndaj konsumatorëve;
- Iniciimi i përfshirjes më të mirë të mbrojtjes së konsumatorëve në procesin mësimor në arsimin e mesëm nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me stafin mësimdhënës dhe nxënësit;
- Zbatimi i aktivitetëve të tjera në koordinim me politikën e konsumatorit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, të cilat do të shfaqen si prioritet në përputhje me kërkesat e BE-së në bazë të Kapitullit 28 - Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndeti publik.

2. Korniza kohore dhe shuma e përgjithshme e mjeteve të parashikuara të arritshme

Mjetet kanë të bëjnë për vitin 2018.

Shfrytëzimi i mjeteve do të specifikohet në kontratën ndërmjet realizuesit të Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018 dhe Qytetit të Shkupit.

3. Kriteret themelore organizuese

Kriteret themelore organizuese që duhet t'i plotësojnë subjektet që marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Të jenë të regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë;
 - Të mos shfrytëzojnë mjete ose të mos kenë deponuar aplikim nga/deri te organet e tjera të administratës shtetërore ose burime tjera për të njëjtin qëllim dhe aktivitetet për të cilat deponojnë aplikimin dhe që do të nënkuptonte financim të dyfishtë të këtyre aktivitetëve nga burime të ndryshme;
 - Përvoja në fushën përkatëse.
4. Kriteret që duhet t'i plotësojnë subjektet
- Vlerësimi i fletëparaqitjeve të subjekteve që i plotësojnë kriteret themelore organizative, do të realizohet në bazë të kriterëve vijuese:

Kriteret	Pikët maksimale
1. Struktura organizuese dhe resurset	40
1.1 A posedojnë institucionet strukturën e nevojshme organizative dhe resurset njerëzore për realizimin e programit (të punësuarit, vullnetarët aktivë, personat e angazhuar me honorar, përfaqësimit i balancuar i femrave dhe meshkujve në organizatë)	10
1.2 Persona profesional që marrin pjesë në realizimin e projektit	10
1.3 A posedojnë institucionet me ambiente të zyrave dhe pajisje teknike për realizimin e programit	10
1.4 A e tejkalon buxheti vjetor i institucioneve për vitin e fundit kalendarik vlerën e grandit	10
2. Bashkëfinancimi i projektit	10
2.1 A siguron subjekti përqindjen e pjesëmarrjes së tij në realizimin e programit	10
3. Cilësia e projektit	50
3.1 Në ç'masë do të kontribuojë qëllimi i përgjithshëm i Programit për realizimin e prioritetëve të përcaktuara, sa është i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate.	10
3.2 Zgjidhje të ofruara cilësore dhe inovative në propozim program	10
3.3 Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera	10
3.4 A është i qartë dhe i realizueshëm plani për realizimin e Programit	10
3.5 A është real plani i propozuar financiar (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive dhe pozicioneve është i harmonizuar me çmimet e tregut)	10

Çdo fushë e kriterëve të posaçme programore do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me kuptimin e mëposhtëm: 1 – jo, 5 – pjesërisht dhe 10 – po.

5. Dokumentacioni i domosdoshëm të cilin subjektet duhet ta deponojnë së bashku me Fletëparaqitjen për realizimin dhe financimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018.

Përkaj Fletëparaqitjes për realizimin dhe financimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018, e cila duhet të plotësohet (me shkronja shtyp në alfabetin cirilik), të nënshkruar nga përfaqësuesi i subjektit dhe të vërtetuar me vulën e subjektit, subjektet patjetër duhet të deponojnë shtojcat e mëposhtme:

- Statuti i subjektit;

- Fotokopje e vendimit për regjistrimin e subjektit;
- Raport për mjetet e marra nga Buxheti i Qytetit të Shkupit në vitin e kaluar fiskal dhe mënyra e realizimit të tyre (nëse subjekti ka qenë përfitues i mjeteve të ndara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2017);
- Raport vjetor i subjektit për programet dhe aktivitetet e realizuara nga fusha e mbrojtjes së konsumatorëve për vitin 2017;
- Deklarata e subjektit se nuk ka fituar mjete ose se nuk ka parashtruar fletëparaqitje nga / deri në organin tjetër të drejtorisë shtetërore ose burime të tjera për qëllim të njëjtë e që do të nënkuptonte financim të dyfishtë të aktivitetëve nga burime të ndryshme.

6. Dokumentacioni përcjellës

Subjekti të bashkëngjitur duhet të deponojë edhe dokumentacionin përcjellës të mëposhtëm:

- biografi profesionale e personave ekspertë të cilët do të angazhohen në realizimin e Programit,
 - listë referuese ose dëshmi (për shembull: kontratë e nënshkruar) për më së paku 2 projekte në fushën për të cilën do të aplikohet,
 - më së paku dy mendime/referenca nga partnerë ose donatorë për realizimin e projekteve paraprake, dhe
 - përkrahje me shkrim nga organizata të tjera ose subjekte për të cilat është planifikuar të marrin pjesë në realizimin e Programit
 - Planin për realizim të Programit
- Institucionet mund të deponojnë vetëm një fletëparaqitje për përkrahje financiare të Programit.*

Vërejtje: Fletëparaqitjet me dokumentacion jo të plotë ose të deponuara pas skadimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e deponuara nuk kthehen.

7. Afati i deponimit të fletëparaqitjeve

Afati për deponimin e fletëparaqitjeve është 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

8. Periudha e realizimit të Programit

Maj – dhjetor viti 2018

Fletëparaqitja me dokumentacionin e plotë duhet të deponohet nëpërmjet postës, në zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, bul "Linden" nr. 82, 1000 Shkup** nëpërmjet arkivit të Qytetit të Shkupit deri në orën 15 (me shënimin - Sektori për zhvillim ekonomik lokal – Fletëparaqitje për thirrje publike).

Subjektet pjesëmarrëse në thirrje publike do të njoftohen për rezultatet në një afat prej 10 ditësh nga dita e sjelljes së Vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018, të përcaktuara për financimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018.

Fletëparaqitja për realizimin dhe financimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve të Qytetit të Shkupit për vitin 2018 është në dispozicion në hapësirat e Qytetit të Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal dhe faqen e internetit të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Kontakt: Biljana Stojmanovska tel: (02) 3 297 284, e-mail adresa: biljana.stojmanovska@skopje.gov.mk.

QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të nenit 6, paragrafi 1, pika 2 dhe neni 7, paragrafi 1, alineja 3 dhe neni 20, paragrafi 2 të Ligjit të Byrosë së zhvillimit të arsimit („Gazeta Zyrtare e R. së Maqedonisë” nr. 37/2006, 142/2008, 148/2009, 69/13, 120/13, 148/13, 41/14, 30/16 dhe 64/18), neni 3 paragrafi 1 alineja 1, neni 4 paragrafi 1, 4 dhe 5, neni 5, neni 10 dhe neni 11, paragrafi 1, alineja 3 dhe paragrafi 2 të Rregullores për mënyrën, veprimin dhe kriteret e zgjedhjes së bashkëpunitorëve të jashtëm dhe përcaktimi i shumës së kompensimeve autoriale dhe kompensimet e shërbimeve tjera të Byrosë së zhvillimit të arsimit nr. 01-2840/1 prej 16.04.2009, nr. 01-10943/1 prej 09.10.2009, nr. 01-12210/1 prej 18.11.2009, nr. 01-1207/2 prej 08.11.2013, nr. 01-534/1 prej 04.06.2014 nr. 01-534/2 prej 13.10.2014 dhe nr. 01-534/3 prej 31.10.2014 dhe Memorandumit për bashkëpunimin e kontraktuar ndërmjet Konsorciumit udhëhequr nga Archidata srl – Italia dhe Byroja e zhvillimit të arsimit nr. 03 -888/1 prej 04.05.2018, Byroja e zhvillimit të arsimit **publikon**

KONKURS

për zgjedhjen e bashkëpunitorëve të jashtëm për punën profesionale të Byrosë së zhvillimit të arsimit

1. Për përpilimin e programeve të reja mësimore për nxënësit në arsimin e mesëm profesional :

1.1. Lëndët mësimore nga *Moduli i përbashkët i përgjithshëm arsimor* (lëndët mësimore të përfshira në gjithsej 14 sektorët e arsimit profesional);

- Gjuhë dhe letërsi maqedone – prej vitit të parë deri në vitin e katërt – 3 orë në javë;
- Gjuhë dhe letërsi shqipe – prej vitit të parë deri në vitin e katërt – 3 orë në javë;
- Gjuhë dhe letërsi turke – prej vitit të parë deri në vitin e katërt – 3 orë në javë;
- Gjuhë dhe letërsi maqedone për nxënësit e komuniteteve tjera – prej vitit të parë deri në vitin e katërt – 2 orë në javë;
- Gjuhë angleze – prej vitit të parë deri në vitin e katërt – 2 orë në javë;
- Histori – në vitin e parë dhe të dytë – 2 orë në javë;
- Kulturë muzikore – në vitin e parë – 1 orë në javë;
- Art figurativ – në vitin e parë – 1 orë në javë;
- Arsim qytetar – në vitin e parë – 2 orë në javë;
- Informatikë – në vitin e parë – 2 orë në javë;
- Sport dhe aktivitetet sportive – prej vitit të parë deri në vitin e katërt – 2 orë në javë.

1.2. Programet mësimore *për sektorin e caktuar* varësisht nga nevojat e sektoreve të veçanta;

- Matematikë – në vitin e parë 3 orë, të dytin 3 orë, të tretin 2 orë, në vitin e katërt 2 orë në javë;
- Matematikë – në vitin e parë dhe të dytë – 3 orë në javë;
- Matematikë – në vitin e parë dhe të dytë – 2 orë në javë;
- Informatikë – në vitin e 2 – 2 orë në javë;
- Fizikë – në vitin e parë dhe të dytë – 2 orë në javë;
- Kimi – në vitin e parë dhe të dytë – 2 orë në javë;
- Biologji – në vitin e parë dhe të dytë – 2 orë në javë;
- Gjeografi – në vitin e parë – 2 orë në javë;
- Gjuhë gjermane (gjuhë e dytë e huaj) – nga viti i parë deri në vitin e katërt – dy orë në javë;
- Gjuhë frënge (gjuhë e dytë e huaj) – prej vitit të parë deri në vitin e katërt – dy orë në javë;
- Gjuhë ruse (gjuhë e huaj e dytë) – prej vitit të parë deri në vitin e katërt – 2 orë në javë;
- Gjuhë italiane (gjuhë e huaj e dytë) – prej vitit të parë deri në vitin e katërt – 2 orë në javë;
- Sociologji – vitin e tretë – 2 orë në javë.
- Psikologji dhe logjikë – vitin e katërt – 2 orë në javë.

1.3. Lëndët mësimore arsimore të përgjithshme të cilat janë të përfshira në Modulin Zgjedhor në planin mësimor për arsim teknik;

- Matematikë – vitin e tretë dhe të katërt – 2 orë në javë;
- Fizikë - vitin e tretë dhe të katërt – 2 orë në javë;
- Kimi - vitin e tretë dhe të katërt – 2 orë në javë;
- Biologji - vitin e tretë dhe të katërt – 2 orë në javë.

2. Rangimi dhe përzgjedhja e bashkëpunitorëve të jashtëm do të bëhet sipas kriterëve vijuese:

a) **për bashkëpunitorët e shkollave:**

- arsimin sipëror për lëmin adekuate;
- minimum tre vjet përvojë në punën edukative – arsimore;
- punime të publikuara profesionale që janë me rëndësi për avancimin e arsimit dhe edukimit, në mënyrë të pavarur apo si pjesë e ekipit;
- pjesëmarrje me punimet e tyre në tubimet profesionale nga lëmi i arsimit;
- pjesëmarrje në projektet hulumtuese – zhvillimore nga lëmi i arsimit.

b) **për bashkëpunitorët e fakulteteve dhe institucioneve:**

- së paku studime të magjistraturës;
- përvojë pune në veprimtarinë edukative – arsimore apo shkencore;
- punime të publikuara profesionale apo shkencore që janë me rëndësi për avancimin e edukimit dhe arsimit;
- pjesëmarrje me punimet e veta shkencore dhe profesionale për arsim;
- pjesëmarrje në projektet hulumtuese – zhvillimore në arsim.

c) **Kriteret plotësuese për zgjedhjen e bashkëpunitorëve të jashtëm janë:**

- njohja e shkathtësive kompjuterike;
- aftësitë dhe shkathtësitë tjera për kryerjen e punëve.

Për përpilimin e secilit program mësimor do të zgjidhen më së shumti 3 (tre) bashkëpunitorë të jashtëm të cilët i plotësojnë kriteret e pikës 2 (a) dhe deri 2 (dy) bashkëpunitorë të jashtëm të cilët i plotësojnë kriteret e pikës 2 (b).

Mënyra e aplikimit dhe përzgjedhja e bashkëpunitorëve

Kandidatët duhet të dërgojnë fletëparaqitje në të cilën do të aplikohet pika nga konkursi për të cilin parqiten dhe dokumentacioni vijues: biografia, vërtetimi për përvojë pune, certifikatë dhe ngjashëm, punime profesionale për plotësimin e kushteve të caktuara me konkursin e publikuar.

Konkursi zgjat **5 (pesë)** ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit për informimin publik, duke mos konsideruar ditën e publikimit.

Bashkëpunitorët e jashtëm të përzgjedhur të cilët do të jenë të inkuadruar në ekipin profesional e bëjnë dërgimin e programit mësimor në Byronë që ka të drejtë të bëjë ndryshime profesionale dhe plotësime për shkak të përmirësimit të cilësisë.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e pakompletuar (biografia, vërtetim për përvojë pune, vërtetimi, certifikatë etj, punimet profesionale përkatësisht shkencore për plotësimin e kushteve të caktuara me konkursin publik) dhe që nuk dërgohen në kohë nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

Aplikimet me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohen në arkivin e Byrosë së zhvillimit të arsimit – Shkup apo me postë me fletëdërgesën e rekomanduar në adresën e mëposhtme: Byroja e Zhvillimit të Arsimit, rr. „Rugjer Boshkoviq” nr. 20, Karposh II, faksi postal 172, 1000 Shkup, (personi për kontakt Emilija Panovska, adresa elektronike: emilijapanovska@bro.gov.mk, tel.3064 – 131 lok.145)

Byroja e Zhvillimit të Arsimit

Ndeshja zhvillohet në stadiumin në Kërçovë dhe do të jetë rasti i fundit për skuadrën nikoqire për të kapur pozitën e dytë, e cila qon në balotazh, derisa Gostivari do të tentojë të fitojë ndeshjen dhe të vazhdojë betejën për pozitën e parë me Makedonia Gj.P. me të cilën do të përballet në xhiron e fundit në Gostivar

NË PRAG TË DERBIT SHQIPTAR NË LIGËN E DYTË

RASTI I FUNDIT PËR VËLLAZËRIMIN DHE GOSTIVARIN



Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 9 maj - Jo vetëm në Ligën e parë, por edhe në të dytën kampionati është bërë interesant, sidomos në garën për plasman në elitën e futbollit vendor. Në garë janë tre ekipe, prej tyre dy shqiptare, Gostivari dhe Vëllazërimi, derisa lider aktual është skuadra e Makedonia Gj.P. Skuadra shkupjane kryeson me 53 pikë, e ndjek Gostivari me 50, ndërsa Vëllazërimi gjendet në pozitën e tretë me 49 pikë. Ndryshe, në Ligën e parë direkt plasohet skuadra e cila do të zen vendin e parë, ndërsa vendi i dytë luan balotazh për plasman në këtë kompeticion. Deri në fund kanë mbetur edhe dy xhiro, ndërsa shumë gjëra do të qartësohen pikërisht këtë të shtunë, pasi njëra kundër tjetrës do të përballet dy skuadrat shqiptare, Vëllazërimi dhe Gostivari. Ndeshja zhvillohet në stadiumin në Kërçovë dhe do të jetë rasti i fundit për skuadrën nikoqire për të kapur pozitën e dytë, e cila qon në balotazh, derisa Gostivari do të tentojë të fitojë ndeshjen dhe të vazhdojë betejën për pozitën e parë me Makedonia Gj.P. Nga të dyja taboret, respektivisht trajnerët e të dyja skuadrave Xhen-

gis Rexhepi (Vëllazërimi) dhe Mensur Jakupi (Gostivari) thonë se synimin kryesor i tyre janë tre pikët.

Trajneri i Vëllazërimit thotë se ndaj Gostivarit i pret një ndeshje derbi ku me fitore eventuale ata do të mbeten në garë për balotazh për plasman në Ligën e parë. "Sa i përket ndeshjes ndaj Gostivarin, na pret një ndeshje derbi ku me fitore ne do të luajmë në balotazh për plasman në Ligën e parë. Ndërkaq, ky fakt e bënë ndeshjen më të rëndësishme. Pritshmëritë e mia për këtë ndeshje janë që të luhet një ndeshje fer dhe le të fitojë më i miri. Jemi përgatitur maksimalisht për këtë përballje, nuk na intereson pozita në të cilën gjendet Gostivari, pasi ne javën e kaluar e dëshmuam veten kundër Makedonia Gj.P., ku ndeshjen e humbëm pas gabimeve tona dhe kjo na kushtoi me humbjen e gjasave për pozitën e parë", u shpreh për gazetën KOHA, trajneri i skuadrës kërçovare, Xhengis Rexhepi. Ndërkohë, lajm i mirë për klubin kërçovar është se futbollistët e lënduar Burhan Aliji dhe Murat Adili, janë rikthyer në stërvitje dhe me siguri do të nisin ndeshjen nga minuta e parë.

Në anën tjetër, trajneri i Gostiva-

Në rast se skuadra e Gostivarit arrin të mposht të shtunën Vëllazërimin, kurse Makedonia Gj.P. "Gorno Lisiçen", xhironja e fundit do të vendos se kush do të plasohet në Ligën e parë, pasi do të përballet pikërisht Gostivari dhe Makedonia Gj.P. Rregullorja sipas asaj që arritëm të kuptojmë thotë se: Nëse Gostivari para tifozëve të saj mund Makedonia Gj.P. me rezultatin 1-0, atëherë Gostivari do të përfundon i dyti, Mkd.Gj.P. do të plasohet në LPFM-së, ndërsa nëse arrin fitore me 2-0, atëherë do të luhen dy ndeshje dhe skuadra e cila do të del fituese nga këto dy përballje, do të luajë sezonin e ardhshëm në Ligën e parë, derisa me fitore eventuale 3-0, atëherë Gostivari do të plasohet direkt në Ligën e parë.

rit, Mensur Jakupi thotë se ndeshjet kundër Vëllazërimit gjithmonë kanë qenë interesante, ndërsa kësaj radhe presioni bie mbi atë dhe

djemtë e tij të skuadrës. "Çdo ndeshje në fund të kampionatit mund të llogaritet derbi për shkak të rëndësisë së ndeshjeve. Si zakonisht ndeshjet ndërmjet Vëllazërimit dhe Gostivarit janë interesante, por në këtë situatë, presioni bie mbi ne pasi me fitore kemi gjasa reale të plasohemi në pozitën e parë dhe të inkuadrohemi në elitën e futbollit vendor, duke marr parasysh se në fund luajmë pikërisht me Makedonia Gj.P. Këtë mund ta arrijmë vetëm nëse mundim Vëllazërimin, në të kundërtën çdo rezultat tjetër do të shkon në favor të Makedonia Gj.P. E them këtë pasi Vëllazërimi nuk ka as gjasa teorike për pozitën e parë", deklaroi për gazetën KOHA, Jakupi. Ndërkohë, në prag të kësaj sfide jashtëzakonisht të rëndësishme, Jakupi po ballafaqohet me probleme. Ersin Fetaj është i suspenduar me tre ndeshje, Fatmir Arifi nuk do të luajë pas lëndimit që e mori ndaj Labunishtit, ndërsa Edin Mersoski për shkak të lëndimit gjithashtu nuk do të jetë në dispozicion për këtë ndeshje. Megjithatë nga skuadra gostivarase pohojnë se kanë fond të mjaftueshëm të lojtarëve të cilët do të mund të arrijnë deri te fitorja.



Fiorentina dhe Napoli në ndjekje të Zenelit

Fiorentina dhe Napoli në ndjekje të Arbër Zenelit. Duke iu referuar asaj që shkruajnë mediat suedeze, duke klubet e njohura italiane kanë shfaqur interes për të marrë shërbimet e talentit të përfaqësues së Kosovës i cili luan tek Herenveen në Holandë. 23-vjeçari pëlqehet shumë nga drejtuesit e Fiorentinës dhe Napolit dhe në merkaton e verës së ardhshme këto dy klube do të tentojnë të afrojnë në gjirin e tyre Arbër Zenelin. Ndryshe, gjatë këtij sezoni Zeneli i cili karrierën e ka nisur tek Elfsborg në Suedi, ka realizuar 6 gola në 23 ndeshje me Herenveen. Kartoni i tij nga faqja e specializuar "transfermarkt.de" vlerësohet 4,5 milionë euro edhe pse vështirë se Herenveen do ta lejojë të largohet për më pak se 6 milionë euro.

Ismajli vishet verdhë e kaltër



Presidenti i FFK-së, Fadil Vokrri, po qëndron për vizitë në Kroaci si mysafir i Hajdukut të Splitit. Me këtë rast presidenti Vokrri ka takuar futbollistin që është pjesë e këtij klubi, Ardian Ismajli dhe menaxherin Enver Raça. Gjatë këtij takimi futbollisti Ardian Ismajli ka konfirmuar se edhe në ardhmen do t'i mbrojë ngjyrat e Kosovës. Në këtë mënyrë janë hequr të gjitha dilemat që ishin ngritur kohë më parë nga mediat dhe janë demantuar zërat dhe shkrimet se Ismajli mund t'i bashkohet Shqipërisë. Ardian Ismajli ka qenë lider i Kombëtarës së Kosovës U21 në ndeshjet për kualifikimet e Evropianit 2019, ku ka pasur paraqitje të shkëlqyeshme. Ai ka treguar formë të mirë edhe në skuadrën kroate, derisa pa dyshim është një potencial i madh i Kombëtarës së Kosovës.

Shabani nënshkruan kontratë profesionale me Bajernin

Meritan Shabani ka nënshkruar dje kontratë profesionale me gjigantin evropian, Bayern Muni. Shabani, i cili me prejardhje është nga Kosova ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2020. Debutimin profesional për Bajernin e bëri në fitoren 4-1 kundër

Aintraht Frankfurtit më 28 prill. Ai është shprehur i lumtur se ka nënshkruar me Bajernin, të cilin e ka quajtur klub të vetin. "Bajerni është klubi im dhe jam shumë i lumtur që kam këtë mundësi", ka thënë ai pas nënshkrimit të kontratës.



Në bazë të nenit 101 paragrafi 1 alineja 7 e Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 104/15 dhe 150/15) nenit 22 paragrafi 1 të Statutit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale - Dellçevë dhe Vendimit të Këshillit drejtues nr. 02-316/2 të datës 07.05.2018, Këshilli drejtues i IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Dellçevë shpall:

SHPALLJE PUBLIKE
Për zgjedhje të drejtorit të IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Dellçevë

Kandidatët e interesuar, krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:

1. Të kenë të mbaruar arsimin sipëror të shkallës VII/1 të përgatitjes profesionale ose 240 kredi sipas SETK ose nga profilet arsimore në vijim: punëtor social i diplomuar, pedagog, psikolog, jurist i diplomuar, ekonomist i diplomuar, defektolog ose sociolog;
Të kenë minimum pesë vjet përvojë pune pas diplomimit;
Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
Posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombtarisht në vijim ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet – TOEFEL IBT së paku 74 pikë, - IELTS – së paku 6 pikë, - ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, - FCE (Cambridge English: First) – të dhënë, - BULATS – së paku 60 pikë ose - APTIS – së paku niveli B2.
Të kenë të përgatitur program për udhëheqje me institucionin.
2. Neto pagesa është 25.679,00 denarë
3. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me biografi të shkurtë;
 - Dëshmi për arsim sipëror të mbaruar përkatës - certifikatë ose diplomë;
 - Vërtetim për përvojë pune pas diplomimit;
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës
 - Dëshmi për posedim të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze
 - Certifikatë të shtetësisë.
4. Dokumentet duhet të dorëzohen në original ose kopje të vërtetuara në noter. Kandidati i cili do të zgjidhet obligohet që të përmbushë kushtin e njohjes së gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes.
5. Shpallja publike zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.
6. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.
7. Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri tek Këshilli drejtues i IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Dellçevë, në adresën në vijim, rr. "Orce Nikolov" pn, Dellçevë.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES
Cvetanka Petrovska

REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA DOGANORE

01.10.00.UP.001.02-OB.05.02

Në bazë të nenit 50 paragrafi 2 të Ligjit doganor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr 39/05, 04/08, 48/10, 158/10, 44/11, 53/11, 11/12, 171/12, 187/13, 15/15, 129/15, 154/15, 192/15 dhe 23/16), nenit 94 paragrafi 2 dhe nenit 148 të Urdhresës për zbatimin e Ligjit doganor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 66/05, 73/06, 40/07, 62/07, 42/09, 48/09, 38/10, 46/10, 61/10, 141/11, 147/11, 158/11, 14/12, 2/13, 92/13, 177/13, 62/15, 11/15, 215/15, 192/16, 21/17 dhe 181/17) dhe pikës 8 të Udhëzimit të Drejtorisë doganore për kushtet minimale dhe mënyrën e përcaktimit të hapësirës punuese ku malli i automjeteve transportuese vihet në shikim dhe bëhet kontrolli nga ana e organeve doganore nr. 01-013669/15-0002 datë 10.03.2015.

DREJTORIA DOGANORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
Shpall
THIRRJE PUBLIKE Nr.2/18
Për mbledhjen e ofertave për të lidhur kontratë për shfrytëzimin e hapësirës punuese për këto organe doganore:

1. Njësia doganore Shkupi 2-1012 (për hapësirën e dedikuar për import dhe eksport – terminal),

Dokumentet të cilat ofruesi duhet t'i dorëzojë dhe kushtet që duhet t'i plotësojë, si dhe mënyra e përzgjedhjes janë dhënë në Udhëzimin për kushtet minimale dhe mënyrën e përcaktimit të hapësirës punuese ku malli i automjeteve transportuese vihet në shikim dhe bëhet kontrolli nga ana e organeve doganore nr. 01-013669/15 datë 10.03.2015 i publikuar në faqen e internetit të Drejtorisë doganore www.customs.gov.mk, në linkun: "Udhëzimi për rregullimin e punës të terminalëve doganore" nga ku edhe mund të merret.

Afati për dorëzimin e ofertave është 14 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike në mjetet e informimit publik. Ofertat të cilat nuk do të dorëzohen në afatin e paraparë, si dhe ato të cilat nuk do t'i përmbajnë të gjitha dokumentet e nevojshme nuk do të merren në shqyrtim.

Ofertat dorëzohen në këtë adresë:

Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë
Sektori për punë administrative dhe teknike
(me shënimin "për Thirrjen publike nr. 2/18")
Rr. L Lazar Ličenovski nr. 13
1000 Shkup

Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopishtes

Tel. ++389 2 27 85 100
Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. Z. nr. 2, f. Sopishte, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk
gradonacelnik@opstinasopiste.gov.mk

Numri i procedurës: 13739
nr. 28-01/17 e datës 07.05.2018

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës publike dhe prezantimit publik në lidhje me Dokumentacionin lokal planor urbanistik për ndërtim të Vikend shtëpisë në PK 1702/1, KK Dobri Doll, Komuna e Sopishtes.

Realizohet prezantim publik dhe anketë publike për Dokumentacionin lokal planor urbanistik për ndërtim të Vikend shtëpisë në PK 1702/1, KK Dobri Doll, Komuna e Sopishtes.

Përfshirja planore e dokumentit Dokumentacioni lokal planor urbanistik për ndërtim të Vikend shtëpisë në PK 1702/1, KK Dobri Doll, Komuna e Sopishtes është me sipërfaqe prej 1249,24 m².

1. Prezantimi publik dhe anketë publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës Sopishte më datë 11.05.2018 në ora 11.00.
2. Anketë publike do të zgjasë deri më 18.05.2018, në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për planifikim hapësor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).
3. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni përkatës të përfshirë në plan në afatin e lartpërmendur të parashtrajnë vërejtje, propozime dhe mendime në listat anketuese në administratën komunale.
4. Informacione në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës së Sopishtes
Stefçe Trpkovski

Koha
<http://www.koha.mk>

Koha
www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, I Q.T. Mavrovazja lok.14 - përdhësë, Shkup

IP "Qendra ndërkomunale për punë sociale" Shtip, duke vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 alineja 2 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016) publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim të 5 (pesë) realizuesve për kohë të pacaktuar

IP "Qendra ndërkomunale për punë sociale" Shtip ka nevojë për punësim të 5 (pesë) realizuesve për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

1. **Punëtor i diplomuar social** në shërbimin për shërbime në mbrojtjen sociale, Departamenti – Këshillimor pranë IP "Qendra ndërkomunale për punë sociale" Shtip.
Kandidatët e interesuar, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror shkalla VII/1 ose 240 kredi sipas SETK, Fakulteti filozofik, dega Punë dhe politikë sociale;
- Të kenë dy vjet përvojë pune në profesion dhe
- Në mënyrë aktive të njohin programet kompjuterike për punë në zyrë.
Pagesa: 23.198,00 denarë.
- Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte.
- Orët e punës në javë: 40 orë të kohës së punës: prej ora 08:30 deri në ora 16:30
2. **Psikolog** në shërbimin për shërbime në mbrojtjen sociale, Departamenti – Qendra ditore për fëmijë me autizëm pranë IP "Qendra ndërkomunale për punë sociale" Shtip.
Kandidatët e interesuar, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror shkalla VII/1 ose 240 kredi sipas SETK, Fakulteti filozofik, dega Psikologji
- Të kenë dy vjet përvojë pune në profesion dhe
- Në mënyrë aktive të njohin programet kompjuterike për punë në zyrë.
Pagesa: 23.198,00 denarë.
- Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë të kohës së punës: prej ora 07:00 deri në ora 15:00
3. **Defektolog** në shërbimin e mbrojtjes sociale Departamenti – Qendra ditore për fëmijë me autizëm pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Shtip.
Kandidatët e interesuar, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror të shkallës VII/1, apo 240 kredi sipas SETK, Fakulteti Filozofik, drejtimi Defektologji
- Të kenë dy vjet përvojë pune në profesion dhe
- Në mënyrë aktive të njohin programet kompjuterike për punë në zyrë.
Pagesa: 23.198,00 denarë.
- Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë të kohës së punës: prej ora 07:00 deri në ora 15:00
4. **Logoped** në shërbimin e mbrojtjes sociale Departamenti – Qendra ditore për fëmijë me autizëm pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Shtip.
Kandidatët e interesuar, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror të shkallës VII/1, apo 240 kredi sipas SETK, Fakulteti Filozofik, drejtimi Logopedi
- Të kenë dy vjet përvojë pune në profesion dhe
- Në mënyrë aktive të njohin programet kompjuterike për punë në zyrë.
Pagesa: 23.198,00 denarë.
- Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë të kohës së punës: prej ora 07:00 deri në ora 15:00

5. **Motër medicinale** në shërbimin e mbrojtjes sociale Departamenti – Qendra ditore për fëmijë me autizëm pranë IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Shtip.
Kandidatët e interesuar, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Të kenë të mbaruar arsimin e mesëm profesional, arsimin e mesëm katërvjeçar profesional – shkencat mjekësore
- Të kenë dy vjet përvojë pune në profesion dhe
- Në mënyrë aktive të njohin programet kompjuterike për punë në zyrë.
Pagesa: 14.643,00 denarë.
- Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë të kohës së punës: prej ora 07:00 deri në ora 15:00

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë Paraqitje, me shtesë të dokumentacionit të nevojshme, original apo kopje të verifikuar në noter:
- biografi të shkurtë;
- Diplomë (certifikatë) për shkallën e arimit të mbaruar e cila kërkohet për vendin e punës;
- Dëshmi (vërtetim) për përvojë pune në profesion;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Vërtetim për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Vërtetim për njohje të gjuhës së huaj;
- Dëshmi për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Certifikatë të shtetësisë.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.
Zgjedhja do të realizohet brenda afatit ligjor, pas përzgjedhjes së realizuar.

Fletëparaqitjen me dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët duhet ta parashtrorin në adresën në vijim:
IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Shtip rr. Partizanska nr. 31A (me shenjë për shpallje publike)
Kontakt tel: 032/385-031; 032/391-779
Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale
për punë sociale - Shtip

Në shpalljen publike për themelimin të marrëdhënies së punës në M-NAV SHA Shkup, të publikuar më datë 09.05.2018 bëhet **korrigjimi** në vijim:

1. Në pjesën e kushteve të posaçme, alineja 1 që ka të bëjë për kandidatin për vendin e punës nën numrin rendor 1 – Këshilltar – Kontabilist i autorizuar për çështje financiare kontabiliteti në Departamentin për financa dhe administratë/Sektori për çështje financiare, çështje juridike, zhvillim dhe investime, fjalët:

" diplomë universitare nga sfera e ekonomisë – drejtimi kontabiliteti bankieri"

Zëvendësohen me fjalët:

" diplomë universitare nga sfera e ekonomisë".

2. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga publikimi i korrigjimit.

"M-NAV" SHA Shkup

Shitet truall 7628 m2, kultura N, klasa 6, në vendin e quajtur KRST, Komuna e Gazi Babës. Të interesuarit mund të paraqiten në numrin e telefonit 075 730-487.

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m² së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m². Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

ATLETIKO NË AKSION KUNDËR BARCELONËS PËR GRIZMANNIN

SJELLJE E PAPRANUESHME, NUK DO TA LËSHOJMË LOJTARIN



“Kur një president, një lojtar dhe një drejtor i klubit flasin në mënyrë të njëjtë, për një lojtar që një kontratë në fuqi, dhe kjo disa ditë larg një finaleje të një gare evropiane, kjo është një mungesë absolute e respektit ndaj Atletiko Madridit dhe të gjithë tifozëve të saj”, pohon drejtori i Atletiko Madridit, Miguel Angel Gil Marin

Spekulimet se Antoine Grizmann do të kalojë te Barcelona, kanë dridhur Atletiko Madridin. Drejtori i Atletiko Madridit, Miguel Angel Gil Marin, ka dhënë një deklaratë të fortë kundër akcionit të klubit katalunas për të nënshkruar me sulmuesi francez. Ka qenë vetë i pari i Barcelonës, Josep Maria Bartomeu, pastaj edhe drejtori Guillermo Amor, e sulmuesi Luis Suarez, e kanë konfirmuar interesim për sulmuesin. “Jemi të lodhur me sjelljen e Barcelonës”, ka thënë

Gil Marin. “Kur një president, një lojtar dhe një drejtor i klubit flasin në mënyrë të njëjtë, për një lojtar që një kontratë në fuqi, dhe kjo disa ditë larg një finaleje të një gare evropiane, kjo është një mungesë absolute e respektit ndaj Atletiko Madridit dhe të gjithë tifozëve të saj”, shtoi më tej Marin. Ndryshe, klauzola e blerjes së Grizmann është 100 milionë euro dhe Gil Marin thotë se Atletico do të ndjekë rrugë të tjera për të marrë kompensim nga Barcelo-

na, nëse ata nënshkruajnë në këtë mënyrë me sulmuesin. “Pozicioni ynë është shumë i qartë dhe është bërë publike në shumë raste. Asnjëherë nuk kemi negociuar për Grizmannin dhe nuk kemi ndërmend ta bëjmë këtë. Personalisht, i thashë presidentit të Barcelonës disa muaj më parë se të drejtat e lojtarit nuk janë në shitje, as nuk do t'i shesim ato. Unë gjithashtu sjelljen e tyre e shoh si të papërshtatshme dhe në kundërshtim me integritetin e konkurrencës,

sepse gjatë sezonit kemi qenë duke konkurruar për titullin e ligës dhe Barcelona e ka vënë vazhdimisht nën presion një nga lojtarët më të rëndësishëm të ekipit tonë”. Sipas Gil Marin, ai i ka thënë Barcelonës që nëse Barcelona e blen lojtarin, do të kërkojë kompensimin për sjelljen e papërshtatshme”. “Mjaft është mjaft, shpresoj që kjo deklaratë do të na ndihmojë që lojtarët tanë të gëzojnë këtë moment dhe të përgatiten për një finale”, përfundoi Marin.



Fekir në Liverpool, Salah drejt Real Madridit

Nabil Fekir drejt Liverpoolit ndërsa Mohamed Salah në Real Madrid. Kështu raportojnë mediat franceze, të cilat supozojnë se Fekir tashmë është transferuar në Liverpool për 70 milionë euro, gjë që jep të dhëna për të ardhmen e Mohamed Salahut. Salah është futbollisti i momentit në Evropë dhe në të gjithë botën. Sulmuesi egjiptian ka qenë protagonist këtë sezon në Ligën Premier ashtu edhe në garën evropiane. Ai ka qenë lojtari më i shquar i trajnerit të “The Reds”, Jurgen Klopp. Për këtë arsye nuk e ndalojnë atë që të lidhet me klubet e mëdha të momentit, duke përfshirë edhe Real Madridin. Një nga të dhënat për largimin e mundshëm është se Liverpooli e ka gjetur tashmë zëvendësuesin, Nabil Fekirin. Francezi 24-vjeçar ka nënshkruar një sezon të suksesshëm në Olimpik Lion, aq shumë sa që në anglezët nuk kanë hezitur të bëjnë oferta. Theksojmë se francezi deri më tani ka shënuar 17 gola dhe ka bërë gjashtë asistime në 28 ndeshje Ligue 1.

Milani përgatit shkëmbimin SILVA-FALKAO

Kërkohet një emër i ri për sulmin te Milani. Të zhgënjyer nga performanca e ofruar nga Kaliniç dhe Andre Silva, drejtuesit e kuqezinjve synojnë një bombardues, që shënon 20 gola në sezon, dhe me përvojë të mirë ndërkombëtare. Vetëm identikit i Radamel Falkao kënaq, i cili, sipas “Tuttosport”, mund të jetë pjesë e një shkëmbimi që do të dërgojë Andre Silva te Monako. Jorge Mendes, një agjent i fuqishëm portugez, i cili thuhet se ka hedhur themelet e çështjes gjatë një darke pune në Madrid, me Mirabellin dhe drejtorin sportiv të Monakos, ta-

shmë po punon për këtë. Falkao sapo ka mbushur 32 vite, por këtë sezon, pas shumë problemeve fizike të së kaluarës, arriti të shënojë 24 gola në të gjitha garat. Një lojtar, që padyshim bën për planet e Milanit. Mbetet të kuptohet se cila do të ishte formula e shkëmbimit eventual dhe mbi të gjitha, nëse Milani mund t'i korrespondojë Falkaos me angazhimin që ai aktualisht percepton në Monte Karlo. Kjo është arsyeja pse në sfond ekzistojnë shumë alternativa: nga Belotti te Manxhukic, duke kaluar përmes Muriel. Merkatoja e kuqezinjve për një sulmues të ri sapo ka filluar.



LAJME SHKURT

DS Junajted, destinacioni i ri i Runit

Për Uejn Runin ka ardhur momenti i largimit nga Premier Liga. Ish futbollisti i Mançester Junajtedit dhe Evertonit është në bisedime të avancuara për të nisur një aventurë të re përtej oqeanit në “Major League Soccer” në radhët e DS Junajted. Agjenti i 32-vjeçarit ka udhëtuar shpesh javët e fundit në SHBA për të arritur një akord dhe ajo që e shtyn më shumë sulmuesin të largohet është edhe raporti i vështirë me Sem Allardajs i cili është konfirmuar në stol edhe për sezonin e ardhshëm.

Duel për Martins

Për Gelson Martins është momenti të largohet nga Sportingu i Lisbonës. Pas problemeve me drejtuesit dhe sezonit jo fort pozitiv të ekipit, sulmuesi i talentuar portugez do të largohet sapo të hapet merkato dhe ofertat ndaj tij nuk mungojnë. Mes shumë ofertave janë dy klube që po insistojnë për 22-vjeçarin, Borussia Dortmund dhe Liverpooli dhe fituesi do të jetë ai që do të ofrojë më shumë pasi me drejtuesit e Sporting është e vështirë të negociohet. Gelson Martins ka një kontratë deri në vitin 2022 dhe çmimi i tij sipas klubit është të paktën 50 milionë euro.

Boatengi thotë jo Betisit

Kevin-Prins Boateng konsiderohet dhurata e drejtuesve të Real Betis për tifozët për kualifikimin në Liga Evropë por ky operacion nuk do të realizohet dhe është agjenti i ganezit që e konfirmon. Edoardo Crnjar e pranoi se ka biseduar me klubin spanjoll për një transferim në verë por si duket palët nuk arriten një akord ekonomik dhe sipas tij 31-vjeçari do të qëndrojë në Bundesligë ku ka edhe 2 vite të tjera kontratë me Aintracht Frankfurt.

Klaivert do të rinovojë me Ajaksin

Është 19-vjeçar dhe ka një mori ofertash nga klube të rëndësishme por Xhastin Klaivert mund të qëndrojë edhe një sezon te Ajaksi. Sulmuesi holandez, i cili ka edhe një vit kontratë me klubin mësohet se po negocion për rinovimin e kontratës dhe gjithçka po drejtohet nga i famshmi Mino Raiola i cili synon ta mbajë edhe një vit te Ajaksi dhe më pas ta transferojë në një ekip të madh por me një vlerë më shumë seç mund ta shesë verën që po vjen. Klaivert pëlqehet prej kohësh nga Mançester Junajtedi, Arsenali, Napoli dhe Roma.

TIAGO SILVA BËN NJË GJEST TË MADH

NGRIT TROFEUN E KUPËS ME KAPITENIN E SKUADRËS KUNDËRSHTARE

Paris Sen Zhermeni fitoi 2-0 ndaj një klubi të vogël francez. Braziliiani ishte në podium me shokët e tij, por ai e ftoi edhe kapitenin e skuadrës kundërshtare në prani të presidentit Emanuel Makron. Kjo pasi klubi francez i ligës së tretë bëri një luftë të madhe me klubin e pasur parisien

Mbrojtësi i Paris Sen-Zhermen, Tiago Silva, e ka ftuar kapitenin e klubit Les Herbiers, Sebastien Floçon, që ta ngritin së bashku trofeun e Kupës së Francës. Në një nga gjërat më të bukura që kemi parë ka ndodhur në ndeshjen mes këtyre dy skuadrave. Paris Sen Zhermeni



fitoi 2-0 ndaj një klubi të vogël francez. Braziliiani ishte në podium me shokët e tij, por ai e ftoi edhe kapitenin e skuadrës kundërshtare në prani të presidentit Emanuel Makron. Kjo pasi klubi francez i ligës së tretë bëri një luftë të madhe me klubin e pasur parisien. Ndryshe, Les Herbiers janë në vendin e 13-të në nivelin e tretë të futbollit francez dhe mund të bie edhe në nivelin e katërt

të premtën në mbremje, por ata u ndjenë krenarë me finalen e së martës. Përplasja mes Davidit dhe Goliat ishte ajo ku përballë ishin dy klube me nivele krejtësisht të ndryshme. Kjo skuadër luan në një stadium me kapacitet prej 5.000 ulësë të "Stade Massabielle" dhe ka vetëm 1.500 tifozë për lojë kur luan në shtëpi. Ata vijnë nga një qytet me 15 mijë banorë. Buxheti i klubit është

1.7 milionë dollar, që i bie se me këto para mund ta paguajnë vetëm për dy javë Nejmarin. Në anën tjetër, Kupa e Francës ka pasur edhe befasi të tjera, kur klubet e nivelit të tretë kishin arritur në finale me Nimes (1996), Amiens (2001) dhe Quevilly (2012). Këtë natë më të bukur e bëri gjesti i madh i Tiago Silvas, i cili mund ta ketë fituar çmimit e sezonit me këtë gjest.

Gomez humb finalen e Ligës së kampionëve

Mbrojtësi i Liverpoolit, Hose Gomez, nuk do të luajë në finalen e "Champions League" kundër Real Madridit dhe në Kupën e Botës 2018 në Rusi, pasi është operuar në kavigj. 20-vjeçari, që u dëmtua në miqësoren e luajtur kundër Holandës, në muajin mars, tentoi të riaftësohet pa operacion, por në dy ndeshjet kundër Uest Brom dhe Stouk pati dhimbje të mëdha, kësajherë, pasi mungoi ndaj Çellsit, vendosi bashkë me stafin mjekësor për një operacion për të zgjidhur përfundimisht problemin. Në këtë mënyrë ai i shpëtoi Adam Lallana, Aleks Oklade-Çamberlen, Emre Xhan dhe Joel Matip në listën e futbollistëve që nuk do të jenë në dispozicion për Klopp në finalen e "Champions League". Gomez ka luajtur 31 ndeshje në këtë sezon, por tanimë do t'i shohë dy sfidat e mbetura, ndaj Brajton dhe Real, si spektator.



Nga ligat amatore te ekipi kombëtar

Kvasi Vriedt është duke përjetuar një përrallë futbollit. Sulmuesi është golashënuesi më i mirë i Amatorëve të Bajern – 20 gola në ligën amatore. Tani ai nëpërmjet një e-maili mori ftesën e parë nga përfaqësuesja ganeze. Lojtari i lindur në Hamburg flet për gjermanen "Bild". "Në momentin e parë isha pa fjalë. Jam shumë i lumtur që do të luaj për vendlindjen e prindërve të mi. Tani do të bëj krenar familjen dhe miqtë e mi. Kjo është qershia mbi tortë pas një sezoni fantastik", shprehet Vriedt. Verën e kaluar ai u transferua te Bajerni nga Osnabruk. Në vjeshtë ai luajti dy herë për profesionistët. Tani ai do të luajë në ndeshjen e Ganës ndaj Japonisë dhe Islandës. "Para dy javësh më kontaktoi trajneri Kvesi Appiah për të parën herë, duke më treguar për planin e tij. Gana kërkon të formojë një skuadër të përbërë nga lojtarë të rinj dhe unë dua të jem pjesë e saj", deklaroi sulmuesi ganez.



HABIT FERGUSON PASI ZGJOHET NGA KOMA

Kërkon nga mjeket të shkojnë në Kiev për finalen e Çampions

Sër Alex Ferguson nuk zhgënjën asnjëherë edhe në momente të tilla kritike për jetën. Pak ditë pas operacionit në tru, për shkak të një hemorragjie cerebrale, trajneri 72-vjeçar ka treguar sërish pasionin e tij për futbollit. Fjalët e para që ka thënë pasi ka dalë nga koma kanë qenë: "Si doli skuadra e Donkaster? (ekipi që drejtohet nga djali i tij Darren)". Më tej, trajneri skocez i ka kërkuar stafit mjekësor nëse do të ishte e mundur të rikthehej në stadium për të parë finale e "Champions League". "E di që për finale e Kupës së Anglisë nuk kam asnjë shans për të qenë në stadium, por a mund të udhëtoj në Kiev?", ka qenë kërkesa e Ferguson. Këto janë sinjale inkurajuese për mjeket dhe familjarët e "sir Alex", që duket se ka kaluar problemet shëndetësore.



Por duket e vështirë që më 26 maj Ferguson, trajneri legjendar i Mançester Junajted të jetë në Kiev për të parë fina-

len mes Liverpoolit dhe Real Madridit, tri javë pas operacionit në tru, duke qenë se është një rrugë e gjatë.

Roma i bën bust ish-kapitenit të përjetshëm

Busti ishte zhdukur. Tani e ka edhe atë. Roma vazhdon t'i paguajë "haraç" ish-kapitenit Françesko Totti. Brenda galerisë "Plus Arte Puls", në "Viale Mazzini 1", do të ekspozohet busti i "Aeterno", i dedikuar për numrin 10 të mëparshëm verdhekuq. Do të ketë një ngjyrosje të dyfishtë (statuja e bardhë dhe fanella e kuqe), teksa statuja paraqet tiparet e të njëjtit Totti. Natyrisht, shkrimi i "Roma 1927" është qartësisht i dukshëm në gjoks. Vepra u krijua nga artisti romak, Stefano Mezzaroma, i lindur në vitin 1984 dhe do të ekspozohet para publikut për herë të parë nga 10 deri më 12 maj.



DASHI 21. mars - 20. prill
 Kjo e mërkurë është një ditë që do ju mësojë shumë gjëra. Sipas parashikimit të ditës, sa i takon dashurisë mund të ketë të reja të rëndësishme, të cilat do ju zbukurojnë ditën. Do të jetë shumë e lehtë të sqaroni një situatë me partnerin, pas një keqkuptimi që keni patur së fundmi. Ata që janë vetëm, prania e Hënës në shenjë, do i ndihmojë që të hedhin një hap më shumë.

DEMI 21. prill - 21. maj
 Kjo ditë do të ecë me hapa të ngadalta dhe nuk do të ketë përmirësime. Dashuria për ju, është një port i sigurtë ku mund të ndaloni dhe pushoni, por gjatë kësaj të mërkure nuk do të jetë aspak e tillë. Ata që janë vetëm, duhet të bëjnë më shumë, për të bërë për vete një person që pëlqejnë. Në punë, nuk do të ndiheni aspak të motivuar dhe do e keni kokën mes reve.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
 Kjo e mërkurë do të jetë mjaft bujare dhe pozitive, në shumë situata. Në dashuri nuk do të mungojnë ndjenjat dhe stimujt pozitiv. Do të jeni mjaft të favorizuar në raportin në çift, duke mbajtur parasysh nevojat e partnerit. Veç bëni kujdes me luhatjet e humorit, në mënyrë që të mos bëni një gabim me personat që nuk i njihni mirë.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
 Do të jetë një ditë relativisht e mirë, ndonëse do të jetë e përfshirë nga rutina dhe normaliteti. Në dashuri këshillohet që të shmangni keqkuptimet e mundshme. Për ata që janë vetëm, yjet parashikojnë situata jo shumë të kënaqshme, madje për disa do të ketë momente të sikletshme. Në punë do të vlerësohet krijimtaria juaj, kështu që mos u tërhiqni mbas nga ajo që keni nisur.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
 Kjo ditë parashikon të jetë mjaft e gëzueshme, sidomos sa i takon jetës në çift. Ata që janë vetëm, do të bëjnë njohje të reja. Për këtë arsye yjet ju këshillojnë që të mos qëndroni vetëm dhe të mos i refuzoni ftesat. Në punë, do të ndiheni të karikuar me energji dhe optimizëm, duke qenë gjatë gjithë kohës në ekuilibrin, të cilin e kishit humbur pak ditë më parë.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
 Parashikohet një ditë jo shumë e favorshme. Në dashuri këshillohet që të veproni në mënyrë racionale. Ajo që ndoshta ju mungon, duhet kërkuar në mënyrë të natyrshme dhe pa shuam sforcime. Ata që janë vetëm, do të duhet të kalojnë një pengesë. Në punë, yjet ju ftojnë të mos i lini pas dore disa ide me vlerë, pasi kanë të gjitha mundësitë që të realizohen gjatë kësaj dite.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
 Kjo e mërkurë për të lindurit e kësaj shenje, mund të jetë vërtetë fatlume, sidomos në fushën e ndjenjave. Në dashuri, yjet ju japin besueshmëri maksimale, duke ju ofruar mundësi shumë të mira për të shfrytëzuar, si mënyrë për të forcuar më tej lidhjen tuaj. Nëse jeni ende vetëm, intuata dhe fati do ju ndihmojnë drejt njohjeve të reja.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
 Kjo ditë do të nisë me ritëm të reduktuar, ndërsa në mesditë do të fillojë gradualisht përmirësimi. Në dashuri, bëni mirë që të merrni një kohë vetëm për ju të dy, në mënyrë që të gjeni harmoninë e trazuar disi. Ata që janë vetëm, do të jenë në formë të shkëlqyer fizike dhe mendore. Yjet favorizojnë zemrat e vetmuara, të cilët do të jenë të përfshirë në udhëtime dhe në njohje të reja.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
 Kjo e mërkurë do ju mësojë me qetësi dhe maturi shumë gjëra. Duke qenë se kjo e mërkurë nuk do të jetë shumë në favorin tuaj, mos u ekspozoni shumë ndaj rreziqeve të kota. Në dashuri, nëse raporti në çift nuk është shumë harmonik, bëni mirë që të hidhni hapin e parë për të bërë paqe. Ata që janë vetëm do të ndihen të lodhur dhe të demotivuar, për shkak të rutinës ku janë përfshirë.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
 Dita nuk do të jetë ajo që ju dëshironi. Por gjithsesi mos u përfshini nga nervozizmi dhe xhelozitë e pavenda. Nëse keni diçka për të cilën duhet të kërkonin ndjesë, kjo është dita e duhur. Ata që janë vetëm, duhet të shmangin keqkuptimet, sidomos në raportet e tensionuara. Në punë, një projekt do të vijë drejt zvarritjes. Bëni mirë të analizoni situatën, për të kuptuar se pse ndodh një gjë e tillë.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
 Kjo do të jetë vërtetë një ditë mahnitëse, sidomos sa i takon fushës së ndjenjave. Dashuria do jetë pjesa më e favorizuar e kësaj të mërkure. Sidomos në raportin në çift, do të jeni të mbushur me energji dhe do të përjetoni momente të cilat nuk do i harroni lehtë. Ata që janë vetëm, duhet të kenë më shumë kurajo dhe të guxojnë për të bërë për vete dikë.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
 Në këtë ditë mesjave, Hëna do të hyjnë në shenjin tuaj, ku do të keni mundësi shumë të mira në fushën e ndjenjave dhe dashuria do të jetë më e favorizuar. Për ata që janë vetëm, gjithçka ecën në mënyrë më të mirë të mundshme, dhe premtohet shumë. Në punë, do të kuptoni se zgjidhja që prisnit prej kohësh është shumë afër.

MENSUR MAMUTI	TREG	ANTON PASHKU	FSHAT NË GOSTIVAR	TOKA E PUNUAR	NË NJË VEND TJETER, TJETERKUND PASTRIM	GJ	RAM (sh.) SHIH FOTON	K	PLLAKA MBATHËSE E KALIT	INSTITUTO DE TECNOLOGJIAS EDUCATIVAS	FOSFOR	LËVIZ NË KEMBË	PËSOJ HUMBJE, HUMBAS
FIGURË GJËOMETRIKE TREDIMENSIONALE													
TËRËSIA E APARATEVE (sh.)											C.Ë. KONCEPTI I TAOIZMIT		
ZORO		MËNYRAT, FORMAT VËNDOJ										SHUMËS VENDI KU JETON L.K.	
PËRSHËNDETJE E ROMAKEVE TË VJETER				VENDLINDJA E L.K. ITALI						ESHTER, KOCKË			
RRËZIM, ULJE						LLOJ AUTOMJETI AJROR PA PILOT				PRINCI GJER. FON BIZMARK LINJA E PARË, BALLI (SH. PASHQ.)			
						PATRIOTI I KUKËSIT, ELEZI (qendra 22 vjet në burgjet komuniste)					U.J. A.N.		
KALË									RATIFIKIM (shkurt.) LLOJ GJARPRI				VENDET E LINDJES
SULFUR								LLOJ ANTILOPE BRENDIA E OBJEKTT					
GAZ QË PËRDORET PËR NDRICIM XEHETARI											ARGON	SPECIALIST I MUEKIMIT TË TUMOREVE	
M													
Q.T.									INSTITUCIONE KRYEQYTETI I KOLORADOS				
INSTITUTION OF ENGINEERING DESIGNERS										FUTBOLLISTI IRLANDEZ, ROJ SHEGË			
KOHA	ORENDI PËR VARJEN E TESHAVE SHTRAT LUI	V	GRUP MUZIKOR AUSTRALIAN	QË I TAKON MOSHËS SË RE LLOJ SHPENDI SHTEPIAK	R	PËRFUNDIMTARE OPEN EDUCATIONAL RESOURCES			VETURË FRANCEZE FAN NOLI			TEMPO PËRFUNDIM I DIÇKAJE	STUDIM ME KARAKTER KRITIK OSE PUBLICISTIK (SH.)
TITULLI QË L.K. FITOI NË MAGDEBURG 5 JANAR, 2002													
QË KA TË BËJË ME ARIANËT								RENIUM SHKOVA				SISTEM PËR TË DHËNAT GJEOGRAFIKE LIDHËSE	
MUJAJ I PAVARËSISË FILIZ								SHKRONJË GREKE SHKRONJAT E PARA			LESOTO K.N.		
L						POSEDON FOSFOR			SKOCEZ RUMANI				
NJËSIA MONETARE BAZE E RUMANISË					E REHATSHME, PA SHOQËTËSIME								

ZGJIDHJET: GJ, K, PARALELOPIPED, APARATURAT, ÇË, Z, VARIANTET, SH, AVE, JUNIK, ASHT, RËNIE, KZO, OTO, RAIF, UJ, AT, RAT, S, BONGO, NEON, AR, MINATORI, QT, ENTE, IED, KIN, RENO, T, V, R, FINALE, KAMPION EVROPE, ARIANE, RE, GIS, NËNTORI, RO, LE, LASTAR, KA, SKOT, LEI, E PABRENGË.

Shumë i lehtë **Sudokun** **mesatar**

		7	4	5		8					2	4			7	3	5		
			1												1				4
5			8			7						9		8	3		6		
4			5			9	1				9	7	5						
2													8		1		4		
		5	3			8										9	3	5	
			8			1						5		8	3			2	
1					4									1					
		6		2	8		4					4	3	5			6	9	

Shumë i lehtë: 627345189, 839176524, 514892736, 476523918, 281469357, 953718642, 748951263, 192634875, 365287491. Mesatar: 824697351, 367451289, 591283764, 975346812, 238915476, 416728935, 659834127, 782169543, 143572698.

Burri 228 kg theu 2 taksi, çiftit obez i ndalohet hipja në to!



Marcus Edwards, i cili peshon 228 kg dhe e dashura e tij Taylor Faulkner, e cila peshon 120 kg, e përdornin firmën e taksive katër herë në ditë për të shkuar në shtëpi nga mamaja e tij, një milje larg. Por kur çifti bëri thirrje për një makinë për t'i marrë ato pas një vizite, atyre iu tha nga një operator se nuk kishte automjete në dispozicion dhe duhet të provonin të

merrnin një kompani tjetër. Dhe kur Taylor u zemërua më vonë duke kërkuar një shpjegim, asaj ju tha nga qendra e taksive në Hodge Hill, Birmingham, se Marcusit i ishte ndaluar të hipte në mjetet e tyre.

Taylor pretendon se asaj iu tha se ishte për shkak se dy shoferë kishin pohuar se pesha e tij kishte dëmtuar kabinat e dy taksive.



iPhone i ri me tri kamera të pasme

Apple do të prezantojë më së paku një model të iPhone-t në vitin 2019, me tri kamera të pasme, shkruan Taipei Times. Gazeta nga Tajvani citon kompaninë Yuanta Securities të ketë thënë se Apple mund të prezantojë telefonin me tri kamera në 12 megapiksel, dhe me një stabilizim optik të imazhit - një opsion që kontribuon në krijimin e fotografive më cilësore, transmeton KP. Aktualisht modelet, iPhone X dhe iPhone 8 Plus vijjnë me kamerën e dyfishtë prej 12 megapikselë.

Veza, duhet ngrënë apo jo përditë?!

Janë të shumta teoritë që qarkullojnë për konsumin e përditshëm të vezës. Disa prej tyre thonë se mjaftojnë vetëm dy në javë, të tjerë mbështesin faktin se veza duhet të hahet përditë. Sigurisht, jo e skuqur sepse pastaj nuk bëhet fjalë më për vezën por për vajin! Në fakt, të njëzëri janë të gjitha studimet se po, veza ka mjaft vlera ushqyese. Është e pasur në proteina e vitamina si A, B2, B6, B12, D, E. Në përbërje të saj ka minerale si zinku, thiamini, riboflavini, fosfori, magnezi, hekuri, seleni dhe bakri. Omega 3 dhe acidet yndyrore janë një tjetër pasuri e vezës. Për funksionet që ka secili nga këta përbërës në vezë dhe të mirat që i sjell veprimtarisë sonë fizike e mendore, është konkluduar së fundi nga studiuesit se, një vezë në ditë, është gjithmonë e këshillueshme.



Boshnjakët tmerrojnë gjermanët, 12 qengja në zgarë



Zgarë e madhe me zjarr të hapur në një livadh të thatë, kjo mund të jetë e rrezikshme! Për këtë arsye, policia gjermane është dashur të ndërtojë në një

festë të pasur në parkun popullor. Festa tashmë ka përfunduar, por edhe mund të kushtojë shumë shtrenjtë. Të dielën e kaluar, në Berlin-Friedrichshain ka qenë një

mot i mrekullueshëm, 24 gradë, rreze dielli, kur papritmas policia alarmohet se disa njerëz janë duke përgatitur zgarë të madhe me qengja në një livadh të thatë. Policia mbeti pa fjalë kur pa rreth 150 persona duke përgatitur plot dymbëdhjetë qengja në zgarë, përderisa fëmijët kanë qenë duke lozur të lirë. Zyrtarët policorë nuk kanë mundur të gjejnë lehtë përgjegjës të festës, pasi askush nuk ka dashur ta marrë përgjegjësinë e organizimit, shkruajnë mediat gjermane. Më në fund situata është sqaruar, pasi mysafirët kanë deklaruar se janë duke i festuar Pashkët. Pjesëmarrësit e zgarës janë nga Bosnjë e Hercegovina dhe ata duhet të llogaritin në një gjobë të majme, pasi e kanë djegur livadhin.

1267 - Kisha e Vjenës urdhëron që të gjithë hebrenjtë të veshin veshje dalluese

1427 - Hebrejtë dëbohet nga Berni - Zvicër

1497 - Lundërtari italian Amerigo Vespuçi fillon lundrimin e tij të parë në Botën e Re

1570 - Cari Ivan IV bëhet Protestant

1655 - Jamajka okupohet nga Anglezët

1774 - Luigji XVI shpallet Mbret i Francës

1906 - Mbahet takimi i parë i Dumës (Parlamentit) Ruse

1924 - J Edgar Hoover emërohet kryesues i FBI

1940 - Ushtria naziste sulmon Hollandën, Belgjikën dhe Luksemburgun

1945 - Trupat ruse okupojnë Pragën

1959 - Trupat sovjetike arrijnë në Afganistan

1969 - Apollo 10 transmeton fotografinë e parë me ngjyra nga gjithësia

1994 - Nelson Mandela jep betimin si kryetari i parë zezak i Afrikës Jugore

2005 - Vlladimir Arutinian hedh granatë dore 20 metra afër kryetarit amerikan Xhorxh Bush gjatë kohës kur ai mbante fjalim në Tblisi, Gjorgji, por nuk detonohet.



Vaksinat janë të sigurta dhe efektive. Çdo vaksinë e licencuar testohet rreptësisht para se të përdoret. Ato rivlerësohen dhe monitorohen vazhdimisht për efektet anësore. Vaksinat parandalojnë sëmundjet vdekjeprurëse. Mosvaksinimi i bën fëmijët dhe të moshuarit më të prekshëm nga sëmundjet, ndërlikimet e madje edhe nga vdekja. Vaksinat sigurojnë një imunitet më të mirë se infeksionet. Përgjigjja imunitare ndaj vaksinave është e ngjashme me përgjigjen natyrale ndaj infeksioneve, vetëm se shumë herë është më pak e dëmshme. Nëse do të ndërprisnim vaksinimin, sëmundjet do të rishfaqeshin.

KOKA DHE KOVA

Gjyqtari i drejtohet të dëmtuarit:
- Thoni se i akuzuari ju qëlloi me kovë në kokë?
- Mu në mes.
- Por në kokën tuaj nuk vërehet asgjë!
- Ndoshta, por mund të shikoni se që ndodhi me kovën!



Integriteti nuk ka nevojë për rregulla.
(Albert Camus)



KALENDARI HISTORIK 10 MAJ



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS